

Next Generation **What We Know** (Çfarë mendojnë të rinjtë për)

Keq/Dezinformimin në Ballkanin Perëndimor

April 2026

 **BRITISH
COUNCIL**



**Raport
përfundimtar**

Përgatitur nga: Aida Ajanović, hulumtuese kryesore,
dhe ekipi i kërkimit, në partneritet me British Council
Porositur nga: British Council
Partner për zbatim: Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Investigative (BIRN)

Data: Shkurt 2026
Vendet e përfshira: Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kosovë,
Mal i Zi, Maqedoni e Veriut, Serbi
Copyright © British Council 2024, licensed under a Creative Commons
Attribution Non-Commercial 4.0 International Licence
(<https://creativecommons.org/licenses/by-nc/4.0/>)
Autorët: <Izzah to share DOI to add here>

Përgjegjësia

Opinionet të shprehura në këtë raport janë të autorëve dhe kontribuesve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimet e British Council. Çdo gabim ose mospërfshirje është përgjegjësia jonë.

Raporti pasqyron gjetjet e disponueshme në kohën e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave. Duke qenë se mjediset informative online zhvillohen me shpejtësi, gjetjet duhet të konsiderohen si treguese të përvojave reale dhe modeleve të vërejtura gjatë periudhës së hulumtimit, dhe jo si një pasqyrë e plotë e të gjitha narrativave apo përmbajtjeve.

Ky dokument është përkthim i raportit origjinal të përgatitur në gjuhën angleze. Megjithëse është bërë çdo përpjekje për të siguruar saktësinë e përkthimit, në rast të çfarëdo dallimi, paqartësie apo mospërputhjeje ndërmjet këtij përkthimi dhe versionit origjinal në anglisht, teksti origjinal në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

Falënderime

Ky studim u bë i mundur falë kohës, njohurive dhe gatishmërisë së të rinjve që morën pjesë në diskutimet në grupe fokusi dhe në ditaret e rrjeteve sociale, si dhe të ekspertëve që kontribuan përmes intervistave me informatorë kryesorë. Ekipi i hulumtimit dëshiron gjithashtu të falënderojë Grupin Këshillimor Rinor (YAG) për udhëzimet, komentet dhe kontributin e tyre në interpretim dhe rekomandime.

Falënderime u drejtohen institucioneve dhe aktorëve të shoqërisë civile në të gjithë BP6 që mbështetën rekrutimin, kuptimin kontekstual dhe diskutimet e validimit. Ekipi i është mirënjohës British Council për mbikëqyrjen strategjike dhe zyrave vendore të BIRN për koordinimin dhe mbështetjen e tyre logjistike. **Shprehim mirënjohjen tonë të sinqertë për të gjithë ata që kanë qenë të përfshirë në këtë projekt që nga fillimi i tij.**

British Council

Izzah Meyer, Menaxhimi i Portofolit Global të Programit Kërkimor “Gjenerata e së Ardhmes”
James Perkins, Drejtues i Ekselencës në Kërkim, Mbretëria e Bashkuar
Jeremy Lang, Udhëheqës i Arsimit Joformal, Evropa e Gjerë
Bojana Colovic, Menaxhere e Lartë e Programeve për Ballkanin Perëndimor

BIRN

Aida Ajanović, Hulumtuese kryesore
Kristina Voko, Hulumtuese, Shqipëri
Mirza Haličević, Hulumtues, Bosnjë dhe Hercegovinë
Albulena Sadiku, Hulumtuese, Kosovë
Vuk Maraš, Hulumtues, Mal i Zi
Tamara Chausidis, Hulumtuese, Maqedoni e Veriut
Tijana Uzelac, Hulumtuese, Serbi
Ekipi i BIRN HUB

Grupi Këshillimor Rinor

Greta Topjana, Shqipëri
Valbona Halitaj, Shqipëri
Geri Emiri, Shqipëri
Ena Čaušević, Bosnjë dhe Hercegovinë
Atdhe Lila, Kosovë
Bujar Hoxha, Kosovë
Emili Radonjić, Mali i Zi
Martina Todorovska, Maqedoni e Veriut
Muhamed Smakić, Serbi
Tamara Arsić, Serbi
Branimir Đurović, Serbi
Marina Zec, Serbi

Përmbajtja

- 6. **Shkurtime dhe termat kryesore**
- 6. **Shkurtime**
- 7. **Termt kryesore**

- 8. **Përmbledhje ekzekutive**
- 8. Qëllimi dhe qasja
- 8. Gjetjet kryesore
- 9. Implikimet dhe pikat e ndikimit

- 10. **1 Hyrje**
- 12. 1.1 Sfondi dhe arsyetimi
- 13. 1.2 Objektivat e studimit dhe pyetjet hulumtuese
- 14. 1.3 Vendet e përfshira dhe audienat
- 15. 1.4 Si të lexohet raporti

- 16. **2 Konteksti rajonal dhe kombëtar**
- 18. 2.1 Përmbledhje rajonale e mjediseve të informacionit për të rinjtë në BP6
- 19. 2.2 Profili i shkurtër i vendeve

- 22. **3 Korniza konceptuale**
- 24. 3.1 Konceptet dhe përkufizimet kryesore
- 25. 3.2 Si i konceptojmë ne “mjediset e informacionit”
- 26. 3.3 Besimi, sinjalet e besueshmërisë dhe vendimmarrja
- 27. 3.4 Çfarë shton ky studim (krahasuar me evidencën ekzistuese)

- 28. **4 Metodologjia**
- 30. 4.1 Dizajni dhe qasja hulumtuese
- 30. 4.2 Mbulimi sipas vendeve
- 30. 4.3 Burimet e të dhënave dhe metodat e mbledhjes së tyre
- 32. 4.4 Përzgjedhja e kampionit dhe rekrutimi
- 32. 4.5 Etika, mbrojtja dhe menaxhimi i të dhënave
- 33. 4.6 Qasja analitike dhe triangulimi
- 34. 4.7 Validimi i bazuar në pjesëmarrje dhe bashkëkrijimi
- 35. 4.8 Kufizimet

- 36. **5 Mjediset e informacionit për të rinjtë në BP6**
- 38. 5.1 Platformat dhe aksesit
- 39. 5.2 Formatet dhe rrugët e përmbajtjes
- 39. 5.3 Dinamikat e bashkëmoshatarëve, krijuesve dhe komunitetit
- 40. 5.4 Peizazhi i besimit
- 40. 5.5 Momente rreziku dhe tema me intensitet të lartë

- 42. **6 Gjetjet: Shtatë tema kryesore**
- 44. 6.1 Tema 1: Besimi përhapet përmes njerëzve (prova sociale si rruga më e zakonshme drejt besueshmërisë)
- 48. 6.2 Tema 2: Kontrolli kërkon punë, prandaj i delegohet të tjerëve (vështirësia e verifikimit)
- 53. 6.3 Tema 3: Platformat formësojnë atë që bëhet “normale” (përforcimi algoritmik, influencuesit, komentet)
- 58. 6.4 Tema 4: Ndarja e përmbajtjes nuk nënkupton gjithmonë besim (humori dhe ndjenja e përkatësisë vs. rreziku i amplifikimit)
- 63. 6.5 Tema 5: Shumë informacion bëhet emocional (mbingarkesë, tërheqje)
- 68. 6.6 Tema 6: Ndërrhyrje në burim (boshllëqet në politika, zbatim, standardet e mediave, përgjegjësia e platformave)
- 73. 6.7 Tema 7: Edukimi mediatik si infrastrukturë (aftësi ndërbrezore)

- 78. 7 Gjetjet: Dy nëntema**
- 80. 7.1 Nëntema 1: Nuk ekzistojnë “fakte të pastra” – vetëm narrativa nga të cilat zgjidhet
- 84. 7.2 Nëntema 2: Autenticiteti i IA-së (konfuzion në rritje + sinjale)

- 88. 8 Përmbledhje ndër-rajonale**
- 90. 8.1 Si të lexohet matrica krahasuese
- 92. 8.2 Modele të përbashkëta në të gjithë BP6
- 93. 8.3 Veçoritë sipas vendeve (si ndryshon theksi sipas kontekstit)
- 95. 8.4 Kontradiktat ndër-metodike (dhe çfarë mund të nënkuptojnë ato)
- 95. 8.5 Kujdeset në interpretim

- 96. 9 Implikimet**
- 99. 9.1 Implikimet për vendimmarrjen e të rinjve
- 100. 9.2 Implikimet për sistemet arsimore
- 101. 9.3 Implikimet për median dhe gazetarinë
- 102. 9.4 Implikimet për platformat dhe ekosistemet digjitale
- 103. 9.5 Implikimet për shoqërinë civile dhe organizatat e të rinjve

- 104. 10 Rekomandime**
- 106. 10.1 Dhjetë rekomandime të priorituara (deklarata veprimi)
- 109. 10.2 Rekomandime sipas palëve të interesuara
- 110. 10.3 Aspekte të zbatimit (renditja e hapave dhe mundësia praktike)
- 110. 10.4 Shënime për vëzhgim dhe të nxënit (çfarë të monitorohet)

- 112. 11 Përfundime**
- 114. Përmbledhje e gjetjeve më të rëndësishme
- 115. Përmbledhje përmbyllëse dhe perspektiva për të ardhmen

- 116. Kredite dhe mirënjohje**
- 121. Kreditet**
- 121. Vërejtje**

Shkurtime dhe termat kryesore

Shkurtime

IA – Inteligjenca Artificiale
ALB – Shqipëria
AMI – Instituti Shqiptar i Medias
NENI 19 – NENI 19 (organizatë për lirinë e shprehjes).
ASCAP – Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (Shqipëri)
ATLAS.ti – Softuer për analizën cilësore të të dhënave i përdorur për kodim (manual kodimi ATLAS.ti v2)
AVMU – Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Maqedoni e Veriut)
BFMI – Nisma Ballkanike për Median e Lirë
BIH – Bosnja dhe Hercegovina
BIRN – Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Investigative
CAËI – Intervistimi në internet i asistuar nga kompjuteri (metodë anketimi online, e referuar në burime)
CG – Mali i Zi (kod vendi i përdorur në seksionet krahasuese të raportit)
CPD – Zhvillimi i vazhdueshëm profesional (mësuesit)
EMI – Burim për punën bazë/politikën mbi Aftësitë Mediatike dhe Informatike, i referuar në përmbledhjen e vendit (Shqipëri)
FES – Friedrich-Ebert-Stiftung.
FGD – Diskutime me grupe fokusi
ISK – Instituti për Studime të Komunikimit (Maqedoni e Veriut)
IMA – Instituti për Media dhe Analitikë (i referuar në listën e burimeve për Maqedoninë e Veriut)
IREX – IREX (organizatë ndërkombëtare për zhvillim; referuar në programin “Vibrant Information Barometer” dhe “YouThink”)
KEC – Qendra për Arsim e Kosovës
KII – Intervista me informatorë kryesorë
KOS – Kosova
LSL – Monitorimi i Lehtë i Rrjeteve Sociale.
MASHTI – Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (Kosovë)
MFRR – Reagimi i Shpejtë për Lirinë e Medias
MIL – Edukimi mediatik dhe informativ
IMM – Instituti Maqedonas i Mediave
MKD – Maqedonia e Veriut (kod vendi i përdorur në seksionet krahasuese të raportit)
MNE – Mali i Zi (kod vendi i përdorur në seksionet krahasuese të raportit)
NM – Maqedonia e Veriut (shkurtim i përdorur në disa citime/etiketa)
OBCT – Osservatorio Balcani e Caucaso Transeuropa.
OSBE – Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
REG – Rajonal (i përdorur në etiketat e citimeve si “REG_FGD_01”)
RESIS – Instituti RESIS (i referuar në listën e burimeve për Maqedoninë e Veriut)
SEENPM – Rrjeti i Evropës Juglindore për Profesionilizimin e Medias
SMD – Ditarët e Rrjeteve Sociale
SRB – Serbia
UNDP – Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
UNESCO – Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsimin, Shkencën dhe Kulturën
UNICEF – Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët
VIBE – Vibrant Information Barometer (IREX).
WB6 – Gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor (Shqipëria, Bosnja e Hercegovina, Kosova, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Serbia)
YAG – Grupi Këshillimor Rinor

Termt kryesore

“Sinjale besueshmërie” – Tregues praktikë të përdorur për të bërë vlerësime të shpejta mbi besueshmërinë (p.sh., identiteti i burimit, “zyrtarizimi”, stili i prezantimit, angazhimi, komentet).

“Dezinformim” – Informacion i verifikueshëm si i rremë, i shpërndarë me qëllim mashtrim dhe çorientim.

“Ekspozim → gjykim → besim → shpërndarje” – Sekuencë sjelljeje e përdorur për të strukturuar analizën se si haset dhe trajtohet përmbajtja.

“Momente me rëndësi/intensitet të lartë” – Periudha (p.sh., zgjedhje, kriza, çështje sociale polarizuese) kur ekspozimi rritet dhe shtohet presioni emocional.

“Mjedise informacioni” – Kushtet e kombinuara që formësojnë atë që hasin të rinjtë dhe si e interpretojnë ata këtë (media publike, platforma, hapësira gjysmë-private, marrëdhënie, komunikim institucional).

“Monitorim i Lehtë i Rrjeteve Sociale (LSL)” – Metodë kontekstuale që kap përmbajtje publike dhe të kërkueshme; nuk riprodhon feed-e të personalizuara dhe nuk vëzhgon besueshëm hapësira private/gjysmë-private.

“Malinformim” – Informacion që mashtron qëllimisht duke ndryshuar kuptimin e informacionit të vërtetë.

“Keqinformim” – Informacion i verifikueshëm si i rremë, i shpërndarë pa qëllim mashtrimi.

“Formate native të platformës” – Përmbajtje e dizajnuar sipas logjikës së platformës (klipe të shkurtra, meme, karusele, zinxhirë ripostimesh) që shpërndahet shpejt dhe shpesh humbet kontekstin.

“Besim indirekt/provë sociale” – Rrugët e shkurtra të besimit të bazuara në faktin se kush e ka shpërndarë diçka, njohja, “zyrtarizimi” i perceptuar dhe sinjalet e aprovimit, jo verifikimi i drejtpërdrejtë.

“Triangulimi” – Integrimi i provave nga diskutimet e grupeve të fokusit, intervistat kyçe dhe studimet e ditareve të rrjeteve sociale (kur është e disponueshme); konvergjenca përforcon besueshmërinë, ndërsa divergjenca trajtohet si e rëndësishme nga ana analitike.

“Besimi” – Besimi se një burim, platformë, ose përmbajtje është i besueshëm dhe i shpërndarë me mirëbesim (përdoret si koncept qendror i raportit).

“Vështirësia e verifikimit” – Kostot e kohës, përpjekjes dhe pasigurisë që e bëjnë verifikimin selektiv, të deleguar ose të shmangur.

Përmbledhje ekzekutive

Qëllimi dhe qasja

Ky studim u porosit nga British Council dhe u realizua nga Rrjeti Ballkanik për Gazetari Investigative (BIRN). Ai është pjesë e programit kërkimor “Next Generation” të British Council, i cili shqyrton prioritetet, aspiratat dhe nevojat e të rinjve në mbarë botën. Synimi i këtij programi është të ndihmojë që interesat e të rinjve të përfaqësohen siç duhet në politikat që ndikojnë në jetën e tyre dhe formësojnë të ardhmen e tyre.

Ky studim shqyrton se si të rinjtë në Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kosovë, Mal të Zi, Maqedoni të Veriut dhe Serbi (të ashtuquajturat “Gjashtëshja e Ballkanit Perëndimor” – BP6) aksesojnë informacionin, vlerësojnë besueshmërinë e tij dhe reagojnë ndaj keqinformimit dhe dezinformimit në mjedise të përditshme të formësuara nga platformat digjitale. Ai përqendrohet në “mjediset e informacionit” si sisteme të jetuara: një ndërthurje platformash, formatesh, marrëdhëniesh dhe kushtesh institucionale që ndikojnë në atë që bëhet e dukshme dhe e besueshme.

Studimi përdor një qasje me metoda të përziera, duke kombinuar diskutimet në grupe fokusi (FGD) dhe Ditarët e Rrjeteve Sociale (SMD) me të rinj të moshës 18–30 vjeç, intervistat me informatorë kryesorë (KII), si dhe Monitorimin e Lehtë të Rrjeteve Sociale (LSL), aty ku është i disponueshëm. Evidenca triangulohet ndërmjet metodave. Konvergjenca rrit besueshmërinë, ndërsa divergjenca konsiderohet me rëndësi analitike dhe diskutohet si tregues i dallimeve midis dukshmërisë publike dhe përvojës së jetuar, përfshirë përmbajtjen që qarkullon në hapësira gjysmë-private ose private.

Gjetjet kryesore

Në të gjithë BP6, të rinjtë përshkruajnë mjedise informacioni të karakterizuara nga volum i lartë, vëmendje e fragmentuar dhe një mbështetje në “sinjale besueshmërie” praktike, në vend të verifikimit të thelluar. Rrallëherë, besimi është i pakushtëzuar dhe shpesh ndërmjetësohet përmes njerëzve dhe sinjaleve të ndërmjetësuar.

- **Ekspozimi ndikohet nga dinamika e platformave dhe rrjetet sociale.** Të rinjtë shpesh hasin pretendime përmes rekomandimeve, krijuesve të përmbajtjes, komenteve, zinxhirëve të ripostimeve dhe bisedave në grup, në vend që t'i kërkojnë qëllimisht lajmet.
- **Vlerësimet e besueshmërisë varen nga “rrugë të shkurtra” nën presion.** Sinjalet e zakonshme përfshijnë “zyrtaritetin” e perceptuar, markimin e njohur, stilin e paraqitjes, metrikat e angazhimit dhe miratimin shoqëror (“kush e ka shpërndarë”). Këto sinjale mund të jenë të dobishme, por jo gjithmonë të besueshme.
- **Verifikimi përjetohet si punë.** Ai kërkon kohë, aftësi dhe motivim, dhe shpesh bëhet në mënyrë selektive. Kur ndihen të mbingarkuar, të rinjtë mund t’ia delegojnë verifikimin individëve të besuar, të tërhiqen, ose ta konsiderojnë përmbajtjen si argëtim dhe jo si pretendime për të vërtetën.
- **Besimi është i pabarabartë dhe shpesh i kontestuar.** Besimi institucional ndryshon sipas kontekstit, por skepticizmi ndaj politikës dhe stimujve mediatikë është i zakonshëm. Në mjedise me nivel më të ulët besimi, besimi ndërpersonal dhe sinjalet e komunitetit bëhen më ndikues.
- **Rreziku rritet gjatë periudhave me rëndësi të lartë.** Zgjedhjet, krizat dhe çështjet shoqërore polarizuese e shtojnë ekspozimin dhe stresin emocional. Në këto momente, rrjedhat e përmbajtjes mund të duken “të pashmangshme” dhe reagimet priren të bëhen më të ankthshme, konfliktuale, shmangëse ose tepër vigjilente.

Implikimet dhe pikat e ndikimit

Gjetjet theksojnë nevojën për ndërhyrje që synojnë si aftësitë individuale, ashtu edhe faktorët sistemikë. Pikat kryesore të ndikimit përfshijnë:


- Përmirësimin e edukimit mediatik dhe informativ (MIL) si një grup aftësish praktike, ndërkurrikulare, të mbështetura nga zhvillimi i vazhdueshëm profesional (CPD) për mësuesit.
- Krijimin e përmbajtjeve dhe burimeve të fokusuara te të rinjtë, që janë specifike për platforma të ndryshme, koncize dhe të shpërndara përmes ndërmjetësve të besuar, përfshirë formate midis bashkëmoshatarëve dhe të krijuara bashkërisht.
- Mbështetjen e mediave cilësore dhe verifikuesve të fakteve për të rritur angazhimin e të rinjve përmes materialeve shpjeguese dhe partneriteteve me krijues të besuar, duke ruajtur njëkohësisht pavarësinë editoriale.
- Përmirësimin e komunikimit institucional duke garantuar konsistencë, transparencë dhe reagim të shpejtë, veçanërisht gjatë momenteve me presion të lartë.
- Avancimin e masave të llogaridhënies së platformave (etiketim, transparencë, kontroll i reklamave dhe zbutje e nxitësve të amplifikimit), në përputhje me qasje të bazuara në të drejta.

Hyrje

Të rinjtë në Gjashtëshen e Ballkanit Perëndimor (BP6) lundrojnë në mjedise informacioni që ndryshojnë shpejt dhe janë shumë të personalizuar, të cilat formësohen po aq nga marrëdhëniet shoqërore sa edhe nga institucionet mediatike. Përmbajtja arrin te të rinjtë përmes një kombinimi të platformave publike dhe kanaleve gjysmë-private ose private, përfshirë bisedat në grup dhe postimet e përcjella. Në këto hapësira, pretendimet shpesh hasen në formate të shkurtra dhe të lehta për t'u shpërndarë (video, meme, screenshot-e), dhe gjykimet mbi besueshmërinë kryhen shpesh nën presion kohe dhe me kontekst të kufizuar.

Këto dinamika janë të rëndësishme sepse ndikojnë në mënyrën se si të rinjtë formojnë opinionet, marrin vendime dhe marrin pjesë në jetën qytetare. Ato gjithashtu ndikojnë në ekspozimin ndaj keqinformimit/dezinformimit, dhe përmbajtjeve të dëmshme ose manipuluese, veçanërisht gjatë periudhave me rëndësi të lartë, si zgjedhjet, krizat ose çështjet shoqërore polarizuese. Në të njëjtën kohë, të rinjtë nuk janë marrës pasivë. Ata interpretojnë, injorojnë, sfidojnë ose shpërndajnë përmbajtje në mënyrë aktive, duke u mbështetur në përvojën personale, rrjetet e bashkëmoshatarëve si dhe sinjale besimi.

Ky raport sjell gjetjet e një studimi të kryer me metodologji të përzier mbi mjediset e informacionit të të rinjve dhe keqinformimin/dezinformimin në BP6. Ai shqyrton praktikën, perceptimet dhe presionet e përditshme që formësojnë mënyrën se si informacioni njihet dhe përdoret. Në përputhje me qëllimet e përgjithshme të programit kërkimor “Next Generation / Gjenerata e së Ardhmes”, raporti thekson implikimet dhe jep rekomandime për politika dhe programim.



1.1 Sfondi dhe arsyetimi

Debati publik mbi keqinformimin/dezinformimin shpesh supozon se gënjeshtat korrigjohen përmes verifikimit individual të fakteve ose se “informacioni më i mirë” automatikisht do të tërheqë vëmendjen. Gjetjet e këtij studimi në të gjithë BP6 sugjerojnë një realitet më kompleks. Të rinjtë përshkruajnë një mjedis të karakterizuar nga volum i lartë, vëmendje e fragmentuar dhe besim që ndryshon vazhdimisht. Në praktikë, verifikimi përjetohet si punë: kërkon kohë, motivim dhe qasje në burime të besueshme, dhe nuk është gjithmonë i mundshëm në rrjedhat e përmbajtjes që lëvizin shpejt.

Paralelisht, dizajni i platformave dhe strukturat e monetizimit ndikojnë në atë që bëhet e dukshme. Sistemet e rekomandimeve mund të amplifikojnë përmbajtje me ngarkesë emocionale, ndërsa reklamimi dhe ekosistemet e krijuesve mund të zbehin kufijtë midis informacionit, bindjes dhe argëtimit. Seksionet e komenteve dhe dinamika e grupeve mund të formësojnë më tej interpretimin, ndonjëherë duke sqaruar pretendimet, por shpesh duke intensifikuar konfliktin, polarizimin ose cinizmin.

Qëllimi i këtij studimi është të shkojë përtej fokusit të ngushtë mbi “përmbajtjen e rreme” dhe të eksplorojë mjediset më të gjera të informacionit ku jetojnë të rinjtë: si ndodh ekspozimi, cilat sinjale ndikojnë në gjykimet e besueshmërisë, si ndërtohet ose shkatërrohet besimi dhe cilat momente ose tema rrisin rrezikun. Kjo qasje mbështet përgjigje më realiste dhe efektive, duke njohur si veprimin individual ashtu edhe kufizimet strukturore.

1.2 Objektivat e studimit dhe pyetjet hulumtuese

Objektivat e studimit

Studimi ka për qëllim të:

- Përshkruajë mjediset e informacionit të të rinjve në BP6, duke përfshirë platformat, rrugët e përhapjes dhe ndërveprimet sociale.
- Kuptojë se si të rinjtë vlerësojnë besueshmërinë, përfshirë sinjalet dhe “rrugët e shkurtra” që përdorin në situata reale.
- Eksplorojë se si keqinformimi/dezinformimi dhe narrativat e dëmshme përhapen, veçanërisht gjatë momenteve me rëndësi të lartë.
- Identifikojë se si ekspozimi dhe mbingarkesa ndikojnë në mirëqenie, pjesëmarrje dhe vendimmarrje të përditshme.
- Gjenerojë implikime të zbatueshme dhe pika ndikimi për politikën, arsimin, mediat dhe programet.

Pyetjet hulumtuese

Studimi udhëhiqet nga pyetjet e mëposhtme:

- Si i qasen të rinjtë në BP6 informacionit dhe cilat platforma dhe kanale formësojnë ekspozimin e tyre të përditshëm?
- Cilat formate dhe rrugë sjellin më shpesh pretendimet në vëmendjen e të rinjve (për shembull, rekomandimet, krijuesit e përmbajtjes, komentet, përcjelljet dhe reklamat)?
- Cilat sinjale përdoren për të gjykuar besueshmërinë dhe si ndikojnë presioni i kohës, emocionet dhe besimi në institucione në këto gjykime?
- Si i njohin, verifikojnë dhe reagojnë të rinjtë ndaj keqinformimit dhe dezinformimit, dhe si ndikojnë këto përvoja në besimin ndaj burimeve të informacionit?
- Si formësojnë marrëdhëniet shoqërore (bashkëmoshatarët, familja, komunitetet, krijuesit) atë që besohet, shpërndahehet, sfidohet ose injorohet?
- Cilat tema dhe periudha përjetohehen si “me rrezik të lartë” ose me intensitet të lartë dhe përse?
- Çfarë masash ose veprimesh mund të nxirren për të përforcuar edukimin mediatik dhe informativ, komunikimin institucional, llogaridhënien e platformave dhe ndërhyrjet për të rinjtë?

1.3 Vendet e përfshira dhe audiencat

Vendet e përfshira

Studimi përfshin gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor (BP6):

1. Shqipëri
2. Bosnja dhe Hercegovina
3. Kosovë
4. Mal i Zi
5. Maqedoni e Veriut
6. Serbi

Gjetjet paraqiten në dy nivele:

- Një përmbledhje e përgjithshme për të gjithë BP6, që nxjerr në pah dinamika të përbashkëta dhe tema ndërsektoriale.
- Profil i shkurtër i secilit vend që i inkuadron gjetjet brenda konteksteve kombëtare dhe nxjerrin në pah modelet karakteristike.

Audiencat e synuara

Ky raport është hartuar për:

- Politikëbërësit dhe institucionet publike të përfshira në arsim, të rinjtë, mediat dhe politikat digjitale.
- Arsimtarët, hartuesit e kurrikulave dhe ofruesit e trajnimeve për mësuesit.
- Organizatat e shoqërisë civile dhe organizatat rinore që zhvillojnë nisma për edukimin mediatik dhe informativ ose që forcojnë qëndrueshmërinë digjitale.
- Mediat, verifikuesit e fakteve dhe shoqatat profesionale që synojnë të rrisin angazhimin dhe besimin e të rinjve.
- Platformat, rregullatorët dhe aktorët që fokusohen në sigurinë online, transparencën dhe llogaridhënien.
- Donatorët dhe organizatat ndërkombëtare që mbështesin të rinjtë, pjesëmarrjen qytetare dhe integritetin e informacionit në rajon.

1.4 Si të lexohet raporti

Raporti është strukturuar për të lehtësuar si navigimin e shpejtë, ashtu edhe analizën e thelluar.

- **Kapitujt 2–4** shpjegojnë kontekstin, konceptet dhe qasjen e studimit. Kjo përfshin përkufizime kyçe dhe logjikën për interpretimin e mjediseve të informacionit, sinjalet e besueshmërisë dhe vendimmarrjen në kushte reale.
- **Kapitulli 5** eksploron mjediset e informacionit të të rinjve në terma të thjeshtë (platformat, formatet, dinamika shoqërore, peizazhi i besimit dhe momentet e rrezikut).
- **Kapitujt 6–8 paraqesin gjetjet kryesore tematike.** Çdo temë mbështetet nga të dhëna të grumbulluara me metoda të ndryshme dhe thekson mekanizmat, tensionet dhe implikimet.

Shtojcat ofrojnë transparencë shtesë dhe materiale mbështetëse (për shembull, hartëzmi temë-kode dhe grafikë e triangulimit, aty ku është e aplikueshme). Shtojcat mund të kërkohen në adresën researchglobal@britishcouncil.org.

Të dhënat triangulohen ndërmjet metodave të ndryshme. Konvergjenca midis metodave konsiderohet si mbështetje më e fortë, ndërsa divergjenca shihet si me rëndësi analitike dhe diskutohet si tregues i dallimeve midis dukshmërisë publike dhe përvojës së jetuar (për shembull, midis asaj që është e dukshme në përmbajtje publike dhe asaj që qarkullon në hapësira gjysmë-private).

Për lexuesit që kërkojnë mësim praktikë, seksioni mbi implikimet dhe pikat e ndikimit mund të lexohet si një përmbledhje e pavarur e fushave të veprimit, të cilat më pas mund të lidhen me provat mbështetëse në kapitujt tematikë.

Shënim mbi të dhënat dhe interpretimin

Të dhënat nga shqyrtimi i literaturës janë përdorur për të ofruar kontekstin mbi të rinjtë, mediat dhe kushtet digjitale në BP6. Gjetjet tematike në Kapitujt 6–8 bazohen në të dhëna cilësore dhe triangulohen ndërmjet diskutimeve në grupe fokusi, intervistave me informatorë kryesorë, Ditarëve të Rrjeteve Sociale (SMD) dhe Monitorimit të Lehtë të Rrjeteve Sociale. Kur të dhënat ndryshojnë ndërmjet metodave, kjo konsiderohet me rëndësi dhe diskutohet si tregues i dallimeve midis dukshmërisë publike dhe përvojës së jetuar (përfshirë përmbajtjen që qarkullon në hapësira gjysmë-private ose private).

Konteksti rajonal dhe kombëtar

Ky kapitull përshkruan kontekstin rajonal dhe kombëtar të nevojshëm për të kuptuar gjetjet. Ai përmbledh tiparet kryesore të mjediseve të informacionit të rinjve në BP6 dhe thekson faktorët specifikë për secilin vend që ndikojnë në ekspozim, besim dhe vendimmarrje përqendrimi. Qëllimi nuk është të ofrohet një rishikim i gjerë i politikave, por të përqendrohet në elementët kontekstualë që lidhen drejtpërdrejt me të dhëna në Kapitujt 6–8, duke përfshirë rrugët e platformave, sinjalet e besueshmërisë dhe dinamikat institucionale e mediatike që formësojnë llogaridhënien. Analizat për secilin vend në Seksionin 2.2 ofrojnë profile të shkurtra për secilin kontekst të BP6, me informacion të detajuar të disponueshëm në Shtojcën A.

Të dhënat nga shqyrtimi i literaturës janë përdorur për të ofruar kontekst; gjetjet tematike rrjedhin nga të dhëna cilësore dhe triangulohen ndërmjet diskutimeve në grupe fokusi (FGD), intervistave me informatorë kryesorë (KII), Ditarëve të Rrjeteve Sociale (SMD) dhe Monitorimit të Lehtë të Rrjeteve Sociale.

2

2.1 Përmbledhje rajonale e mjediseve të informacionit për të rinjtë në BP6

Në të gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor (BP6), mjediset e informacionit për të rinjtë formësohen nga tre dinamika të ndërlydhura: zakone informimi të përqendruara te platformat, sisteme mediatike të dobëta dhe të kontestuara, si dhe një ofrim i pabarabartë i edukimit mediatik dhe informativ (MIL). Si rezultat, krijohet një mjedis ku të rinjtë shpesh i njohin rreziqet e dezinformimit, por i përballojnë ato përmes rrugëve të shkurtra njohëse si mbështetja te miratimi i bashkëmoshatarëve, familjariteti, “zyrtariteti” i perceptuar dhe verifikimi ad hoc në vend që të mbështeten në burime institucionale të qëndrueshme.

Anketat dhe vlerësimet rajonale tregojnë një mungesë të theksuar të trajnimit formal për vlerësimin e besueshmërisë së informacionit. Në fazën fillestare të studimit, më pak se 40% e të rinjve raportuan se kishin marrë ndonjë formë trajnimi formal për këtë çështje, duke përforcuar varësinë nga heuristikat në vend të verifikimit sistematik (BIRN, 2026).

Njëkohësisht, dobësitë strukturore të ekosistemeve mediatike (si polarizimi politik, brishtësia e tregut dhe standardet jo të qëndrueshme profesionale) ndikojnë si në përmbajtjen që arrin te të rinjtë, ashtu edhe në mënyrën se si ajo interpretohet. Kjo bëhet veçanërisht e dukshme gjatë momenteve me ngarkesë të lartë publike (p.sh. kriza politike, incidente të sigurisë publike dhe çështje identitare polarizuese), kur përmbajtjet emocionale përhapen me shpejtësi në rrjete dhe platforma komunikimi, ndërsa sinjalet korigjuese të besueshme shpesh janë më të ngadalta ose më pak të dukshme.

Ofrimi i edukimit mediatik dhe informativ mbetet i paqëndrueshëm dhe shpesh i orientuar nga projekte afatshkurtra. Vlerësimet rajonale sugjerojnë se shumë iniciativa MIL drejtohen nga organizata të shoqërisë civile dhe organizata ndërkombëtare, në vend që të integrohen në mënyrë sistematike në kurrikulat shkollore, me përgjegjësi të shpërndara ndërmjet ministrive, autoriteteve rregullatore dhe institucioneve arsimore (BIRN, 2026). Edhe kur ekzistojnë në kurrikula, këto përmbajtje shpesh janë ndërkurrikulare ose opsionale, çka mund të dobësojë zbatimin dhe t'i lërë mësuesit pa mbështetje të vazhdueshme praktike.

Përmbledhjet e shkurtëra të vendeve të paraqitura më poshtë bazohen në kërkime dokumentare të përgatitura nga studiues vendas dhe burime mbështetëse për të përshkruar karakteristikat kryesore të secilit mjedis informativ të të rinjve, të rëndësishme për interpretimin e gjetjeve të studimit.

Përmbledhjet e vendeve më poshtë përdorin kërkime dokumentare të përgatitura nga studiues vendas dhe burime mbështetëse për të përshkruar karakteristikat kryesore të secilit mjedis informativ rinor, të rëndësishme për interpretimin e gjetjeve.

2.2 Profili i shkurtër i vendeve

Këto përmbledhje ofrojnë profile të shkurtra të mjedisit informativ të të rinjve në secilin vend, duke u fokusuar në:

- (i) mënyrën se si të rinjtë zakonisht i qasen informacionit,
- (ii) dobësitë kryesore (dezinformimi, përmbajtja e dëmshme, rreziqet ndaj besimit dhe integritetit), dhe
- (iii) kontekstin e politikave dhe praktikave (MIL dhe përgjigjet institucionale përkatëse).

Shqipëria

Në Shqipëri, rrjetet sociale po bëhen gjithnjë e më qendrore në mënyrën se si të rinjtë marrin informacionin, me kufij të paqartë ndërmjet “lajmeve”, argëtimit dhe përmbajtjes së krijuesve digjitalë. Një raport rajonal mbi trendet mediatike thekson se rrjetet sociale përbëjnë burimin kryesor të informacionit për të rinjtë, duke reflektuar ndikimin në rritje të tyre në sjelljen e përditshme (SEENPM, 2025).

Edukimi mediatik dhe informativ (MIL) ka qenë objekt i një sërë iniciativash politike dhe programore. Një analizë kombëtare përshkruan përpjekjet për zhvillimin e një kurrikule të integruar MIL, të harmonizuar me kompetencat e UNESCO-s, e cila pritet të pilotohet në disa shkolla fillore dhe të mesme (EMI, 2021). Së fundmi, UNESCO ka raportuar zgjerimin e integritetit të MIL-it përmes trajnimit të trajnerëve të mësuesve, të cilët më pas i transferojnë këto aftësi te kolegët e tyre (UNESCO, 2025).

Mjedisi i platformave ndikohet gjithashtu nga debatet publike dhe politike mbi rreziqet që lidhen me platformat e videove të shkurtrë, përfshirë diskutimet për masa kufizuese dhe mekanizma sigurie (Reuters, 2025). Edhe pse gjetjet e këtij raporti mbështeten kryesisht në të dhëna cilësore, këta faktorë kontekstualë janë të rëndësishëm për të kuptuar perceptimet mbi rrezikun dhe përgjegjësinë si të rinjtë, ashtu edhe të rriturit.

Bosnja dhe Hercegovina

Mjedisi informativ në Bosnje dhe Hercegovinë karakterizohet nga një rol i fortë i televizionit, përdorim i lartë i rrjeteve sociale dhe ekspozim i konsiderueshëm ndaj narrativave të politizuara dhe të lidhura me identitetin. Një raport krahasues tregon se, megjithëse televizioni mbetet burimi më i zakonshëm i lajmeve, rreth 50% e të anketuarve i marrin lajmet çdo ditë përmes rrjeteve sociale (BFMI, 2022).

Përdorimi i platformave dominohet nga Facebook-u, i cili përbën një pjesë shumë të madhe të përdoruesve të rrjeteve sociale dhe rreth gjysmën e përdoruesve të moshës 18–34 vjeç (BFMI, 2022). Në praktikë, rrugët e informacionit për të rinjtë shpesh kalojnë lirshëm mes portaleve, platformave sociale dhe komunikimit ndërpersonal, gjë që mund të përshpejtojë si përhapjen e informacionit të besueshëm, ashtu edhe të atij mashtrues.

Bazuar në provat cilësore të këtij studimi, Bosnja dhe Hercegovina është e njohur për fokusin e saj të fortë në transparencën e mediave dhe kufizimet e kapaciteteve institucionale, duke përfshirë interesin në sinjalet e pronësisë/impresumit si sinjale besueshmërie (BIRN, 2026).

Bosnja dhe Hercegovina po avancojnë nëpërmjet një faze pilotimi, në vend të një zbatimi të standardizuar në nivel kombëtar të edukimit mediatik dhe informativ (MIL) në shkolla. Sipas UNESCO-s, testimi pilot është miratuar në nivel kantonal dhe të entiteteve, duke përfshirë trajnimin e bibliotekarëve dhe mësuesve, të lidhur drejtpërdrejt me zbatimin në 30 shkolla në Kantonin e Sarajevës, Kantonin Hercegovinë-Neretva dhe Republikën Srpska, duke filluar nga viti shkollor 2021/2022 (UNESCO, 2023; Ministria e Çështjeve Civile e Bosnjë dhe Hercegovinës, pa datë).

Njëkohësisht, Kantoni i Sarajevës ka miratuar një strategji të posaçme për zhvillimin e MIL-it brenda sistemit arsimor, duke sinjalizuar integrim të politikave të paktën në një pjesë të strukturës së fragmentuar të qeverisjes në vend (Ministria e Arsimit e Kantonit të Sarajevës, 2022).

Kjo qasje e vendos kapacitetin e zbatimit në qendër: shtrirja dhe qëndrueshmëria varen nga mbështetja e vazhdueshme për mësuesit dhe koordinimi ndërmjet autoriteteve të shumta arsimore.

Kosova

Në Kosovë, televizioni mbetet një burim kyç informacioni për popullatën e përgjithshme, ndërsa rrjetet sociale po bëhen gjithnjë e më të rëndësishme si kanale alternative, veçanërisht për audiencat e reja. Një profil i trendeve mediatike thekson se televizioni vazhdon të jetë burimi kryesor i informacionit, ndërkohë që rrjetet sociale (veçanërisht Facebook-u dhe Instagram-i) po fitojnë terren si burime alternative (SEENPM, 2025).

Sa i përket edukimit mediatik dhe informativ (MIL), një vlerësim i fundit për Kosovën thekson se edukimi mediatik është i përcaktuar si temë ndërkurrikulare në arsimin parauniversitar, megjithëse shkalla e integritimit në praktikën e klasës ndryshon (Hibrid.info, 2024).

Mali i Zi

Mjedisi i informacionit për të rinjtë në Mal të Zi është kryesisht digjital dhe po ndikohet gjithnjë e më shumë nga kanalet e komunikimit gjysmë-private. Dokumentet strategjike kombëtare theksojnë se të rinjtë kryesisht mbledhin informacion përmes rrjeteve sociale dhe portaleve online, dhe pritet që ata të vazhdojnë ta bëjnë këtë (Qeveria e Malit të Zi, 2023). Ndërsa informacioni qarkullon përmes aplikacioneve të mesazheve dhe grupeve të mbyllura, ai mund të shmangë debatin publik dhe korrigjimin gazetaresk, duke krijuar “realitete” paralele që janë të vështira për t'u kundërshtuar përmes reagimeve konvencionale mediatike.

Strategjia rinore thekson gjithashtu rëndësinë e forcimit të aftësive dhe infrastrukturës mbrojtëse, përfshirë përmes arsimit qytetar dhe edukimit mediatik në shkolla, duke reflektuar shqetësimet për mjedise informacioni të pasigurta dhe manipuluese (Qeveria e Malit të Zi, 2023). Ky kontekst është i rëndësishëm kur interpretohen gjetjet e studimit mbi verifikimin selektiv, raportimin e ulët dhe pritshmërinë se përgjegjësia qëndron “më lart” në zinxhirin e informacionit.

Mali i Zi e ka futur edukimin mediatik si një lëndë fakultative në arsimin fillor gjatë vitit shkollor 2023/24, i mbështetur nga udhëzimet për mësuesit të zhvilluara në kuadër të një nisme të lidhur me UNESCO-n (UNESCO, 2023). Kjo ofron një pikë hyrjeje të qartë në arsimin formal, por shkalla dhe vazhdimësia do të varen nga resurset e disponueshme dhe mbështetja e vazhdueshme për mësuesit, përfshirë përafrimin me prioritetet më të gjera të politikave rinore mbi aftësitë digjitale dhe mediatike (Qeveria e Malit të Zi, 2023).

Besimi te mediat përbën një dobësi të veçantë. Studimi kombëtar i të rinjve i vitit 2024 raporton se besimi te mediat është ndër më të ulëtit, me vetëm 15.8 për qind të të anketuarve që tregojnë se u besojnë mediave plotësisht ose në një masë të konsiderueshme (Ostojčić, 2024).

Maqedonia e Veriut

Në Maqedoninë e Veriut, mjedisi i informacionit për të rinjtë karakterizohet nga një angazhim i lartë digjital dhe shqetësim në rritje për keqinformimin dhe rreziqet online. Lista e burimeve të hulumtimit kombëtar e përpiluar për këtë studim evidenton prova kombëtare mbi sjelljet online dhe sigurinë e adoleshentëve (UNICEF, 2020–2023), prioritetet e politikave rinore përfshirë kompetencat digjitale (Agjencia për Rini dhe Sport, 2023–2027) dhe punën e anketimeve mbi konsumimin e lajmeve nga të rinjtë dhe njohjen e keqinformimit (ICS, pa datë).

Edukimi mediatik është promovuar gjithashtu përmes programeve të lidhura me arsimin. Një shembull i rëndësishëm është programi “YouThink”, i cili raporton integrimin e edukimit mediatik në shkollat fillore dhe të mesme dhe lidhjen e tij me zhvillimin e mësuesve, përfshirë trajnimin para-shkollor (IREX, 2022). Fokusi institucional gjithashtu pasqyrohet nga puna e rregullatorit kombëtar audio-vizual, i cili vlerëson edukimin mediatik mes nxënësve të shkollave të mesme, duke mbështetur një kuptim më të targetuar të nevojave të tyre (AVMU, 2024).

E njëjta përmbledhje burimore tregon se aktorët kombëtarë kanë vlerësuar besimin te mediat, sfidat e integritetit dhe rreziqet e dezinformimit përmes studimeve të dedikuara dhe raporteve të monitorimit (p.sh., IREX, 2024; Metamorphosis, 2024), dhe se edukimi mediatik është matur mes nxënësve të shkollave të mesme nga rregullatori audio-vizual AVMU (AVMU, 2024).

I njëjti raport thekson gjithashtu se edukimi mediatik është futur si lëndë fakultative në shkolla (“Gjuha, media dhe kultura”), por palët e interesuara favorizojnë një qasje më të fortë duke integruar edukimin mediatik në lëndë të tjera dhe në vitet e hershme të shkollës (IREX, 2024).

Serbia

Në Serbi, një ekosistem mediatik kompleks dhe i polarizuar ndërvepron me përdorimin e gjerë të platformave dhe shqetësimet e vazhdueshme mbi manipulimin, shkeljet e privatësisë dhe dëmet online. Raporti i Vibrant Information Barometer 2024 për Serbinë thekson raste survejimi dhe ngacmimi të aktivistëve dhe protestuesve studentorë, si dhe qarkullimin e informacionit të manipuluar ose të rremë që synon diskreditimin e figurave publike (IREX, 2024). Ai gjithashtu evidenton një nivel të lartë shkeljesh të të drejtave digjitale dhe shkeljesh online në vitin 2023, ku mashtrimet, kërcënimet dhe manipulimi përbëjnë një pjesë të konsiderueshme (IREX, 2024).

I njëjti raport thekson gjithashtu se edukimi mediatik është futur si lëndë fakultative në shkolla (“Gjuha, media dhe kultura”), por palët e interesuara favorizojnë një qasje më të fortë duke integruar edukimin mediatik në lëndë të tjera dhe në vitet e hershme të shkollës (IREX, 2024).

Provat krahasuese gjithashtu evidentojnë dominimin e Facebook-ut brenda bazës së përdoruesve të rrjeteve sociale në Serbi dhe rëndësinë e rrjeteve sociale si burim lajmesh për një pjesë të konsiderueshme të përdoruesve të internetit (BFMI, 2022). Në sintezën cilësore të studimit, Serbia njihet gjithashtu për thirrjet për sqarimin e standardeve dhe rolin e organeve rregullatore (BIRN, 2026).

Korniza konceptuale

Ky kapitull paraqet konceptet dhe qasjen analitike të përdorura për të kuptuar se si të rinjtë në BP6 hasin, vlerësojnë dhe reagojnë ndaj informacionit të kontestuar. Në vend që dezinformimi të shihet thjesht si një “problem përmbajtjeje”, ai konsiderohet një aspekt i përhapur i mjedisve të përditshme të informacionit të të rinjve: i ndikuar nga dizajni i platformave, lidhjet shoqërore, besimi në institucione dhe peizazhi më i gjerë mediatik dhe i politikave.





3.1 Konceptet dhe përkufizimet kryesore

Studimi përdor përkufizimet e mëposhtme::

- **Keqinformimi:** Keqinformimi i referohet informacionit të verifikueshëm të pasaktë që shpërndahet pa qëllim për të mashtruar.
- **Dezinformimi:** Dezinformimi i referohet informacionit të verifikueshëm të pasaktë që shpërndahet me qëllim për të mashtruar dhe çorientuar.
- **Malinformimi:** Në disa raste, studimi merr në konsideratë edhe malinformimin – informacion që mashtron qëllimisht duke shtrembëruar kuptimin e informacionit të vërtetë.

Besimi është koncepti qendror organizues i këtij studimi: Ai përkufizohet si “besim se një burim, platformë ose pjesë përmbajtjeje është e sigurt, e besueshme dhe e shpërndarë në mirëbesim”.

Besimi mund të shprehet në tre nivele:

- **Besimi institucional**, i drejtuar ndaj mediave, qeverive, platformave ose organizatave.
- **Besimi ndërpersonal**, i bazuar në marrëdhëniet me bashkëmoshatarët, influencuesit ose anëtarët e familjes, dhe
- **Besimi situacional**, i cili ndryshon në varësi të temës, platformës ose kontekstit.

Gjatë gjithë raportit, këto koncepte trajtohen si praktike dhe kontekstuale. Të rinjtë nuk përballen me informacion në kategori të rregullta; ata navigojnë mes sinjaleve të përziera, përgjegjshmërisë së paqëndrueshme dhe nxitjeve të ndryshme nëpër platforma, media dhe rrjete ndërpersonale. Përkufizimet e mësipërme ofrojnë një pikë të qëndrueshme referimi për interpretim në vende dhe metoda të ndryshme.

3.2 Si i konceptojmë ne “mjediset e informacionit”

Mjediset e informacionit kuptohen si kushtet e përbashkëta që formësojnë atë që të rinjtë hasin, çfarë bëhet e dukshme dhe si formohen në praktikë gjykimet mbi besueshmërinë. Kjo përfshin mediat publike, infrastrukturën e platformave, hapësirat gjysmë-private (aplikacione mesazhesh, grupe të mbyllura), marrëdhëniet ndërpersonale dhe komunikimin institucional.

Për të strukturuar analizën e këtyre mjediseve, studimi adopton një model sjelljeje që e koncepton sjelljen digjitale si një sekuencë veprimesh të ndërlidhura: ekspozim → gjykim → besim → shpërndarje.

Raporti e përkufizon secilën fazë si më poshtë:

- **Ekspozimi:** Si të rinjtë e hasin informacionin online, përmes lajmeve, mesazheve direkte, bisedave në grup, influencuesve ose përmbajtjes së rekomanduar.
- **Angazhimi:** Si të rinjtë ndërveprojnë me përmbajtjen — duke lexuar, parë, komentuar, pëlqyer ose duke e injoruar atë.
- **Besimi (si fazë në model):** Si vlerësohet besueshmëria pasi një përdorues ndërvepron me përmbajtjen.
- **Shpërndarja (ose injorimi):** Rezultati i sjelljes: vendimi për ta shpërndarë, diskutuar, verifikuar ose injoruar një pjesë informacioni.

Ky model nxjerr në pah një pikë kyçe në analizën cilësore: gjykimet mbi besueshmërinë rrallë bëhen të izoluar. Ato ndikohen nga kushtet e ekspozimit (çfarë shfaqet dhe sa shpesh), toni dhe dinamika sociale e angazhimit (përfshirë komentet dhe reagimet e bashkëmoshatarëve), sinjalet e besimit në dispozicion (njerëz, media, platforma) dhe rezultatet e perceptuara të shpërndarjes ose kundërshtimit të përmbajtjes.

3.3 Besimi, sinjalet e besueshmërisë dhe vendimmarrja

Duke u mbështetur në kornizën fillestare, raporti e trajton besimin njëkohësisht si:

- a) një koncept të përcaktuar qartë, dhe
- b) një pikë vendimmarrjeje brenda sekuencës ekspozim–gjykim–besim–shpërndarje.

Në situata reale, të rinjtë shpesh bëjnë gjykime të shpejta mbi besueshmërinë, nën presionin e kohës dhe mbingarkesës. Për këtë arsye, ata mbështeten në “sinjale besueshmërie”: sinjale që i ndihmojnë ata të vendosin nëse diçka duket mjaftueshëm e besueshme për t’u pranuar, për t’u përdorur, për t’u injoruar apo për t’u shpërndarë.

Gjatë analizës cilësore, këto sinjale grupohen rreth tre pikave praktike referimi:

- **Sinjale të bazuara në burim:** kush e ka shpërndarë, nëse burimi shihet si “zyrtar”, i njohur apo i lidhur me një komunitet të besuar.
- **Sinjale të bazuara në përmbajtje:** nëse përmbajtja “përputhet” me kuptimin paraprak, duket e besueshme apo shfaq shenja manipulimi.
- **Sinjale sociale dhe të platformës:** si ndërveprojnë të tjerët me të (shpërndarjet, komentet, influencuesit) dhe si ndikojnë platformat në dukshmëri (rekomandime, trende, promovim i paguar).

Këto gjykime të bazuara në sinjale nuk janë thjesht tregues të “mirë” apo “të dobët” të edukimit mediatic. Ato janë përgjigje të përshtatura ndaj një mjedisi ku informacioni është i bollshëm, verifikimi është i kushtueshëm dhe besimi institucional mund të jetë i brishtë ose i kontestuar. Kur besimi institucional është i ulët, besimi ndërpersonal mund të bëhet zgjedhja e parazgjedhur. Në situata me polarizim të lartë, të rinjtë shpesh e interpretojnë informacionin më shumë përmes qëllimit të perceptuar (“agjendës”) sesa përmes provave. Në një mjedis të zhurmshëm dhe të ngarkuar emocionalisht, sinjalet që tërheqin vëmendjen mund të errësojnë sinjalet e besueshmërisë.

Kjo qasje ndihmon gjithashtu në shpjegimin e shmangies dhe mosangazhimit. Kur verifikimi kërkon kohë, përpjekje emocionale ose sjell konflikt social, “injorimi” mund të jetë një strategji racionale përballuese dhe jo një shenjë apatie. Kjo vihet re veçanërisht gjatë momenteve të një rëndësie të veçantë (zgjedhje, kriza, debate polarizuese), kur të rinjtë mund ta përjetojnë informacionin si të tepërt dhe të lodhshëm.

3.4 Çfarë shton ky studim (krahasuar me evidencën ekzistuese)

Studimi thellon të kuptuarit duke lidhur konceptet e njohura (keqinformimi, dezinformimi, malinformimi dhe besimi) me vendimmarrjen e të rinjve në jetën reale përmes metodave dhe vendeve të ndryshme, duke përdorur rrjedhën e sjelljes së raportit fillestar për të garantuar interpretim të qëndrueshëm.

Së pari, ai kap jo vetëm atë që të rinjtë thonë se “duhet” të bëjnë, por edhe atë që ata bëjnë realisht përgjatë rrjedhës ekspozim–angazhim–besim–shpërndarje, përfshirë kompromiset që bëjnë në kushte mbingarkese.

Së dyti, ai e trajton besimin si konceptin organizues dhe eksploron se si ai ndryshon në nivele institucionale, ndërpersonale dhe situacionale, në vend që të supozojë një marrëdhënie të vetme dhe të qëndrueshme besimi.

Së treti, ai forcon besueshmërinë përmes triangulimit. Siç theksohet në raportin fillestar, “Triangulimi do të kryhet në dy nivele”. Ai dallon:

- Konvergjencën, e cila rrit besimin kur tema të ngjashme shfaqen në burime të shumta të dhënash, dhe
- Divergjencën, e cila shënohet për interpretim të mëtejshëm (duke treguar dallime kontekstuale, variacione mes nën-grupeve ose kufizime metodologjike).

Kjo është e rëndësishme për raportin përfundimtar sepse trajton mospërputhjet ndërmjet metodave (për shembull, midis ekspozimit të perceptuar në ditarë dhe dukshmërisë në monitorimin publik të rrjeteve sociale) si elemente analitike të rëndësishme dhe jo si gabime që duhen zbutur.

Së fundi, studimi përfshin validimin pjesëmarrës në interpretim (siç përshkruhet diku tjetër në raport), duke ndihmuar që gjetjet të mos jenë vetëm rreth të rinjve, por të jenë edhe të informuara nga perspektivat dhe përvoja e tyre konkrete.

Së bashku, kjo kornizë konceptuale mbështet mesazhin kryesor të raportit:

Forcimi i qëndrueshmërisë së të rinjve nuk ka të bëjë vetëm me aftësitë individuale. Ai kërkon gjithashtu vëmendje ndaj mjediseve që ndikojnë në dukshmëri, normalizim dhe rreziqet reale të verifikimit, të shprehjes së qëndrimeve ose të mosangazhimit.

Metodologjia



4



4.1 Dizajni dhe qasja hulumtuese

Ky studim përdor një qasje cilësore me shumë metoda për të eksploruar se si të rinjtë e moshës 18–30 vjeç në të gjithë Ballkanin Perëndimor përballen, interpretojnë dhe reagojnë ndaj keqinformimit dhe dezinformimit në mjediset digjitale të përditshme. Metodologjia është qëllimisht e strukturuar në shtresa. Grupet e fokusit me të rinjtë dhe intervistat me aktorët kyç eksplorojnë se si besimi, besueshmëria dhe përgjegjësia ndikojnë në sjellje, ndërsa ditarët e rrjeteve sociale regjistrojnë ekspozimin dhe veprimet “në moment” ndërsa ndodhin. Një monitorim i lehtë i rrjeteve sociale ofron njohuri kontekstuale mbi peizazhin e informacionit që është i dukshëm për publikun gjatë të njëjtës periudhë. Në procesin hulumtues u integrua gjithashtu një shtresë validimi pjesëmarrës për të përmirësuar interpretimin, për të garantuar qëndrueshmëri me perspektivat e të rinjve dhe për të përkthyer të dhënat në pika veprimi praktike.

Logjika metodologjike ndjek një rrjedhë të qartë: **ekspozim** → **gjykim** → **veprim** → **ndikim**, duke marrë parasysh mekanizmat që ndikojnë në secilin hap (si heuristikat e besimit, vështirësitë e verifikimit, dinamika e amplifikimit të platformave dhe mbingarkesa emocionale). Kur metodat e ndryshme japin rezultate të ndryshme, këto mospërputhje konsiderohen si analitike të rëndësishme, jo si gabime.

4.2 Mbulimi sipas vendeve

Hulumtimi shqyrton gjashtë kontekste të Ballkanit Perëndimor: Shqipërinë, Bosnjën dhe Hercegovinën, Kosovën, Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut dhe Serbinë. Ekipet në secilin vend përdorën mjete dhe korniza raportimi të harmonizuara për të mundësuar krahasimin ndërmjet vendeve, duke ruajtur njëkohësisht detajet kontekstuale. Të gjitha materialet në nivel vendi u anonimizuan dhe u agreguan për analizë rajonale.

4.3 Burimet e të dhënave dhe metodat e mbledhjes së tyre

Diskutimet në grupe fokusi (FGD)

FGD-të u përdorën për të eksploruar gjuhën e përbashkët, normat dhe dinamikat sociale që lidhen me besueshmërinë, besimin, përdorimin e platformave dhe rutinat e informacionit. Ambienti në grup rezultoi veçanërisht i dobishëm për të kuptuar se si të rinjtë negociojnë kolektivisht kuptimin, si ndikimi i bashkëmoshatarëve formëson bindjet dhe shpërndarjen e informacionit, si dhe si formohen dhe qarkullojnë pretendimet normative (çfarë thonë të rinjtë se “duhet” të bëjnë).

Intervistat me informatorët kryesorë (KII)

KII-të u zhvilluan me aktorë të rritur dhe ekspertë për të mbledhur perspektiva në nivel sistemi në fusha si arsimi, media dhe gazetaria, institucionet dhe rregullatorët, shoqëria civile, verifikimi i fakteve dhe të drejtat digjitale. KII-të ndihmojnë në pozicionimin e përvojave të të rinjve brenda dinamikave më të gjera institucionale dhe të ekosistemit, si dhe mundësojnë triangulimin ndërmjet asaj që raportojnë të rinjtë dhe asaj që vëzhgojnë praktikuesit.

Ditarët e Rrjeteve Sociale (SMD)

Ditarët e rrjeteve sociale u krijuan për të dokumentuar ekspozimin dhe reagimet sa më afër kohës reale. Çdo hyrje në ditar u shndërrua në një “episod”, duke përfshirë platformën, llojin e përmbajtjes ose temën, vëmendjen dhe reagimin, gjykimin e besueshmërisë, veprimet e ndërmarra (për shembull, injorim, verifikim, shpërndarje, diskutim, raportim), si dhe sinjalet e besueshmërisë mbi të cilat u mbështet mbajtësi i ditarit. Ditarët i mundësojnë analizës të shqyrtojë hendekun midis normave të shprehura dhe sjelljes reale, përfshirë rastet kur dhe pse verifikimi bëhet selektiv, si dhe mënyrën se si humori dhe ndjenja e përkatësisë ndikojnë në shpërndarje.

Shënim për datasetin (pjesëmarrja në SMD): Në të gjithë skedarët e episodeve të përpiluara, numri i mbajtësve të ditarëve ndryshon sipas vendeve. Datasetet aktuale të episodeve përfshijnë gjashtëdhjetë e shtatë mbajtës ditarësh nga Bosnja dhe Hercegovina, Serbia, Maqedonia e Veriut, Shqipëria, Kosova dhe Mali i Zi. Vëllimi i episodeve gjithashtu ndryshon sipas vendeve, duke reflektuar nivelet e pjesëmarrjes dhe dendësinë e ditarëve, dhe jo dallime në “rëndësi”.

Monitorimi i Lehtë i Rrjeteve Sociale (LSL)

Monitorimi i lehtë i rrjeteve sociale u përdor si një mënyrë për të trianguluar kontekstin, me synimin për të identifikuar narrativat kryesore publike dhe trendet në platforma gjatë periudhës së hulumtimit. LSL-ja nuk imiton një feed të personalizuar individual; përkundrazi, ai ofron një pamje të strukturuar të asaj që është publikisht e dukshme në hapësira të kërkueshme dhe mënyrës se si qarkullojnë narrativat dhe formatet specifike. Në këtë studim, gjetjet e LSL-së u përfshinë si indikatorë kontekstualë krahas FGD-ve, KII-ve dhe evidencës nga ditarët.

Shënim për mbulimin (LSL): Rezultatet e LSL-së ishin të disponueshme për disa vende gjatë analizës, ndërsa për vende të tjera mbulimi ishte i pjesshëm për shkak të kufizimeve operacionale. Kur LSL-ja mungon ose është e kufizuar, kjo trajtohet në mënyrë të qartë si një kufizim dhe nuk e zhvlerëson përvojën e raportuar nga të rinjtë, e kapur përmes FGD-ve dhe ditarëve.

4.4 Përzgjedhja e kampionit dhe rekrutimi

Përzgjedhja e kampionit u hartua për të garantuar krahasueshmëri, duke kapur njëkohësisht një gamë të gjerë përvojash të të rinjve sipas gjinisë, gjeografisë dhe praktikave të përditshme digjitale. Të rinjtë u rekrutuan nga ekipet vendase përmes metodave të qëllimshme, për të garantuar një përzjerje të larmishme të formimeve arsimore dhe niveleve të angazhimit digjital. Informatorët kryesorë u përzgjedhën në bazë të relevancës së tyre për mjedisin informativ, mekanizmat e politikave dhe praktikave, si dhe afërsinë e tyre profesionale me çështjet që prekin të rinjtë.

Analiza ndan dy grupe pjesëmarrësish nga BP6: të rinjtë e moshës 18–30 vjeç (13 diskutime në grupe fokusi me 124 pjesëmarrës të rinj, si dhe ditarë të rrjeteve sociale me 67 pjesëmarrës të rinj; gjithsej 160 pjesëmarrës të rinj në të gjitha metodat për të rinjtë, përfshirë 109 gra/vajza, 50 burra/djem dhe 1 pjesëmarrës i regjistruar si i papërcaktuar) dhe aktorë të rritur/ekspertë (48 intervista me informatorë kryesorë me 48 pjesëmarrës, përfshirë 28 gra dhe 20 burra). Kjo strukturë lehtëson krahasimin midis përvojave të jetuara dhe njohurive në nivel sistemi.

4.5 Etika, mbrojtja dhe menaxhimi i të dhënave

Hulumtimi synon të reduktojë rrezikun dhe të garantojë privatësinë e pjesëmarrësve. Pjesëmarrja ishte vullnetare, me pëlqim të informuar dhe të gjitha materialet u anonimizuan. Transkriptet dhe shënimet e ditarëve janë anonimizuar, janë ruajtur në mënyrë të sigurt dhe janë përdorur vetëm për qëllimin e këtij studimi. Për shkak të ndjeshmërisë së disa temave (si polarizimi politik, narrativat e lidhura me identitetin dhe ngacmimi online), ndërmjetësuesit dhe intervistuesit përdorën gjuhë të përshtatshme për të rinjtë dhe shmangën ekspozimin e panevojshëm ndaj përmbajtjes së dëmshme.

Trajtimi i të dhënave ka ndjekur një rrjedhë të strukturuar pune: **mbledhja** → **transkriptimi dhe anonimizimi** → **kodimi dhe sinteza** → **triangulimi** → **validimi dhe zhvillimi i rekomandimeve**. Citimet e përdorura në raport janë përkthyer në gjuhën angleze dhe janë redaktuar vetëm për qartësi, ku ka qenë e nevojshme, duke ruajtur kuptimin; detajet identifikuese janë hequr.

4.6 Qasja analitike dhe triangulimi

Analiza ka kombinuar kodimin e strukturuar me sintezën tematike iterative. Materialet nga FGD-të dhe KII-të u koduan duke përdorur një manual kodimi ATLAS.ti (v2), duke mundësuar etiketim të qëndrueshëm të treguesve të besueshmërisë, sjelljeve, pengesave, emocioneve dhe dinamikave në nivel sistemi. Shënimet në ditar u shndërruan në episode dhe u analizuan si prova sjelljeje edhe si rrëfime narrative mbi mënyrën se si vlerësohet besueshmëria “në moment”. Regjistrat LSL u konsideruan si sinjale kontekstuale dhe u integruan aty ku ndihmojnë në interpretimin ose kualifikimin e ekspozimit të vetë-raportuar.

Temat u zhvilluan në mënyrë iterative, duke kaluar nga provat e koduara në pohime tematike fillestare, më pas duke testuar kufijtë dhe tensionet ndërmjet vendeve dhe metodave. Kuadri përfundimtar përbëhet nga shtatë tema kryesore dhe dy tema ose sinjale dytësore. Gjatë gjithë procesit, triangulimi shërben si parim udhëzues dhe jo si një listë kontrolli mekanike. Kur metodat përputhen, gjetja përforcohet. Kur metodat ndryshojnë, mospërputhja pranohet si një sinjal domethënës, për shembull hendeuku i përsëritur midis “verifikimit si normë” dhe verifikimit selektiv në ditarë, ose midis ekspozimit të perceptuar si “i pashmangshëm” dhe asaj që mund të vërehet në gjurmët publike.

Sinteza ndër-vendore mbështetet në një matricë krahasuese që gjurmon dukshmërinë relative të temave nëpër dataset-et kombëtare. Këto përmasa shërbejnë për të treguar theksin brenda korpusit të koduar, jo për të renditur “ashpërsinë” apo për të gjeneruar vlerësime të performancës.

4.7 Validimi i bazuar në pjesëmarrje dhe bashkëkrijimi

Studimi ka përfshirë një shtresë validimi të bazuar në pjesëmarrje, për të përmirësuar interpretimin, gjuhën dhe për të garantuar që rekomandimet të mbeten të bazuara në përvojat reale të të rinjve dhe të jenë praktike për profesionistët. Kjo shtresë nuk e ka zëvendësuar bazën e të dhënave; përkundrazi, ajo ka shërbyer si një mjet i strukturuar për verifikim kuptimor (sense-check) dhe përkthim.

Grupi Këshillimor Rinor (YAG)

Grupi Këshillimor Rinor (YAG; 12 anëtarë) ka ofruar një perspektivë të drejtpërdrejtë rinore mbi sintezën në zhvillim gjatë tre takimeve (16 dhjetor 2025; 15 janar 2026; 5 shkurt 2026).

Takimi hapës (16 dhjetor 2025) prezantoi studimin dhe rolin e YAG-ut, dhe shqyrtoi se si do të dukej “suksesi” dhe cilat grupe të rinjsh duhet të marrin vëmendje të veçantë. Në këtë diskutim, anëtarët e YAG-ut theksuan rëndësinë e mosanashkalimit të të rinjve nga komunitetet rurale, të rinjve NEET, minoriteteve, të rinjve jo-universitarë, të rinjve në arsimin e mesëm profesional dhe atyre që nuk janë të angazhuar në aktivitete jashtëshkollore apo qytetare. Takimi i dytë (15 janar 2026) rishikoi sintezën pilot (bazuar në një mostër të vogël nga dy vende dhe ende jo përfaqësuese) për të testuar nëse modelet e hershme “kishin kuptim” përpara kalimit në analizë të plotë.

Gjatë takimit të tretë të YAG-ut (5 shkurt 2026), anëtarët krahasuan draftin e shtatë temave kryesore dhe dy temave dytësore, identifikuan atë që “tingëllon e vërtetë”, nxorën në pah atë që dukej e munguar ose e tepruar dhe ndihmuan në qartësimin e tensioneve kyçe, veçanërisht hendekun midis asaj që të rinjtë thonë se bëjnë dhe asaj që tregojnë ditarët në praktikë. Seanca shërbeu gjithashtu si një kontroll i hershëm realiteti mbi rekomandimet, duke u përqendruar në dobishmërinë dhe realizueshmërinë e tyre.

Sesionet “Ndalo & Mendo”

Studimi përfshiu gjithashtu aktivitete “Ndalo & Mendo” si momente reflektimi të strukturuar për të testuar kornizimin e hershëm, gjuhën e ndjeshme ndaj të rinjve dhe relevancën praktike të njohurive të reja. Këto sesione shërbyen si një mekanizëm i shpejtë reagimesh, duke i mundësuar ekipit hulumtues të përmirësojë mënyrën se si komunikohen temat dhe cilat sjellje dhe kufizime të përditshme duhen nxjerrë në pah. Në total, u zhvillua një sesion në grup “Ndalo & Mendo”, i plotësuar nga disa konsultime individuale gjatë ofrimit të informacionit (përfshirë konsultime iterative me bashkëbisedues kyçë) për të testuar në mënyrë kritike gjetjet dhe rekomandimet e reja.

Tryeza rajonale për bashkëkrijimin e politikave

Një tryezë rajonale për bashkëkrijimin e politikave u përdor për të vlerësuar implikimet dhe për të identifikuar pika të realizueshme ndërhyrjeje. Tryeza u organizua më 10 shkurt 2026 dhe mbledhi 13 pjesëmarrës. Ajo synoi të përkthente gjetjet në rekomandime praktike me përgjegjësi më të qartë ndërmjet grupeve të interesit (arsimi, media, platformat, institucionet dhe shoqëria civile). Gjithashtu, ajo ndihmoi në përmirësimin e ekuilibrit midis mbështetjes për të rinjtë dhe masave të llogaridhënies në nivele më të larta.

Integrimi në analizë ishte i qëllimshëm: të dhënat e validimit u përdorën për të përmirësuar kufijtë e temave, për të pasuruar përshkrimin e mekanizmave dhe tensioneve, si dhe për të përmirësuar hartimin e realizueshmërisë. Validimi nuk solli pretendime të reja pa mbështetje në të dhënat bazë.

4.8 Kufizimet

Gjatë interpretimit të gjetjeve duhen marrë në konsideratë disa kufizime.

Së pari, ekziston variacion në plotësinë dhe qëndrueshmërinë e shënimeve të ditarit të rrjeteve sociale (SMD) midis pjesëmarrësve dhe vendeve, gjë që ndikon në sigurinë me të cilën mund të krahasojmë modelet ose të nxjerrim përfundime mbi frekuencën. Pjesëmarrja në ditar dhe dendësia e episodeve ndryshojnë sipas kontekstit dhe kjo duhet parë si një kufizim i provave të sjelljes dhe jo si një ndryshim thelbësor në përvojën e të rinjve. Së dyti, efektet kohore janë të rëndësishme. Mbledhja e të dhënave u zhvillua paralelisht me ngjarje të ndryshme kombëtare dhe rajonale, trende të platformave dhe cikle lajmesh, të cilat mund të kenë ndikuar në atë që pjesëmarrësit përjetuan, vëzhguan apo vendosën të regjistronin.

Së treti, dallimet në profilet e qasjes në platformë dhe përdorimit ndikojnë në ekspozim. Nëse pjesëmarrësit kishin llogari, sa aktivisht përdornin platforma të caktuara dhe çfarë përmbajtjeje u shfaqnin algoritmet, do të thotë se ekspozimi nuk është uniform; në mënyrë të ngjashme, monitorimi i lehtë i rrjeteve sociale kap vetëm gjurmë publike dhe të kërkueshme dhe nuk mund të vëzhgojë me besueshmëri hapësira private ose gjysmë-private (aplikacione mesazhesh, grupe të mbyllura) ku qarkullojnë disa narrativa. Si rezultat, ekspozimi i perceptuar si “i pashmangshëm” mund të mos jetë gjithmonë i dukshëm përmes monitorimit publik.

Së katërti, përzgjedhja e pjesëmarrësve ishte e qëllimshme, në përputhje me kriteret praktike të pranueshmërisë dhe në përputhje me qasjen në terren. Kjo do të thotë se mostra mund të anojë drejt të rinjve që janë relativisht aktivë në jetën qytetare ose komunitare dhe, në disa raste, tashmë të lidhur me aktivitetet apo rrjetet e BIRN-it ose British Council-it. Profili gjithashtu priret të përfshijë pjesëmarrës me nivele më të larta arsimimi formal (shpesh të paktën studime bachelor). Kjo nuk i zhvlerëson gjetjet, por mund të nënpërfaqësojë përvojat e të rinjve më pak të lidhur ose me arsimim formal më të ulët dhe duhet pasur parasysh gjatë interpretimit të përhapjes ose përgjithësueshmërisë së disa modeleve.

Në fund, si në çdo studim mbi tema të ndjeshme, ekziston rreziku i paragjykitimit të dëshirueshmërisë sociale në diskutimet në grup dhe intervista. Dizajni e redukton pjesërisht këtë rrezik përmes triangulimit me ditarë dhe monitorimit kontekstual, por nuk mund ta eliminojë plotësisht.

Këta faktorë nuk e dëmtojnë vlefshmërinë e gjetjeve, por kërkojnë një interpretim të kujdesshëm – veçanërisht kur bëhet dallimi midis asaj që duket e zakonshme dhe asaj që mund të ndikohet nga pjesëmarrja e pabarabartë, koha ose dinamikat specifike të platformave.

Mjediset e informacionit për të rinjtë në BP6



Mjediset e informacionit për të rinjtë në BP6 formësohen nga një kombinim i dizajnit të platformave, lidhjeve sociale dhe rrjedhave të përmbajtjes me volum të lartë. Të rinjtë përshkruajnë lëvizje të shpejta nëpër hapësira të ndryshme (platforma publike, grupe gjysmë-private dhe mesazhe private), me feeds që janë gjithnjë e më të personalizuar dhe “gjithnjë aktive”. Në këto mjedise, ekspozimi rrallë është i qëllimshëm: ajo që bëhet e dukshme ndikohet shumë nga sistemet e rekomandimit, përmbajtja e paguar dhe sinjalet e angazhimit si komentet dhe shpërndarjet.

Ky kapitull ofron një pasqyrë përshkruese të kushteve të përditshme ku ndeshet (keqinformimi/dezinformimi). Ai mbështetet në një shqyrtim dokumentesh për të vendosur kontekstin, ndërsa gjetjet tematike në Kapitujt 6–8 bazohen në të dhëna cilësore dhe janë trianguluar nëpërmjet diskutimeve të grupeve të fokusit, intervistave me aktorë kyç dhe analizave të rasteve të studimit.



5



5.1 Platformat dhe aksesit

Të rinjtë zakonisht operojnë nëpër disa platforma dhe jo vetëm në një të vetme. Modelet e tyre të përdorimit ndikohen nga komoditeti, zakoni dhe rëndësia e perceptuar, ku platforma të ndryshme plotësojnë role të ndryshme (për shembull, argëtim i shkurtër, përditësime lajmesh, diskutime komunitare ose koordinim privat). Qasja ndikohet gjithashtu nga kufizimet e pajisjeve dhe të dhënave, të cilat mund të ndikojnë në varësinë e tyre nga formatet mobile-first dhe të lehta për përdorim.

Një tipar kyç i aksesit është përzierja e hapësirave publike dhe private. Përveç platformave kryesore, kanalet private ose gjysmë-private (aplikacione mesazhesh, grupe të mbyllura, postime të dërguara) përdoren gjerësisht për lidhje sociale dhe shpërndarje të shpejtë. Këto hapësira mund të jenë më të besueshme dhe të funksionojnë më shpejt, por janë më pak transparente dhe të gjurmueshme, gjë që ndikon në mënyrën se si ndahen pretendimet dhe sa lehtësisht mund të verifikohen ato.

Këto modele aksesit ndihmojnë për të shpjeguar pse ekspozimi shpesh përshkruhet si “i pashmangshëm” dhe pse dukshmëria mund të ndryshojë midis asaj që individët shohin në feed-et e tyre dhe asaj që mund të vërehet në të dhëna publikisht të disponueshme.

5.2 Formatet dhe rrugët e përmbajtjes

Përmbajtja gjendet shpesh në formate të kompresuara dhe shumë të shpërndashme: video të shkurtra, meme, screenshot-e, mbishkrime mbi imazhe dhe fragmente të prera. Këto formate përhapen shpejt sepse janë të lehta për t'u konsumuar dhe shpërndarë, por shpesh e shkëpusin pretendimin nga konteksti i tij (burimi, koha, korniza origjinale). Si rezultat, interpretimi shpesh varet nga tregues sipërfaqësorë (prezantimi, stilizimi “zyrtar”, numri i ndjekësve) ose nga tregues socialë (kush e ka shpërndarë, si reagojnë të tjerët).

Rrugët drejt feed-eve të të rinjve nuk kufizohen vetëm te “kërkimi i lajmeve”. Ekspozimi mund të ndodhë përmes përmbajtjes argëtuese, influencuesve dhe krijuesve, postimeve të rekomanduara dhe polemikave të amplifikuara algoritmikisht. Përmbajtja e sponsorizuar dhe reklamat politike mund të shfaqen gjithashtu përkrah përmbajtjes së përditshme, ndonjëherë pa etiketim të qartë ose me ndërjegjësim të kufizuar të përdoruesve mbi mënyrën se si funksionon targetimi.

Kur pretendimet qarkullojnë nëpër kanale të mbyllura, si mesazhet e përcjella dhe bisedat në grup, vlerësimi i origjinës bëhet veçanërisht i vështirë. Në këto raste, vetë rruga mund të shërbejë si tregues besueshmërie: “erdhi nga dikush që e njoh” mund të ketë më shumë peshë sesa burimi origjinal.

5.3 Dinamikat e bashkëmoshatarëve, krijuesve dhe komunitetit

Rrjetet e bashkëmoshatarëve mbeten thelbësore për mënyrën se si kuptohet dhe shpërndahet informacioni. Shpërndarja është shpesh më shumë sociale sesa informative: përcjellja mund të përfaqësojë përkatësi, humor, identitet ose pjesëmarrje në një bisedë grupi. Kjo mund të krijojë një “shtresë qarkullimi” ku përmbajtja përhapet edhe kur besimi është i pjesshëm, i pasigurt ose mungon.

Krijuesit dhe influencuesit veprojnë gjithashtu si ndërmjetës brenda mjediseve informative. Për disa të rinj, krijuesit perceptohen si më të afërt ose më “realë” sesa institucionet formale, veçanërisht kur këto të fundit shihen si të ngadalta, politike ose jokonsistente. Në të njëjtën kohë, ekosistemet e drejtuara nga krijuesit formësohen nga stimujt e angazhimit, dhe të rinjtë e përfshirë në kërkim shpesh vënë re se polemikat, sensacionalizmi dhe polarizimi mund të shpërblehen me dukshmëri më të lartë.

Dinamikat e komunitetit janë veçanërisht të dukshme në seksionet e komenteve dhe hapësirat në grup. Komentet mund të shërbejnë si provë sociale (duke pohuar, sfiduar ose riinterpretuar një pretendim), por ato gjithashtu mund të shtrembërojnë kuptimin përmes konfliktit, mesazheve të koordinuara ose toksicitetit. Në praktikë, komentet shpesh përdoren si një tregues i shpejtë, sidomos kur koha ose motivimi për verifikim është i kufizuar.

5.4 Peizazhi i besimit

Besimi rrallë shprehet si një besim i pakushtëzuar ndaj një institucioni apo burimi të vetëm. Në vend të kësaj, vlerësimet e besueshmërisë shpesh kalojnë përmes rrjeteve të besimit social dhe treguesve të ndërmjetëm. Të rinjtë shpesh përshkruajnë mbështetjen tek individë të besuar (miq, familjarë, mësues, gazetarë të njohur) dhe faqe të njohura, veçanërisht kur e perceptojnë mjedisin më të gjerë si konfuz apo të manipuluar.

Treguesit e besueshmërisë janë shpesh praktikë më shumë sesa ideologjikë: markimi i njohur, paraqitja “me pamje zyrtare”, sinjalet e ngjashme me verifikimin dhe angazhimi i lartë mund të perceptohen si shenja legjitimiteti, edhe pse këta tregues nuk janë gjithmonë të besueshëm. Kur besimi tek institucionet është i ulët, të rinjtë mund t'i drejtohen besimit ndërpersonal (“dikush do të më tregonte nëse do të ishte e pavërtetë”) ose ta shmangin fare (“e injoroj sepse është e lodhshme”).

Ky peizazh besimi ka rëndësi sepse ndikon jo vetëm në atë që besohet, por edhe në atë që shpërndahet, injorohet apo hidhet poshtë si “thjesht përmbajtje”. Ai gjithashtu shpjegon pse zgjidhjet e bazuara vetëm në përgjegjësinë individuale (“verifiko gjithçka”) mund të duken jopraktike në mjedise me volum të lartë.

5.5 Momente rreziku dhe tema me intensitet të lartë

Rreziku rritet gjatë momenteve të një intensiteti të lartë, kur vëmendja shtohet dhe pasiguria është më e madhe. Të rinjtë raportojnë rritje të ekspozimit gjatë periudhave politikisht të ngarkuara, krizave dhe çështjeve sociale polarizuese. Në këto kohë, feed-et mund të duken të mbingarkuara, emocionalisht intensive dhe më të vështira për t'u menaxhuar, me më shumë përmbajtje sensacionale, akuza dhe narrativa mobilizuese.

Temat me intensitet të lartë kanë gjithashtu më shumë gjasa të nxisin shpërndarje të shpejtë, reagime emocionale më të forta dhe konflikt në komente apo hapësira në grup. Kjo rrit gjasat që vlerësimet e besueshmërisë të bëhen shpejt, të delegohen te treguesit socialë, ose të zëvendësohen nga shmangia për të mbrojtur mirëqenien. Në praktikë, “momentet e rrezikut” nuk kanë të bëjnë vetëm me vetë përmbajtjen, por edhe me ritmin dhe presionin e mjedisit: volumni, shpejtësia, nxitësit emocionalë dhe kapaciteti i reduktuar për verifikim.

Këto kushte ndihmojnë të kuptohet pse disa të rinj bëhen tepër vigjilentë ose shqetësohen, ndërsa të tjerë shkëputen ose e trajtojnë përmbajtjen si argëtim—reagime që mund ta zvogëlojnë dëmin në nivel individual, por të krijojnë dobësi në nivel kolektiv.



Gjetjet: Shtatë temat kryesore



Shtatë temat kryesore në këtë kapitull shpjegojnë se si të rinjtë në BP6 lundrojnë në mjediset e përditshme informative, të formësuara nga marrëdhëniet sociale, dizajni i platformave dhe përgjegjshmëria e pabarabartë. Ndërsa secila temë prezantohet veçmas, ato janë të lidhura ngushtë në praktikë. Besimi shpesh kalon përmes njerëzve dhe burimeve të njohura (Tema 1), ndërsa verifikimi shihet si punë dhe për këtë arsye është selektiv ose i deleguar (Tema 2). Sistemet e platformave më pas ndikojnë në atë që bëhet e dukshme dhe haset vazhdimisht, duke formësuar perceptimet mbi atë që duket “normale” ose e pashmangshme (Tema 3). Këto dinamika prodhojnë efekte të rëndësishme të rendit të dytë. Shpërndarja mund të funksionojë si humor ose si ndjenjë përkatësie, dhe jo domosdoshmërisht si mbështetje, por gjithsesi amplifikon përmbajtjen përmes rrjeteve dhe sinjaleve të angazhimit (Tema 4). Me kalimin e kohës, ekspozimi me volum dhe intensitet të lartë mund të çojë në emocione si konfuzion, ankth dhe tërheqje (Tema 5). Si përgjigje, shumë të rinj ia atribuojnë përgjegjësinë faktorëve në nivele më të larta, duke kërkuar standarde më të mira, zbatim më të fortë dhe përgjegjshmëri të platformave, në vend që ta vendosin të gjithë barrën mbi individët (Tema 6). Si përfundim, ata e shohin edukimin mediatik dhe informativ si një infrastrukturë ndërbreznore: diçka që duhet të mbështetet nga shkollat, familjet dhe komunitetet, dhe të përditësohet ndërsa mjedisi ndryshon (Tema 7).

Në këtë kapitull, dallimet midis metodave konsiderohen si të rëndësishme nga ana analitike. Kur ajo që thonë të rinjtë nuk përputhet plotësisht me atë që regjistrohet në ditarë ose gjatë monitorimit të lehtë të rrjeteve sociale, kjo nuk shihet si gabim. Përkundrazi, shpesh nxjerr në pah një mekanizëm kyç, si hendeku midis normave dhe sjelljes, ose kufizimet e asaj që mund të vërehet në hapësirat publike krahasuar me feed-et private dhe të personalizuar.



6.1 Tema 1

Besimi përhapet përmes njerëzve (prova sociale si rruga më e zakonshme drejt besueshmërisë)

Të rinjtë shpesh vendosin nëse një përmbajtje është e besueshme bazuar në faktin se kush e ka shpërndarë ose kush duket se qëndron pas saj, duke u mbështetur në sinjale të ndërmjetme besimi përpara (dhe ndonjëherë në vend të) vlerësimit të provave.



Çfarë do të thotë

Kjo temë e trajton besueshmërinë si një gjykim social. Në vend që të vlerësojnë drejtpërdrejt pretendimet, shumë të rinj mbështeten në sinjale si familjariteti, reputacioni, ekspertiza e perceptuar dhe “zyrtarizmi”. Besimi shpesh i atribuohet një personi, një faqeje ose një burimi të njohur dhe më pas përhapet në rrjete përmes rishpërndarjeve, rekomandimeve dhe bisedave në grup.

Kjo është e rëndësishme sepse të njëjtat sinjale që i ndihmojnë të rinjtë të përballojnë flukset e mëdha të informacionit mund të manipulohen. Kur besimi është “i transportueshëm”, ai mund të huazohet, imitohet ose zgjerohet në shkallë të gjerë.

Si funksionon

Në praktikë, tre dinamika i shtyjnë gjykimet e besueshmërisë drejt rrugëve të shkurtra sociale.

Së pari, vëllimi dhe shpejtësia e informacionit e bëjnë verifikimin e kujdesshëm të duket i lodhshëm dhe që merr kohë. Shumë pjesëmarrës përshkruan nevojën për të vendosur shpejt çfarë të injorojnë, çfarë të shohin dhe çfarë të shpërndajnë.

Së dyti, besueshmëria shpesh “huazohet” nga individë dhe marka. Miqtë e njohur, figurat publike të respektuara (përfshirë gazetarë ose profesorë) dhe llogaritë që duken zyrtare ose të prodhuara profesionalisht mund të shërbejnë si pika ancorimi për besimin.

Së treti, përsëritja mund të perceptohet si konfirmim. Përsëritja e të njëjtit pretendim në disa faqe ose burime mund të shihet si siguri shtesë, edhe nëse informacioni bazë nuk është verifikuar.

Dëshmitë

Dëshmitë prezantohen në tre këndvështrime plotësuese: çfarë thanë pjesëmarrësit në grupet e fokusit dhe intervistat, çfarë regjistruan të rinjtë në praktikë përmes ditareve të rrjeteve sociale dhe çfarë ishte e dukshme në mjedisin e informacionit për publikun e gjerë gjatë të njëjtës periudhë. Kjo strukturë lejon krahasimin midis qëndrimeve të raportuara, sjelljes së vëzhguar dhe mjedisit më të gjerë të informacionit.

Çfarë dëgjuam (FGD/KII)

Nëpër grupet e fokusit dhe intervistat, pjesëmarrësit vazhdimisht e përshkruanin “kush e postoi” si një filtër të hershëm për besueshmërinë. Shenjat e besimit përfshinin identitetin e personit që e shpërndante, statusin e perceptuar të folësit dhe nëse llogaria dukej zyrtare apo e konsoliduar.

“Për mua, është shumë e rëndësishme se kush po e ndan atë. Nëse shoh një lajm që dikush që ndjek e ka ndarë, për mua ka rëndësi se kush e ka ndarë atë.” (REG, FGD)

“Unë i besoj Klodiana Lalës sepse ajo ka shumë peshë si gazetare në Shqipëri.” (ALB, FGD)

“Duhet të kesh kujdes: disa njerëz flasin për tema të caktuara pa qenë fare në atë fushë.

Pastaj e kupton se ata nuk mund të ofrojnë besueshmërinë që të nevojitet.” (KOS, FGD)

“Nëse një profesor nga fakulteti im e shpërndan atë, do të kem më shumë besim se ai është i saktë, sepse i besoj atij personi, por sigurisht që do ta kontrolloj përsëri.” (REG, FGD)

Çfarë pamë në praktikë

Episodet e ditareve tregojnë se besimi indirekt funksionon si një rregull “në moment”. Pjesëmarrësit shpesh e gjykonin besueshmërinë bazuar tek identiteti i llogarisë (p.sh., faqe zyrtare, burim i njohur, vend i njohur) dhe pastaj ndërvepronin me përmbajtjen (duke parë, pëlqyer, ruajtur, shpërndarë) pa verifikim të mëtijshëm.

- Në Bosnjë dhe Hercegovinë, një pjesëmarrës/e pa dhe shpërndau një video të shkurtër nga një klub futbollit, duke deklaruar hapur besimin sepse ajo video ishte postuar në faqen zyrtare të klubit. (SMD, Bosnjë dhe Hercegovinë)
- Në Serbi, një pjesëmarrës/e ndërveproi me një njoftim ngjarjeje dhe deklaroi se i besonte, sepse ai ishte një “njoftim zyrtar” nga vendi ku do të mbahej ngjarjeje, duke ruajtur dhe pëlqyer postimin. (SMD, Serbi)
- Në Shqipëri, një pjesëmarrës/e pa një video të shkurtër në Instagram dhe deklaroi qartë besimin e tij, sepse ajo ishte postuar nga një faqe mediatike zyrtare (“Po, sepse ishte postuar nga faqja zyrtare e TV Klan”) dhe më pas ndërveproi duke pëlqyer postimin dhe duke hapur komentet. (SMD, Shqipëri)

“Për mua, është shumë e rëndësishme se kush po e ndan atë. Nëse shoh një lajm që dikush që ndjek e ka ndarë, për mua ka rëndësi se kush e ka ndarë atë.”

REG, FGD

Çfarë ishte e dukshme në mjedisin më të gjerë të informacionit

Monitorimi i lehtë i rrjeteve sociale (LSL) forcon idenë se sa fort “shtresa e llogarisë” ndikon në dukshmërinë dhe interpretimin e përmbajtjes. Përmbajtjet me angazhim të lartë shpërndahen shpesh në formate natyrore për platformat (video të shkurtra, meme, zinxhirë ripostimesh), ku burimi përfaqësohet kryesisht nga një emër përdoruesi, identiteti i një faqeje ose prezantimi “në stil lajmesh” dhe jo përmes një publikuesi të qartë.

Puna në terren me LSL-në gjithashtu zbuloi një kufizim praktik: është e vështirë të riprodhosh feed-et reale të të rinjve me llogari të reja. Llogaritë e reja zakonisht përmbanin kryesisht përmbajtje ndërkombëtare, duke e drejtuar vëmendjen te kërkimet me hashtag, në vend të faqeve dhe njerëzve lokalë që formësojnë ekspozimin e përditshëm. Kjo ka rëndësi sepse sinjalet që të rinjtë përmendin më shpesh – njerëz të njohur, faqe lokale dhe krijues të njohur – janë pikërisht elementët që shihen më pak nga një llogari e re. (Vëzhgime nga puna në terren me LSL-në, Mali I Zi).

Modelet dhe dallime ndërmjet vendeve

Në të gjithë BB6, besimi indirekt ngjan si një rrugë e shkurtër logjike. Identiteti, familjariteti, ekspertiza e perceptuar, “zyrtarizmi”, popullariteti dhe përsëritja shërbejnë si pika ankorimi për besueshmërinë, veçanërisht kur ka presion kohor.

Në të njëjtën kohë, këto sinjale janë të paqëndrueshme. Popullariteti dhe prezantimi profesional mund të japin siguri, por gjithashtu mund të ngjallin dyshime (p.sh., dyshime për promovime të paguara ose përcaktim agjendash). Dëshmitë gjithashtu tregojnë një hendek midis normave dhe sjelljes së përditshme: të rinjtë shpesh e përshkruajnë kontrollin e informacionit si një parim, por ditarët tregojnë se kontrolli është selektiv dhe më i mundshëm kur një postim duket personalisht i rëndësishëm ose i rrezikshëm.

Pse ka rëndësi kjo

Nëse besueshmëria lidhet me identitetin dhe provat sociale, atëherë ajo mund të fabrikohet. Kjo paraqet një dobësi strukturore në peizazhin e informacionit: problemi nuk është vetëm që “të rinjtë nuk kontrollojnë”, por edhe se besimi mund të transferohet, huazohet dhe zgjerohet. Prandaj, ndërhyrjet duhet të shkojnë përtej thjesht inkurajimit të verifikimit individual. Ato duhet të rrisin aftësinë për të kuptuar sinjalet e besueshmërisë, të mbështesin integritetin e llogarive dhe identiteteve, dhe të rrisin disponueshmërinë e burimeve të besueshme në formatet dhe hapësirat ku krijohet besimi.

6.2 Tema 2

Kontrolli kërkon punë, prandaj i delegohet të tjerëve (vështirësia e verifikimit)

Verifikimi njihet gjerësisht si i rëndësishëm, por përjetohet si i lodhshëm dhe kërkon shumë kohë, ndaj të rinjtë shpesh e delegojnë këtë teknjerëz të besuar, mbështeten te sinjale “mjaftueshëm të mira” ose kontrollojnë vetëm kur gjërat duken me rrezik të lartë.



Çfarë do të thotë

Kjo temë thekson hendekun midis idealit (“duhet të kontrollosh”) dhe praktikës reale (“rrallë kam kohë ose mjete”). Të rinjtë e përshkruan verifikimin si diçka që kërkon vëmendje, aftësi dhe motivim–burime që shpesh nuk janë të disponueshme në feed-et e shpejta dhe rutinat e ngarkuara. Si rezultat, kontrolli zakonisht është selektiv: ai ndodh më shpesh kur një temë duket personale, me rrezik ose e rëndësishme.

Kjo ka rëndësi sepse vështirësia e verifikimit nuk çon vetëm në “konsum pasiv”. Ai ndikon se cilat pretendime pranohen automatikisht, cilat narrativa përhapen shpejt dhe cilat rreziqe injorohen sepse nuk shkaktojnë një reagim “me rrezik të lartë”.

Si funksionon

Vështirësia e verifikimit lind nga tre kufizime të ndërlidhura. Së pari, koha dhe ngarkesa njohëse: kontrolli bie në konflikt me punën, studimet dhe jetën e përditshme. Kur ndihesh i mbingarkuar, një zgjedhje më praktike shpesh është të vazhdosh para në vend që të hetosh.

Së dyti, besimi në aftësi dhe mjete: disa pjesëmarrës mund të përshkruanin sjellje bazike të kontrollit (kërkimi, krahasim burimesh), por shumë thanë se nuk kishin një metodë të qartë ose nuk ishin të sigurt se cilat mjete të përdornin dhe se si. Së treti, delegimi te të tjerët si një rrugë praktike e shkurtër: kur janë të pasigurt, të rinjtë shpesh u drejtohen bashkëmoshatarëve të besuar, familjarëve ose “dikujt që do ta dinte”, veçanërisht për temat që nuk ndihen të sigurt për t'i vlerësuar vetëm.

Dëshmitë

Çfarë dëgjuam (FGD/KII)

Në grupet e fokusit, pjesëmarrësit shpesh e shohin verifikimin si të kushtëzuar: ata e vlerësojnë atë, por kryesisht e nisin vetëm kur gjejnë se diçka ka rëndësi. Një pjesëmarrës në Bosnje dhe Hercegovinë shpjegoi se ata vlerësojnë kur një çështje është e rëndësishme, por përmbajtjen “banale” e konsiderojnë si diçka që nuk ia vlen munda: *“Varet çfarë lloj informacioni është. Nëse është diçka me të vërtetë e rëndësishme—për shtetin ose për gjëra që vendosin për jetën tonë—atëherë, sigurisht, duhet të verifikohet. Por statistikat dhe fakte interesante zakonisht i marrim të mirëqena dhe vazhdojmë përpara.”* (BiH, FGD)

Në Serbi, një pjesëmarrës/e përshkroi se përpiqet të kuptojë pse e beson ose nuk e beson diçka, por se i mungonte një mënyrë e besueshme për të verifikuar saktësinë:

“Përpiqem ta filtroj dhe të gjej një arsye pse e besoj ose nuk e besoj. Por nuk kam një mënyrë të veçantë për të përcaktuar nëse informacioni është i saktë, sidomos kur nuk ka një mënyrë të qartë për ta bërë këtë.” (SRB, FGD) Delegimi i verifikimit bëhet i dukshëm kur ekziston pasiguria. Një pjesëmarrës/e në Mal të Zi shpjegoi se ata i lënë mënjanë gjërat me rëndësi të ulët, por konsultohen me të tjerët kur diçka duket e rëndësishme: *“Kur nuk jam i/e sigurt, shpesh bëhet fjalë për gjëra që nuk janë shumë të rëndësishme, kështu që thjesht i lë mënjanë. Por nëse diçka ka vërtet rëndësi, përpiqem ta zbuloj. Ia dërgoj të tjerëve për të parë nëse kanë informacion më të saktë.”* (MNE, FGD)

Çfarë pamë në praktikë

Episodet e ditarit tregojnë se verifikimi shpesh ndodh gjatë shfletimit të përditshëm si një “kontroll i shpejtë” dhe jo si një proces formal. I njëjti/E njëjta pjesëmarrës/e mund të verifikojë një informacion në një rast dhe të mos e bëjë në një tjetër, në varësi të emocioneve, rëndësisë dhe perceptimit të rrezikut.

- Në Serbi, një pjesëmarrës/e hasi një postim që pretendonte se ari kishte arritur një nivel të ri rekord dhe përmendi nevojën për të kontrolluar dy herë online para se të vendoste çfarë të besonte: ai/ajo “u shokua” dhe e ndau këtë me një mik pas verifikimit. (SMD, SRB)
- I njëjti/E njëjta pjesëmarrës/e ndau një klip politik edhe pse nuk kontrolloi kontekstin e plotë: “Po, edhe pse nuk e kontrollova videon e plotë...” dhe më pas ua dërgoi atë miqve të tij/të saj. Kjo tregon se si shpejtësia dhe humori/absurditeti mund të anashkalojnë qëllimet për verifikim. (SMD, SRB)
- Në Mal të Zi, një pjesëmarrës/e përshkroi një klip “shpjegues lajmesh” si miks ose të pasigurt, duke theksuar se do t’i besonte më shumë nëse ai/ajo do t’i referohej burimeve primare dhe më pas do të ndërmernte një veprim pasues, në vend që ta pranonte atë siç dukej. (SMD, MNE)
- Në Kosovë, një pjesëmarrës/e pa një video në TikTok që pretendonte se çmimet e energjisë elektrike do të rriteshin përsëri, shprehu pasiguri sepse nuk kishte një “burim zyrtar” dhe më pas kontrolloi një faqe lokale lajmesh para se të vendoste të mos e shpërndante videon. (SMD, KOS)
- Në Maqedoninë e Veriut, një pjesëmarrës/e hasi një postim në Facebook mbi sistemin e ardhshëm “Qytet i Sigurt” dhe gjobat e trafikut, dhe e verifikoi informacionin duke kontrolluar shpejt faqen zyrtare të Ministrisë së Punëve të Brendshme. (SMD, NM)

“Varet çfarë lloj informacioni është. Nëse është diçka me të vërtetë e rëndësishme—për shtetin ose për gjëra që vendosin për jetën tonë—atëherë, sigurisht, duhet të verifikohet. Por statistikat dhe fakte interesante zakonisht i marrim të mirëqena dhe vazhdojmë përpara.”

BIH, FGD

Çfarë ishte e dukshme në mjedisin më të gjerë të informacionit

Vëzhgime në terren të LSL-së gjithashtu theksojnë se verifikimi mund të kufizohet nga dukshmëria në platformë dhe kushtet e kërkimit. Në Mal të Zi, hulumtuesi vuri re se llogaritë e reja nuk nxirrnin shumë përmbajtje lokale dhe se vëzhgimi varej shumë nga kërkimet me hashtag. Ai gjithashtu përmendi pasiguri gjatë kodimit të “statusit të verifikimit” për përmbajtje argëtuese që nuk mund të kontrollohej lehtësisht, shpesh duke e shënuar si “e pa verifikuar”. Kjo nxjerr në pah një pikë më të gjerë: në shumë formate të përditshme (meme, trende, satirë), “kontrolli” nuk është i thjeshtë dhe linja midis “të padëmshmes” dhe “të dëmshmes” nuk është gjithmonë e qartë në momentin e ekspozimit. (vëzhgime në terren të LSL-së, MNE)

Modelet dhe tensionet rajonale

Në të gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor (BB6), vështirësitë në verifikim shfaqen në mënyrë të qëndrueshme si një mekanizëm: të rinjtë mbajnë një normë për të kontrolluar informacionin, por e praktikojnë këtë kontroll në mënyrë selektive.

Një nga tensionet kryesore është se “rëndësia” është subjektive dhe shpesh vendoset shpejt. Disa përmbajtje konsiderohen me rrezik të ulët deri sa papritmas nuk janë më — veçanërisht gjatë krizave ose momenteve polarizuese. Një tension tjetër është se delegimi i verifikimit mund të minimizojë dëmin, por gjithashtu mund ta rrisë atë: kërkimi i këshillave nga individë të besuar mund të veprojë si një rrjet sigurie, por mund të përshpejtojë përhapjen nëse personi i besuar ndan të njëjtat supozime, ose nëse grupi e trajton përsëritjen si konfirmim.

Pse ka rëndësi kjo

Kur verifikimi ngjan si një detyrë e lodhshme, përgjegjësia kalon tek individë që mund të kenë kohë, aftësi ose energji të kufizuar. Kjo çon në pika të verbra të parashikueshme: përmbajtja që është emocionalisht tërheqëse, që mbështetet nga shoqëria ose që prezantohet në formate “si lajme” mund të përhapet pa kontroll, ndërsa vetëm disa pretendime nxisin ndjekje të mëtejshme. Forcimi i qëndrueshmërisë përfshin zvogëlimin e pengesave të verifikimit përmes mjeteve të arritshme, sinjaleve më të qarta të platformës dhe shpjegimeve më të disponueshme dhe të besueshme në formatet e platformave autoktone, ndërkohë që promovon edhe rutinat e verifikimit social që nuk përforcojnë thjesht paragjykimet në grup.

6.3 Tema 3

Platformat formësojnë atë që bëhet “normale” (përforcimi algoritmik, influencuesit, komentet)

Platformat nuk kufizohen vetëm në shpërndarjen e informacionit; përmes renditjes, sugjerimeve, reklamave dhe formave të ndërveprimit, ato ndikojnë në atë që të rinjtë shohin vazhdimisht, në atë që perceptohet si “kudo”, dhe në atë që normalizohet në shoqëri.



Çfarë do të thotë

Kjo temë e koncepton shtresën e platformave si një faktor aktiv që formëson mjediset informative të të rinjve. Pjesëmarrësit shpesh e përshkruan ekspozimin si diçka që “u ndodh”: përmbajtja shfaqet vazhdimisht, disa narrativa duken të pashmangshme dhe seksionet e komenteve mund të ndikojnë në mënyrën se si interpretohet një postim. Në këtë kontekst, “besueshmëria” nuk lidhet vetëm me vetë pretendimin; ajo ka të bëjë edhe me përvojën e një feed-i, çfarë promovon ai, çfarë shpërblen dhe çfarë e bën të duket si normë e përhapur.

Tema përfshin mekanizma të tillë si rekomandimet algoritmike, përforcimi i paguar (reklamata dhe përmbajtjet e sponsorizuara), dinamikat e influencësve dhe krijuesve, si dhe kuptimin shoqëror që krijohet përmes komenteve dhe sinjaleve të angazhimit. Ajo ndërthuret me besimin dhe verifikimin, por fokusi kryesor këtu mbetet te roli i dizajnit të platformave dhe i mekanizmave të shpërndarjes në formësimin e perceptimeve dhe sjelljeve në shkallë të gjerë.

Si funksionon

Tre mekanizma shfaqen në mënyrë të qëndrueshme nga analiza e të dhënave.

Së pari, *përsëritja shndërrohet në realitet*. Kur një temë apo mënyrë kornizimi shfaqet vazhdimisht në llogari, formate dhe kohë të ndryshme, ajo mund të fillojë të duket si e vërtetë, e rëndësishme ose shoqërisht dominante, edhe pa u verifikuar paraprakisht nga përdoruesit.

Së dyti, *figurat karakteristike të platformave funksionojnë si bartëse të narrativave*. Influencësit dhe krijuesit e përmbajtjes shpesh marrin rolin e ndërmjetësve interpretues të lajmeve dhe çështjeve sociale, duke kombinuar informacionin, opinionin, humorin dhe elemente të identitetit në forma që perceptohen si të afërta dhe lehtësisht të shpërndashme.

Së treti, *komentet funksionojnë si një shtresë e dytë kuptimi*. Të rinjtë i përshkruan seksionet e komenteve si hapësira që mund të korrigjojnë dezinformimin, të thellojnë polarizimin, ose ta “prishin” krejt përvojën—duke u bërë ndonjëherë arsyeja kryesore për të besuar, për ta hedhur poshtë ose për t’u tërhequr nga një përmbajtje.

Dëshmitë

Çfarë dëgjuam (FGD/KII)

Pjesëmarrësit në vende të ndryshme e përshkruan ekspozimin si të kushtëzuar kryesisht nga shpërndarja algoritmike, më shumë sesa nga kërkimi i vetëdijshëm. *“Për shkak të mënyrës si imponohet përmbajtja — nga algoritmet ose nga numri i lartë i klikimeve — të rinjtë shndërrohen në spektatorë të pavullnetshëm.”* (ALB, KII). Edhe pse e pranojnë se feed-et janë të personalizuar, ata gjithsesi i përshkruan disa tema si të pranishme “kudo”, sidomos në periudha me rëndësi të lartë publike, si zgjedhjet, krizat apo debatet e polarizuara shoqërore. Njëkohësisht, ata vunë re se funksionalitetet e platformave nxisin reagime të menjëhershme dhe angazhim të shpejtë. Disa pjesëmarrës e konsiderojnë seksionin e komenteve si vendimtar: ai mund të funksionojë si mekanizëm verifikimi (“dikush do të thotë nëse është e pavërtetë”), por mundet edhe të rrisë armiqësinë dhe konfuzionin.

“Unë i shoh edhe komentet për ta verifikuar. Kur ka shumë reagime, do të thotë që po diskutohet.” (ALB, FGD)

“...por mund të rrisë edhe armiqësinë dhe konfuzionin.” (ALB, FGD)

“Më të këqija janë komentet poshtë. Për mua, kjo e ul edhe më shumë besueshmërinë.” (ALB, FGD)

Në diskutime të ndryshme, të rinjtë e konsiderojnë edhe reklamimin dhe promovimin e paguar si pjesë integrale të mjedisit informativ. Kur përmbajtja perceptohet si e “nxitur”, ajo mund të ngjallë dyshime mbi motivet, por njëkohësisht mund të rrisë perceptimin e rëndësisë së një teme thjesht përmes dukshmërisë së saj.

“Një influencuese nisi të fliste për shëndetin e saj mendor. Në fund doli se ishte reklamë — nuk ishte e shënuar si e tillë. Pas kësaj, humba dëshirën për ta besuar apo për të parë më përmbajtje prej saj në të ardhmen.” (BiH, FGD)

“Një influencuese nisi të fliste për shëndetin e saj mendor. Në fund doli se ishte reklamë — nuk ishte e shënuar si e tillë. Pas kësaj, humba dëshirën për ta besuar apo për të parë më përmbajtje prej saj në të ardhmen.”

BIH, FGD

“Për shkak të mënyrës si imponohet përmbajtja — nga algoritmet ose nga numri i lartë i klikimeve — të rinjtë shndërrohen në spektatorë të pavullnetshëm.”

ALB, KIII

Çfarë pamë në praktikë

Episodet e ditarit tregojnë në mënyrë konkrete se si funksionalitetet e platformave ndikojnë si në ekspozimin e përditshëm, ashtu edhe në interpretimin e përmbajtjes.

- Në Bosnje dhe Hercegovinë, një pjesëmarrës/e përshkroi se si përmbajtja “shfaqet vazhdimisht” dhe se kjo përsëritje e shtynte të kushtonte vëmendje, edhe pa verifikim të plotë. Besimi lidhej me perceptimin se një narrativë është e pranishme “kudo”. (SMD, BiH)
- Në Serbi, të dhënat nga ditari tregojnë se si komentet ndikojnë në mënyrën si pritet një postim: pjesëmarrësit ndonjëherë i shoshin komentet si një mënyrë të shpejtë për të interpretuar përmbajtjen (“komentet e konfirmojnë ose e prishin atë”), ndërsa në raste të tjera ata tërhiqen kur seksionet e komenteve bëhen toksike. (SMD, SRB)
- Në Shqipëri, një pjesëmarrës/e përshkroi mbështetjen te komentet për të kuptuar atë që po shihte: pasi iu shfaq një video në TikTok për një “emergjencë” në qytetin e tij/saj, ai/ajo tha se e besoi sepse “komentet e konfirmonin” (njerëzit pretendonin se e kishin parë drejtpërdrejt) dhe veprimi pasues ishte kontrolli i komenteve dhe i llogarisë që e kishte postuar për më shumë informacion. (SMD, ALB)

Çfarë ishte e dukshme në mjedisin më të gjerë të informacionit

Monitorimi i lehtë i rrjeteve sociale (LSL) tregon se dukshmëria e përmbajtjes ndikohet në masë të madhe nga dinamika të brendshme të ekosistemeve të platformave. Në Mal të Zi, shënimet javore evidentojnë se TikTok-u “dominohej” nga trende të përsëritura të drejtuara nga influencersit dhe nga formate me nivel të lartë angazhimi, ndërsa X ishte më i orientuar drejt lajmeve aktuale. Këto dallime ndihmojnë të kuptohet pse të rinjtë shpesh e lidhin ekspozimin me “normat” specifike të secilës platformë—pra, me atë që shpërblehet, amplifikohet dhe përsëritet—në vend të një agjende të përbashkët lajmesh. (LSL, MNE)

LSL-ja gjithashtu nxjerr në pah një tension metodologjik të rëndësishëm. Ndërsa të rinjtë shpesh i përshkruajnë narrativat si të pranishme “kudo” ose “të pashmangshme”, LSL-ja mund të ofrojë një pamje tjetër: disa narrativa qarkullojnë në hapësira private ose gjysmë-private (aplikacione mesazhesh, grupe të mbyllura, përmbajtje e përcjellë), të cilat nuk janë plotësisht të kapshme përmes monitorimit të rrjeteve sociale, ose ekspozimi ndryshon ndjeshëm për shkak të personalizimit algoritmik (sipas përdoruesit, vendndodhjes, gjuhës dhe rrjeteve). Kështu, ekspozimi i perceptuar reflekton përvojën individuale të një feed-i të kuruar, ndërsa LSL-ja pasqyron gjurmët publike dhe të kërkueshme. Në analizë, këto dy burime duhet të trajtohen si plotësuese: ditarët shpjegojnë përvojën individuale të ekspozimit, ndërsa LSL-ja kontribuon në kuptimin e mjedisit më të gjerë publik.

Modelet dhe tensionet rajonale

Në të gjithë BP6, të rinjtë e përshkruajnë në mënyrë të qëndrueshme ekspozimin ndaj feed-it si të personalizuar, por të ndërtuar mbi modele të përsëritura: tema të caktuara fitojnë vëmendje, bëhen dominuese për një periudhë dhe më pas zbehen, shpesh në sinkron me ciklet politike, situatat e krizës ose çështjet shoqërore me ngarkesë emocionale. Sinjalet e angazhimit (pëlqimet, shpërndarjet, komentet) përdoren si tregues orientues për besueshmërinë, edhe kur pjesëmarrësit janë të vetëdijshëm se këta tregues mund të manipulohen.


Një tension qendror që del në pah është se të rinjtë e përjetojnë njëkohësisht veten si aktivë në formësimin e përmbajtjes që shohin (“mund ta kuroj feed-in tim”) dhe si të kufizuar nga rikthimi i vazhdueshëm i të njëjtave përmbajtje (“kjo vazhdon të shfaqet”). Një tjetër tension lidhet me funksionin ambivalent të komenteve: nga njëra anë ato mund të shërbejnë si verifikim i bazuar në turmë, ndërsa nga ana tjetër mund të nxisin ngacmim, polarizim dhe përhapje të dezinformimit, duke i çuar disa përdorues drejt tërheqjes dhe lodhjes (gjë e cila lidhet drejtpërdrejt me Temën 5).

Pse ka rëndësi kjo

Kur platformat ndikojnë në dukshmërinë e përmbajtjes, ato, në fakt, përcaktojnë edhe kufijtë e asaj që perceptohet si normale, urgjente dhe e pranueshme në aspektin shoqëror. Si rrjedhojë, ndërhyrjet nuk mund të kufizohen vetëm te zhvillimi i aftësive individuale. Ato duhet të marrin në konsideratë edhe mënyrën se si funksionojnë mekanizmat e shpërndarjes dhe dizajnit të platformave: rolin e sistemeve të rekomandimit në përforcimin e kornizimeve të caktuara, ndikimin e reklamimit në mjegullimin e dallimit midis informacionit dhe bindjes, rolin e krijuesve si “interpretues” de facto të lajmeve, si dhe mënyrën se si struktura e komenteve ndikon në formimin e besimit, konfliktit dhe vendimeve për t’u angazhuar ose për t’u tërhequr. Në këtë kontekst, forcimi i qëndrueshmërisë kërkon një qasje të dyfishtë që përfshin si (a) mbështetje të drejtpërdrejtë për përdoruesit (p.sh. kuptimi i shpërndarjes algoritmike, menaxhimi i ekspozimit dhe vlerësimi kritik i sinjaleve të angazhimit), ashtu edhe (b) masa në nivel platforme (etiketim më i qartë, mekanizma më të fortë integriteti dhe përgjegjësi më e madhe për mënyrën e amplifikimit dhe ndikimit të përmbajtjes).

6.4 Tema 4

Ndarja e përmbajtjes nuk nënkupton gjithmonë besim (humori dhe ndjenja e përkatësisë vs. rreziku i amplifikimit)



Të rinjtë shpesh shpërndajnë përmbajtje për arsye si argëtimi, shprehja e përkatësisë ose “për të bërë shaka”, edhe kur nuk besojnë se ajo është e vërtetë; megjithatë, ky akt i shpërndarjes mund të lehtësojë përhapjen e narrativave të pasakta.

Çfarë do të thotë

Kjo temë thekson një mospërputhje të zakonshme midis besimit dhe sjelljes. Pjesëmarrësit e përshkruan ndarjen e përmbajtjes si një praktikë me funksion social: dërgimi i postimeve të miqtë ose në grupe përdoret për të forcuar lidhjet, për të sinjalizuar “ky është stili im i humorit” ose për të shprehur qëndrime ndaj politikës në mënyrë indirekte. Në këto situata, qëllimi nuk është domosdoshmërisht bindja e të tjerëve. Megjithatë, në nivel platforme, efekti mbetet i njëjtë: përmbajtja shpërndahet më gjerë, normalizohet dhe ruhet në qarkullim.

Tema përfshin ndarjen e memeve, komentet ironike apo sarkastike, ripostimet ironike, si dhe përcjelljen e përmbajtjes “sepse është qesharake” ose “sepse përputhet me grupin”. Përfshihen gjithashtu raste kur përdoruesit shtojnë një shënim paralajmërues (“nuk jam i/e sigurt nëse është e vërtetë”), por gjithsesi e shpërndajnë. Edhe pse lidhet me Temat 1–3, fokusi kryesor këtu është roli social i ndarjes dhe efektet e saj të paqëllimshme në mjedisin informativ.

Si funksionon

Të dhënat evidentojnë tre dinamika të përsëritura.

Së pari, humori e lehtëson ndjeshëm procesin e ndarjes së përmbajtjes. Materialet që perceptohen si argëtuese, absurde ose “të këqija, por zbavitëse” kanë prirje të shpërndahen më shpejt dhe më gjerësisht. Së dyti, shpërndarja shërben si një mënyrë për të demonstruar identitetin dhe përkatësinë. Përmes saj, individët sinjalizojnë se “kush janë”, me kë identifikohen ose cilit grup i përkasin (rrethet e miqve, komunitetet lokale, mikro-grupet politike). Së treti, qëllimi i shpërndarjes nuk e neutralizon efektin e saj. Edhe kur përmbajtja shpërndahet në mënyrë ironike ose “si shaka”, ajo mund të arrijë audiencën të reja që nuk e interpretojnë si të tillë, ndërsa sinjalet e angazhimit mund të nxisin amplifikimin e mëtejshëm të saj.

Dëshmitë

Çfarë dëgjuam (FGD/KII)

Gjatë diskutimeve, pjesëmarrësit e përshkruan ndarjen e përmbajtjes si një praktikë sociale që nuk lidhet domosdoshmërisht me besimin.

Në Serbi, një pjesëmarrës/e e përshkroi ndarjen e artikujve tabloide si një shaka të brendshme brenda grupit të bashkëmoshatarëve: *“Kur shoh diçka nga ato tabloidët pro-regjim, si ‘plani sekret i bllokuesve për të shkatërruar shtetin’, thjesht qesh dhe e dërgoj në grupin tim, u them ‘shikoni çfarë kemi shpikur tani!’”* (SRB, FGD). Në Kosovë, pjesëmarrësit përshkruan një praktikë të ngjashme, ku përmbajtja e pasigurt mund të shpërndahet “për të qeshur”, sidomos kur përputhet me interesa të përbashkëta ose identitetet lokal: *“Me familjen, dërgoj vetëm lajme që e di se janë të sigurta. Me miqtë, nëse diçka nuk është e vërtetë ose duket e dyshimtë, mund ta dërgoj gjithsesi si shaka, në varësi të interesave tona të përbashkëta.”* (KOS, FGD)

Një i/e intervistuar në Mal të Zi sqaroi se si funksionon mekanizmi: edhe shpërndarja e postimeve me shaka kontribuon në përhapjen e dezinformimit: *“Këto lloje dezinformimi përcillen si shaka, për të qeshur, por mendoj se kjo gjithsesi kontribuon në përhapjen e përmbajtjes.”* (MNE, KII). Ky model shfaqet edhe në reflektime ekspertësh: humori mund të ulë ndikimin emocional, por njëkohësisht lejon që narrativat e pavërteta ose çorientuese të qarkullojnë dhe të normalizohen. *“Dezinformimi shpesh ndahet si shaka, meme ose koment sarkastik. Ndërsa kjo mund të ulë ndikimin emocional, ajo gjithashtu normalizon narrativat e pavërteta ose çorientuese dhe i mban ato në qarkullim pa u vënë në pikëpyetje.”* (ALB, KII)

“Kur shoh diçka nga ato tabloidët pro-regjim, si ‘plani sekret i bllokuesve për të shkatërruar shtetin’, thjesht qesh dhe e dërgoj në grupin tim, u them ‘shikoni çfarë kemi shpikur tani!’”

SRB, FGD

“Këto lloje dezinformimi përcillen si shaka, për të qeshur, por mendoj se kjo gjithsesi kontribuon në përhapjen e përmbajtjes.”

MNE, KII

Çfarë pamë në praktikë

Episodet e ditarit tregojnë se ndarja e përmbajtjes shpesh motivohet nga argëtimi dhe lidhjet sociale, dhe jo domosdoshmërisht nga besimi.

- Në Serbi, një pjesëmarrës/e përshkroi një trend në TikTok që e konsideroi argëtues dhe e ndau menjëherë, duke theksuar se nuk e besonte pretendimin bazë: *“Jo, jam i vetëdijshëm / e vetëdijshme që është vetëm për qëllime argëtimi.”* (SMD, SRB)
- Në një tjetër rast nga Serbia, pjesëmarrësi/sja ndërveproi me një meme që i dukej e afërt me përvojën e tij/saj, por shprehu një qëndrim të pasigurt ose të përzier ndaj besimit, duke treguar se përmbajtje të tilla mund të pozicionohen në një hapësirë gri midis argëtimit dhe pranimit të pjesshëm.
- Në Shqipëri, një pjesëmarrës/e ndau një klip absurd në mënyrë eksplicite si meme/humor dhe jo si diçka për t'u verifikuar apo mbështetur: *“E ndava si meme.”* (SMD, ALB)
- Në Kosovë, një pjesëmarrës/e ndau një klip politik për të cilin nuk e besonte, duke e përdorur ndarjen kryesisht si formë ndërveprimi social në një bisedë familjare: *“E ndava në grupin e familjes me një emoji.”* (SMD, KOS)

Në tërësi, këto raste tregojnë një prirje më të gjerë: përmbajtja mund të shpërndahe, shijohet, ruhet ose përcillet më tej edhe kur besimi është i kufizuar, duke kontribuar në rritjen e dukshmërisë përmes ndërveprimeve ndërpersonale dhe sinjaleve të angazhimit në platformë.

Çfarë ishte e dukshme në mjedisin më të gjerë të informacionit

Monitorimi i lehtë i rrjeteve sociale mbështet idenë se formatet native të platformave (meme-t, klipet e shkurtra, komentet ironike) kanë dukshmëri të lartë dhe favorizojnë angazhimin. Këto formate shpesh e zbehin dallimin midis informacionit dhe argëtimit, duke e bërë më të vështirë vlerësimin e “statusit të së vërtetës” në momentin e ekspozimit. Kjo ka rëndësi të veçantë, pasi përmbajtja me natyrë humoristike mund të qarkullojë gjerësisht pa nxitur domosdoshmërisht sjellje verifikuese.

Modelet dhe tensionet rajonale

Në të gjithë BP6, shpërndarja “për argëtim” është e zakonshme, por e kushtëzuar nga konteksti. Gjatë periudhave me rëndësi të lartë (politikë, kriza, çështje shoqërore polarizuese), përcjellja me humor ose sarkazëm e postimeve përdoret shpesh si mënyrë për të shprehur qëndrime ose për të reaguar pa hyrë në konfrontim të drejtpërdrejtë.

Një tension kryesor është se humori mund të funksionojë si formë e kritikës apo rezistencës informale (duke ironizuar propagandën ose duke kritikuar elitat), por njëkohësisht mund të përforcojë vetë narrativat që synon të vërë në lojë. Një tjetër tension lidhet me kolapsin e audiencës: qëllimi i shpërndarësit (“miqtë e mi do ta kuptojnë shakanë”) shpesh nuk qëndron jashtë rrethit të ngushtë, sidomos kur përmbajtja qarkullon më tej përmes ripostimeve ose rekomandimeve algoritmike.

Pse ka rëndësi kjo

Kur shpërndarja perceptohet si “thjesht për shaka”, përgjegjësia për pasojat mund të relativizohet. Megjithatë, efekti kumulativ mbetet i dukshëm: çdo shpërndarje zgjeron audiencën, forcon sinjalet e angazhimit dhe mund të kontribuojë në normalizimin e narrativave çorientuese duke i bërë ato të duken të njohura. Për rrjedhojë, ndërhyrjet nuk duhet të fokusohen vetëm te mungesat në njohuri, por edhe te motivimet sociale që nxisin ndarjen. Kjo nënkupton mbështetje për të rinjtë në identifikimin e situatave kur humori përmban rrezik amplifikimi, inkurajimin e praktikave të thjeshta parandaluese (si shtimi i kontekstit, përdorimi i paralajmërimeve, ose shmangia e shpërndarjes), si dhe forcimin e përgjegjësisë së platformave për mënyrën se si përmbajtjet çorientuese përhapen përmes formateve argëtuese.

6.5 Tema 5

Shumë informacion bëhet emocional (mbingarkesë, tërheqje)

Mjediset informative me fluks të lartë dhe intensitet të shtuar shpesh gjenerojnë emocione si paqartësi, ankth, irritim dhe lodhje, duke çuar shumë të rinj drejt tërheqjes, shmangies së lajmeve ose zhvillimit të një “hipervigilence” që është e vështirë të ruhet në mënyrë të qëndrueshme.



Çfarë do të thotë

Kjo temë trajton përvojën e drejtpërdrejtë të mbingarkesës me informacion. Pjesëmarrësit diskutuan për situata kur ekspozimi nuk është më informues, por bëhet i lodhshëm dhe i vështirë për t'u përballuar: sasia e madhe e përmbajtjes, pretendimet e shumta dhe shpesh kontradiktore, si dhe “zhurma” e vazhdueshme krijojnë një ndjesi mbingarkese. Për disa, kjo çon në shmangie (“e anashkaloj”). Për të tjerë, prodhon një gjendje monitorimi të vazhdueshëm (“duhet të jem gjithmonë vigjilent/e”). Të dyja këto reagime synojnë vetëmbrojtjen, por shoqërohen me kosto: mosangazhimi mund të kufizojë informimin mbi çështje të rëndësishme, ndërsa hipervigjilenca mund të jetë psikologjikisht rraskapitëse.

Tema përfshin reagimet emocionale ndaj polarizimit politik, situatave të krizës dhe konflikteve të zgjatura shoqërore, si dhe ndikimin e veçorive të platformave që intensifikojnë ekspozimin, (si rrëshqitja e vazhdueshme në përmbajtje “endless scrolling”, luajtja automatike “auto-play”, njoftimet “push” dhe toni armiqësor në seksionet e komenteve).

Si funksionon

Identifikohen tre dinamika kryesore. Së pari, mbingarkesa njohëse: kur feed-et ngopen me informacion, bëhet gjithnjë e më e vështirë të dallohet thelbësorja nga “zhurma”. Narrativat kontradiktore mund të duken të pamundura për t'u zgjidhur. Së dyti, përhapja emocionale: emocione si zemërimi, frika dhe indinjata transmetohen lehtësisht, ndërsa arkitektura e platformave favorizon përmbajtje me ngarkesë të lartë emocionale. Seksionet e komenteve dhe formatet e bazuara në konflikt shpesh e përshkallëzojnë stresin. Së treti, strategjitë e përballimit: të rinjtë zhvillojnë praktika mbrojtëse, si bllokimi i përmbajtjes (muting), mosndjekja (unfollowing), kufizimi i kohës së dedikuar lajmeve, shmangia e tyre, ose mbështetja te një grup i kufizuar burimesh të perceptuara si “të sigurta”. Edhe pse funksionale, këto strategji mund të kufizojnë ekspozimin dhe, në afat më të gjatë, të reduktojnë angazhimin qytetar.

Dëshmitë

Çfarë dëgjuam (FGD/KII)

Në të gjitha vendet, pjesëmarrësit përshkruan konfuzion dhe lodhje si pasojë e ekspozimit të vazhdueshëm ndaj informacionit dhe narrativave kontradiktore. Në Bosnje dhe Hercegovinë, një pjesëmarrës/e e përshkroi qartë ndikimin emocional të pasigurisë: *“Gjithçka është konfuze. Nuk e di më kujt t’i besoj. Kjo më lodh.”* (BiH, FGD). Në Maqedoninë e Veriut, të rinjtë e lidhin erozionin e besimit me një lodhje të vazhdueshme emocionale, ku pasiguria bëhet gjendje e përhershme: *“Kjo gjë të lodh. Në një moment thjesht ndalon së u përpjekuri të kuptosh se çfarë është e vërtetë.”* (NM, FGD). Në Mal të Zi, pjesëmarrësit e përshkruan shmangien si një mekanizëm përballimi, sidomos gjatë periudhave me përmbajtje politike intensive: *“Kur fillon sërish me politikë, thjesht e fik. Është e tepërt dhe ndihesh keq pas kontrollit të vazhdueshëm të përmbajtjes.”* (MNE, FGD)

Ekspertët theksuan gjithashtu se mbingarkesa kontribuon në tërheqje dhe rrit ndjeshmërinë ndaj informacionit. Kur shfaqet lodhja, individët priren të mbështeten më shumë në narrativa të thjeshtuara ose në shkurtesa mendore. *“Kjo ndodh sepse të rinjtë, në përgjithësi, janë të mbingarkuar. Sepse nëse konsumoj një sasi të madhe informacioni gjatë ditës, nuk kam realisht as kohën dhe as energjinë për të verifikuar dhe rishikuar gjithçka që shoh.”* (ALB, KII)

“Kjo ndodh sepse të rinjtë, në përgjithësi, janë të mbingarkuar. Sepse nëse konsumoj një sasi të madhe informacioni gjatë ditës, nuk kam realisht as kohën dhe as energjinë për të verifikuar dhe rishikuar gjithçka që shoh.”

ALB, KII

Çfarë pamë në praktikë

Episodet e ditarit tregojnë se mbingarkesa nuk është thjesht koncept teorik; ajo shfaqet në zakonet e përditshme të ekspozimit dhe në reagimet emocionale.

- Në Serbi, një pjesëmarrës/e e lidhi drejtpërdrejt tonin e feed-it me humor negativ dhe e përshkroi tërheqjen si një formë vetëmbrojtjeje: “Vazhdon të shfaqet dhe është gjithmonë negative.” (SMD, SRB; ekspozim i përsëritur → shmangie)
- Në Bosnje dhe Hercegovinë, një pjesëmarrës/e përshkroi se u përfshi në konflikte të nxitura nga komentet dhe më pas u pendua për kohën dhe energjinë emocionale të shpenzuar, duke vënë në dukje se komentet shkaktuan lodhje emocionale dhe e përkeqësuan përvojën në vend që të ofronin qartësi. (SMD, BiH; komente → lodhje emocionale)
- Në Mal të Zi, një rast ilustron se si pasiguria vetë mund të jetë rraskapitëse: pjesëmarrës/e shprehu besim të përzier, paretat dhe më pas zgjodhi të tërhiqej në vend që të kryente një verifikim të plotë. (SMD, MNE; besim i përzier → tërheqje)
- Në Kosovë, një pjesëmarrës/e përshkroi lundrimin nëpër postimet e një faqeje të një reality-show dhe theksoi se kapërceu një sasi të madhe përmbajtjeje (“...ndonjëherë u befasova dhe i kalova shumë video”), duke treguar se ekspozimi me volum të lartë mund të çojë në tërheqje të shpejtë në vend të vëmendjes më të thelluar. (SMD, KOS)
- Në Maqedoninë e Veriut, një pjesëmarrës/e hasi një klip shqetësues lidhur me çështjen Epstein dhe regjistroi një reagim të menjëhershëm emocional (“I/E hutuar dhe i/e shqetësuar”), pa kaluar në një proces të plotë verifikimi—duke ilustruar se pasiguria vetë mund të bëhet rraskapitëse emocionalisht dhe t'i shtyjë përdoruesit drejt tërheqjes në vend të kontrollit. (SMD, NM)

Çfarë ishte e dukshme në mjedisin më të gjerë të informacionit

LSL-ja tregon se përmbajtja me angazhim të lartë shpesh ka natyrë emocionale të fortë: klipet politike polarizuese, narrativat e krizave dhe komentet me tone të theksuara emocionale janë të pranishme në platforma ku viraliteti dhe ndërveprimet shpërblehen. Shënimet në terren të LSL-së sugjerojnë gjithashtu se në periudha me rëndësi të lartë publike, intensiteti i përmbajtjes rritet: temat bëhen më të dendura, narrativat përsëriten dhe niveli emocional i diskutimeve në komente rritet, duke reflektuar ndjesitë e mbingarkesës të raportuara nga pjesëmarrësit.

Për më tepër, LSL-ja ndihmon të kuptohet pse të rinjtë e perceptojnë përmbajtjen si “të pashmangshme”. Mekanizmat algoritmikë të rekomandimit dhe përsëritja e përmbajtjes mund të krijojnë ndjesinë e ekspozimit të vazhdueshëm, edhe pa kërkim aktiv, duke kontribuar në rritjen e lodhjes dhe në uljen e gjasave për verifikim të qëllimshëm.

Modelet dhe tensionet rajonale

Në të gjithë BP6, mbingarkesa shfaqet si një fenomen njëkohësisht psikologjik dhe informativ: tepricë mesazhesh, të vërteta kontradiktore dhe mungesë e qartësisë mbi burimet e besueshme. Shumë të rinj e përshkruajnë shmangien (“e injoroj”, “e çaktivizoj”) si strategjinë më praktike të përballimit.

Një tension qendror që del në pah është se tërheqja mund të reduktojë ndikimin negativ në afat të shkurtër, por në të njëjtën kohë mund të kufizojë pjesëmarrjen e informuar dhe të lejojë që narrativat të qarkullojnë pa kundërshtim. Nga ana tjetër, hipervigjilenca përbën një rrezik tjetër: monitorimi i vazhdueshëm mund të rrisë ankthin dhe qëndrimet cinike, duke kontribuar më tej në dobësimin e mëtejshëm të besimit ndaj institucioneve dhe mediave.

Pse ka rëndësi kjo

Mbingarkesa nuk përbën vetëm një përvojë individuale, por edhe një tipar strukturor të mjedisit informativ. Kur të rinjtë përjetojnë lodhje emocionale, ulet aftësia për të ruajtur vëmendjen dhe për të kryer verifikime të detajuara, duke i shtyrë ata drejt rënies shkurt ose drejt tërheqjes së plotë. Prandaj, ndërhyrjet duhet të synojnë lehtësimin e barrës si informative ashtu edhe emocionale: të ofrojnë shpjegime të qarta dhe të besueshme në formate të përshtatura për platformat; të mbështesin “daljet” e shëndetshme nga ekspozimi (praktika të shëndetshme të ekspozimit, mirëqenie digjitale); si dhe të adresojnë elementet e platformave që nxisin konfliktin dhe përsëritjen. Në thelb, forcimi i qëndrueshmërisë nënkupton bërjen e informacionit të besueshëm më të lehtë për t’u pranuar dhe zhvillimin e aftësive për ta verifikuar atë.

6.6 Tema 6

Ndërhyrje në burim (boshllëqet në politika, zbatimi, standardet e mediave, përgjegjësia e platformave)

Të rinjtë shpesh e identifikojnë problemin “në burim”: ata e shohin keqinformimin/dezinformimin si të shkaktuar nga zbatimi i dobët i rregullave, mungesa e përgjegjshmërisë dhe standardet e dobëta të mediave dhe platformave, dhe kërkojnë që përgjegjësia të ndahet përtej përdoruesve individualë.



Çfarë do të thotë

Kjo temë nxjerr në pah një ndryshim në mënyrën se si atribuohet përgjegjësia. Edhe pse pjesëmarrësit pranojnë rolin e zgjedhjeve individuale (si p.sh. çfarë të ndjekin dhe çfarë të shpërndajnë), shumë theksojnë se barra nuk mund të mbetet vetëm mbi të rinjtë që përballen me një mjedis informativ të tejmbushur. Në vend të kësaj, ata nënvizojnë faktorë strukturorë: gazetari me standarde të ulëta, pronësi jo të qarta, stimuj për përmbajtje sensacionale (clickbait), ndikim politik, rregullim apo zbatim të pamjaftueshëm, si dhe mekanizma platformash që amplifikojnë përmbajtje të dëmshme duke ofruar pak transparencë.

Kjo temë kërkon standarde më të larta profesionale në media, llogaridhënie më të qartë për mediat online, reagim më të shpejtë dhe efektiv nga institucionet, si dhe përgjegjësi më të madhe të platformave për mënyrën se si amplifikohet përmbajtja, reklammat dhe mënyrën si përhapet përmbajtja e dëmshme.

Si funksionon

Në të gjithë setin e të dhënave, shfaqen vazhdimisht tre mekanizma.

Së pari, niveli i ulët i llogaridhënies krijon një klimë toleruese. Kur mediat nuk përballen me pasoja për keqinformim, sensacion apo sjellje joetike, përmbajtja me cilësi të dobët bëhet e zakonshme. Së dyti, besimi tek institucionet përbën një element kyç të mjedisit informativ. Kur të rinjtë i shohin institucionet si të padukshme, të politizuara ose joefikase, ata priren ta konsiderojnë sistemin si të pabesueshëm dhe të distancohen, ose të mbështeten më shumë në rrjete joformale. Së treti, mënyra si janë ndërtuar platformat dhe modelet e tyre të biznesit ndikojnë drejtpërdrejt në atë që njerëzit shohin. Pjesëmarrësit shpesh theksuan se platformat përfitojnë nga tërheqja e vëmendjes dhe nga konfliktet, duke përdorur algoritme dhe sisteme reklamimi që favorizojnë angazhimin më shumë sesa saktësinë.

Dëshmitë

Çfarë dëgjuam (FGD/KII)

Të rinjtë shprehën qartë shqetësime për boshllëqet në llogaridhënie, veçanërisht në lidhje me portalet online dhe ndjesinë se “çdokush mund të publikojë çfarë të dojë”.

Në Bosnjë dhe Hercegovinë, pjesëmarrësit ia atribuuan problemin mungesës së përgjegjësisë dhe zbatimit të rregullave: *“Nuk ka llogaridhënie. Portalet bëjnë çfarë të duan. Shteti nuk po bën mjaftueshëm.”* (BiH, FGD). Në Serbi, pjesëmarrësit e përshkruan praktikën e mediave me cilësi të dobët si të zakonshme dhe të vështirë për t’u sfiduar: *“Ata publikojnë çfarëdo gjëje që sjell klikime dhe askush nuk mban përgjegjësi për këtë. Edhe kur provohet se është e gabuar, përmbajtja mbetet online.”* (SRB, FGD).

Pjesëmarrësit e lidhën gjithashtu besueshmërinë e dobët institucionale me një cenueshmëri më të gjerë: nëse institucionet nuk mund t’u besohet ose nëse ato nuk komunikojnë qartë, keqinformimi e gjen më lehtë rrugën e përhapjes. *“Kur institucionet nuk komunikojnë siç duhet, njerëzit e mbushin boshllëkun me çfarëdo gjëje që gjejnë online.”* (NM, FGD). Një diskutim rajonal në një grup fokusi përforcoi kërkesën për rregullim dhe zbatim më të fortë e funksional, ku një pjesëmarrës theksoi veçanërisht nevojën për një rregullator efektiv të mediave: *“E vetmja rrugë përpara që shoh është përmes REM-it — një organ rregullator funksional që do të parandalonte vendosjen e lajmeve sensacionale në radhë të parë, ose të paktën do të rregullonte situatën në mënyrë që ky nivel i gjuhës së urrejtjes dhe dhunës në media të ndalet.”* (REG, FGD)

“E vetmja rrugë përpara që shoh është përmes REM-it — një organ rregullator funksional që do të parandalonte vendosjen e lajmeve sensacionaliste në radhë të parë, ose të paktën do të rregullonte situatën në mënyrë që ky nivel i gjuhës së urrejtjes dhe dhunës në media të ndalet.”

REG, FGD

“Vite të tëra polarizimi politik, skandalesh korrupsioni dhe llogaridhënie e paqëndrueshme kanë bërë që shumë njerëz të jenë skeptikë ndaj informacionit zyrtar. Kur besimi tek institucionet dhe mediat tradicionale është i ulët, narrativat alternative — edhe ato të pasigurta — gjejnë terren të favorshëm.”

ALB, KII

Informatorët kryesorë i pasqyruan dhe i kontekstualizuan këto shqetësime. Ata përshkruan se si polarizimi politik, mekanizmat e dobët të llogaridhënies dhe presionet ekonomike mund të krijojnë një “terren pjellore” për narrativa të pasigurta. *“Vite të tëra polarizimi politik, skandalesh korrupsioni dhe llogaridhënie e paqëndrueshme kanë bërë që shumë njerëz të jenë skeptikë ndaj informacionit zyrtar. Kur besimi tek institucionet dhe mediat tradicionale është i ulët, narrativat alternative — edhe ato të pasigurta — gjejnë terren të favorshëm.”* (ALB, KII)

Çfarë pamë në praktikë

Episodet e ditari pasqyrojnë të njëjtin model të përsëritur. Pjesëmarrësit shpesh reagojnë ndaj postimeve jo vetëm duke i besuar apo duke i vënë në dyshim, por edhe duke shprehur zhgënjim ndaj sistemit më të gjerë: kush lejohet të publikojë, kush përfiton dhe kush mban përgjegjësi.

- Në Serbi, një pjesëmarrës/e reagoi ndaj një videoje polarizuese, duke theksuar se vetë mjedisi i platformës favorizon përmbajtje provokuese dhe duke shprehur irritim, në vend që ta konsideronte si një rast të veçuar. Sjellja e tij/saj më pas nuk ishte verifikimi, por tërheqja emocionale, çka tregon një ndjesi se mungojnë mekanizmat realë për të vepruar. (SMD, SRB; logjika e platformës → zhgënjim)
- Në Bosnje dhe Hercegovinë, një shënim në ditar e lidhi mosbesimin me mënyrën e funksionimit të mediave: pjesëmarrësi tregoi se shmang përmbajtjet nga disa portale, pasi i konsideron sensacionale ose të ndikuara politikisht, duke përdorur reputacionin e burimit si filtër mbrojtës në vend që të verifikojë çdo informacion më vete. (SMD, BiH; reputacioni i burimit → shmangie)
- Në Mal të Zi, një pjesëmarrës/e shprehu shqetësim për videot “në formë lajmi” dhe mungesën e referencave të qarta, duke e parë këtë si pjesë të një problemi më të gjerë të llogaridhënies dhe transparencës së platformave, dhe jo thjesht si një rast të vetëm keqinformimi. (SMD, MNE; mungesa e burimit → kritikë sistematike)

Çfarë ishte e dukshme në mjedisin më të gjerë të informacionit

LSL-ja vë në pah dukshmërinë e faktorëve strukturorë: grupimet e përmbajtjes politike, narrativat sensacionale dhe komentet e udhëhequra nga influencerë shpërndahen në formate të optimizuara për angazhim. Shënimet nga terreni tregojnë gjithashtu se përmbajtja ndryshon sipas platformave (për shembull, trendet në TikTok kundrejt diskutit të lajmeve në X), çka ndikon edhe në mënyrën se si shpërndahet përgjegjësia. Thirrjet e pjesëmarrësve për ndërhyrje “në burim” përputhen me dukshmërinë e narrativave të përsëritura dhe polarizuese, si dhe me lehtësinë me të cilën përmbajtja mund të riprodhohet, rishpërndahet dhe kontekstualizohet nëpër llogari të ndryshme.

Modelet dhe tensionet rajonale

Në të gjithë BP6, të rinjtë e konceptojnë çështjen kryesisht si një problem sistemik: mangësitë në cilësi dhe llogaridhënie të mediave dhe institucioneve, të shoqëruara me efektet e amplifikimit nga platformat. Po ashtu, ata presin që shkollat, rregullatorët dhe platformat të kenë role të përcaktuara më qarta.

Një nga tensionet kryesore është se rregullimi më i fortë shihet njëkohësisht si i nevojshëm dhe potencialisht problematik. Disa pjesëmarrës kërkojnë rregulla më të qarta dhe zbatim më rigoroz, ndërsa të tjerë shprehin shqetësime për politizim, censurë ose zbatim të njëanshëm. Një tension tjetër lidhet me realizueshmërinë: megjithëse të rinjtë kërkojnë “përgjegjësi nga platformat”, shpesh ata nuk kanë njohuri të mjaftueshme për mekanizmat praktikë ekzistues, çka mund të nxisë cinizëm dhe ndjesi dorëzimi.

Pse ka rëndësi kjo

Trajtimi i keqinformimit/dezinformimit vetëm si mungesë aftësish individuale (“të rinjtë duhet të verifikojnë më shumë”) bën që ndërhyrjet të lënë në hije faktorët kyç të theksuar nga të rinjtë: nxitjet, mekanizmat e llogaridhënies dhe besimi. Ndërhyrjet “në burim”, si standarde më të qarta për median, transparencë mbi pronësinë dhe burimet e financimit, rregulla të zbatueshme për mediat online dhe përgjegjësi më të madhe të platformave për mënyrën e amplifikimit dhe reklamimit, mund të ulin presionin mbi individët. Megjithatë, këto masa duhet të shoqërohen me garanci, si: transparencë, pavarësi dhe proporcionalitet, për të mos rritur mosbesimin politik. Në praktikë, qëndrueshmëria forcohet kur aftësitë individuale mbështeten nga sisteme që e bëjnë informacionin e besueshëm më të aksesueshëm, më të dallueshëm dhe më të besueshëm.

6.7 Tema 7

Edukimi mediatik si infrastrukturë (aftësi ndërbrezore)

Të rinjtë e shohin edukimin mediatik dhe informativ si një “infrastrukturë” ndërbrezore: ai zhvillohet me kalimin e kohës përmes shkollave, familjeve dhe komuniteteve, dhe kërkon mbështetje si për të rriturit ashtu edhe për të rinjtë.



Çfarë do të thotë

Kjo temë e paraqet edukimin mediatik dhe informativ më pak si një trajnim të njehershëm dhe më shumë si një aftësi të përbashkët që zhvillohet gjatë gjithë jetës. Pjesëmarrësit shpesh e përshkruajnë të nxënit mbi besueshmërinë dhe sigurinë online si një kombinim i mësimëve në shkollë, udhëzimeve nga familja dhe praktikave mes bashkëmoshatarëve. Ata gjithashtu theksuan se të rriturit shpesh përballen me të njëjtin mjedis informativ, ndonjëherë me më pak aftësi digjitale, por me më shumë vetëbesim, duke krijuar rreziqe për keqkuptime ndërbrezore dhe përhapjen e keqinformimit.

Kjo temë përfshin thirrje për forcimin e edukimit mediatik dhe informativ në shkolla, për t'u ofruar mësuesve mbështetje praktike në vend të fajësimit, si dhe për zgjerimin e ndërhyrjeve të prindërve dhe kujdestarëve. Ajo përfshin gjithashtu idenë se të rinjtë vetë mund të jenë bartës efektivë të mesazheve, veçanërisht në mjedise ku besimi ndaj institucioneve është i ulët.

Si funksionon

Tre modele kryesore shfaqen vazhdimisht në të dhëna.

Së pari, aftësitë përvetësohen në mënyrë shoqërore. Të rinjtë krijojnë zakone përmes vëzhgimit dhe praktikës së përbashkët: çfarë përcjellin prindërit, çfarë konsiderojnë interesante miqtë dhe cilat burime perceptohen si “të besueshme”. Së dyti, mësuesit dhe prindërit kanë nevojë për mbështetje. Pjesëmarrësit shpesh e përshkruajnë arsimin si një hapësirë të përshtatshme për zhvillimin e këtyre aftësive, por njëkohësisht vinin në dukje kufizime si: ngarkesa e mësuesve, programet e ngjeshura dhe ndikimi i zakoneve digjitale të të rriturve që mund të zbehin mesazhet shkollore. Së treti, qasjet mes bashkëmoshatarëve kanë potencial për të arritur një audiencë më të gjerë. Në kontekste ku besimi ndaj institucioneve është i ulët, komunikimi i drejtuar nga të rinjtë dhe shpjegimet nga krijues përmbajtjeje shpesh rezultojnë më bindëse se fushatat zyrtare.

“Nuk mjafton të thuhet ‘mos besoni gjithçka’. Na duhen mënyra konkrete për të kontrolluar dhe kuptuar pse diçka është çorientuese.”

KOS, FGD

“Integrimi i edukimit mediatik dhe digjital në kurrikulat shkollore — nga arsimi fillor deri në atë të mesëm — do t'u mundësonte nxënësve të zhvillojnë të menduarit kritik, aftësitë e verifikimit të fakteve dhe një kuptim më të mirë të burimeve të informacionit. Këto module duhet të përditësohen rregullisht dhe të shoqërohen me trajnim të vazhdueshëm të mësuesve.”

ALB, KII

Dëshmitë

Çfarë dëgjuam (FGD/KII)

Në vende të ndryshme, të rinjtë shpesh argumentuan se edukimi mediatik dhe informativ duhet të fillojë më herët dhe të mos kufizohet vetëm në një “orë mësimi” apo të jetë opsional. Ata gjithashtu theksuan rëndësinë e përfshirjes së të rriturve.

Në Bosnje dhe Hercegovinë, një pjesëmarrës/e e përshkroi atë si përgjegjësi të shkollës, por me theks në përgatitjen e njerëzve për të menaxhuar mjediset reale online: *“Kjo duhet të mësohet në shkollë. Edhe prindërit dhe mësuesit kanë nevojë për mbështetje.”* (BiH, FGD). Në Maqedoninë e Veriut, pjesëmarrësit shpjeguan se boshllëqet në të kuptuarit e të rriturve shtojnë presionin mbi të rinjtë për të luftuar keqinformimin brenda familjes: *“Ndonjëherë jam unë ai/ajo që u shpjegoj prindërve pse diçka nuk është e vërtetë, sepse ata thjesht e shpërndajnë.”* (NM, FGD). Në Kosovë, të rinjtë theksuan se edukimi duhet t’u japë përparësi aftësive praktike, si të njohësh shenjat, si të verifikosh informacionin dhe si të shmangësh dëmin, në vend të paralajmërimeve abstrakte: *“Nuk mjafton të thuhet ‘mos besoni gjithçka’. Na duhen mënyra konkrete për të kontrolluar dhe kuptuar pse diçka është çorientuese.”* (KOS, FGD). Ata gjithashtu vunë në dukje se sinjalet e besimit dhe besueshmërisë mësohen në mënyrë sociale dhe shpesh varen nga figura autoriteti të njohura, edhe kur të rinjtë bëjnë një “kontroll” të shpejtë: *“Nëse, për shembull, një profesor nga fakulteti im e shpërndan, unë do të kem një nivel të caktuar besimi se është më shumë ose më pak i saktë, sepse i besoj atij personi — por sigurisht që prapë do ta verifikoj.”* (REG, FGD).

Informatorët kryesorë e mbështetën këtë këndvështrim dhe theksuan se zhvillimi i kapaciteteve duhet të jetë i vazhdueshëm dhe të përditësohet rregullisht, pasi platformat, formatet dhe teknikat e manipulimit evoluojnë me shpejtësi. *“Integrimi i edukimit mediatik dhe digjital në kurrikulat shkollore — nga arsimi fillor deri në atë të mesëm — do t’u mundësonte nxënësve të zhvillojnë të menduarit kritik, aftësitë e verifikimit të fakteve dhe një kuptim më të mirë të burimeve të informacionit. Këto module duhet të përditësohen rregullisht dhe të shoqërohen me trajnim të vazhdueshëm të mësuesve.”* (ALB, KII)

Çfarë pamë në praktikë

Episodet e ditari tregojnë se të nxënit dhe interpretimi shpesh ndodhin përmes lidhjeve shoqërore. Pjesëmarrësit ndonjëherë përdorin familjarët ose miqtë si pikë reference për të vlerësuar nëse diçka është e besueshme dhe përshkruajnë shpërndarjen e përmbajtjes për të “testuar” reagimet ose për të marrë një mendim të dytë.

- Në Serbi, një pjesëmarrës/e ndau një postim me miqtë për ta diskutuar, duke përdorur bisedën në grup si një hapësirë interpretimi dhe jo si një vendimmarrje përfundimtare. Kjo sjellje tregon se rrjetet e bashkëmoshatarëve funksionojnë si mjedise informale të të nxënit, edhe kur verifikimi mbetet i paplotë. (SMD, SRB; “dërgoje në grup” → ndërtim kuptimi)
- Në Bosnje dhe Hercegovinë, një pjesëmarrës/e përshkroi mbështetjen te burime të njohura “zyrtare” dhe shpjegoi se ky zakon ishte formësuar nga udhëzime dhe praktika të mëparshme. Kjo tregon se zakonet e besimit mund të rrënjosen me kalimin e kohës, duke funksionuar si një infrastrukturë e përditshme dhe jo si një zgjedhje e vetëdijshme çdo herë. (SMD, BiH; “burim zyrtar” → besim i zakonshëm)
- Në Kosovë, një pjesëmarrës/e përdori diskutimin familjar si nxitje për të kuptuar më mirë situatën: “Prindërit e mi po debatonin në dhomën e ndenjës, kështu që e kërkova për të parë fjalimin e plotë,” dhe më pas e ndau videon në një grup familjar. (SMD, KOS)
- Në Shqipëri, një pjesëmarrës/e ndau përmbajtje me qëllim të qartë për ta diskutuar me të tjerët dhe për të përpunuar reagimin e tyre: “E shpërndava për ta diskutuar me të tjerët, që të shprehja zemërimin tim për atë që kishte ndodhur.” (SMD, ALB)
- Në Maqedoninë e Veriut, një pjesëmarrës/e ndau një video të shkurtër (reel) me miqtë si një formë sociale “e përcjelljes” së interpretimit/vëmendjes (“Më pëlqeu dhe e ndava me miqtë”), duke treguar se si rrjetet e bashkëmoshatarëve shërbejnë si një kanal i lehtë për atë që tërheq vëmendje dhe përhapet më tej. (SMD, MKD)

Çfarë ishte e dukshme në mjedisin më të gjerë të informacionit

LSL-ja mbështet rëndësinë e formateve edukative të përshtatura për vetë platformat. Videot shpjeguese, videot e shkurtra dhe komentet e drejtuara nga krijues përmbajtjeje janë shumë të pranishme në hapësirat e frekuentuara nga të rinjtë, duke sugjeruar se mesazhet e edukimit mediatic dhe informativ duhet ta arrijnë audiencën aty ku ndodhet, përmes formateve të shkurtra, praktike dhe të lehta për t’u shpërndarë. Shënimet nga terreni të LSL-së tregojnë gjithashtu se një pjesë e përmbajtjes më me ndikim nuk paraqitet fare si “lajm”, duke përforcuar nevojën për çasje ndërkurrikulare dhe të bazuara në aftësi, në vend të mësimëve të izoluara të edukimit mediatic dhe informativ.

Modelet dhe tensionet rajonale

Në të gjithë BP6, ekziston një bindje e fortë dhe e përbashkët se edukimi mediatik dhe informativ duhet të forcohet në shkolla dhe të nisë më herët. Po ashtu, pranohet gjerësisht se prindërit dhe mësuesit kanë nevojë për mbështetje, si për faktin që të rriturit mund të përhapin pa dashje keqinformim, ashtu edhe sepse të rinjtë nuk mund ta mbajnë këtë barrë të vetëm.

Një tension kryesor lidhet me zbatimin. Pjesëmarrësit duan që shkollat të veprojnë, por njëkohësisht njohin ngarkesën e mësuesve, pabarazitë në burime dhe rrezikun që edukimi mediatik dhe informativ të kthehet në një “formalitet” në vend të një aftësie praktike. Një tjetër tension lidhet me besimin: në kontekste ku besimi ndaj institucioneve është i dobët, mesazhet formale mund të injorohen, duke rritur rëndësinë e qasjeve të drejtuara nga bashkëmoshatarët dhe krijuesit e përmbajtjes, të cilat përhapen përmes rrjeteve të besueshme.

Pse ka rëndësi kjo

Nëse edukimi mediatik dhe informativ konsiderohet si infrastrukturë, ai kërkon investim të vazhdueshëm dhe jo fushata të njëhershme. Kjo përfshin mbështetjen e mësuesve me zhvillim të vazhdueshëm profesional dhe mjete të gatshme për përdorim në klasë; integrimin e të menduarit kritik dhe higjienës digjitale në të gjitha lëndët; si dhe mbështetjen e prindërve dhe kujdestarëve në mënyra që shmangin fajësimin dhe fokusohen te praktikat e përditshme. Po ashtu, kjo nënkupton krijimin e mesazheve të orientuara drejt të rinjve përmes bashkëpunimit dhe komunikimit mes bashkëmoshatarëve, duke përdorur formate që i angazhojnë realisht. Në thelb, ndërtimi i qëndrueshmërisë kërkon zhvillimin e aftësive në të gjitha brezat, duke garantuar që të rinjtë të mos mbeten vetëm përballë një mjedisi informativ kompleks dhe në ndryshim të vazhdueshëm.



Gjetjet: Dy nëntema

Dy nëntemat në këtë kapitull janë shfaqur në të gjithë setin e të dhënave, por më pak në mënyrë të qëndrueshme krahasuar me temat kryesore. Ato janë përfshirë sepse ndihmojnë të shpjegohet se si të rinjtë e kuptojnë pasigurinë dhe pse disa dinamika të informacionit duken veçanërisht të vështira për t'u zgjidhur. Në të dy rastet, nëntemat nxjerrin në pah rreziqe në zhvillim dhe fusha për t'u monitoruar: si kornizat narrative ndikojnë në atë që konsiderohet si “fakt” dhe si format e reja të përmbajtjes sintetike ose të manipuluar mund të dobësojnë shenjat e përditshme të autenticitetit.

7

Gjetjet: Dy nëntema



7.1 Nëntema 1:

Nuk ekzistojnë “fakte të pastra” – vetëm narrativa nga të cilat zgjidhet

Për shumë të rinj, informacioni përjetohet më pak si “fakte kundrejt gënjeshtrove” dhe më shumë si narrativa që konkurrojnë me njëra-tjetrën, ku sfida është të zgjedhin cilin interpretim të besojnë, në vend që të verifikojnë një pretendim të vetëm.

Përkufizim i shkurtër (fushëveprimi dhe kufijtë)

Ky përkufizim thekson një zhvendosje nga të menduarit binar (“e vërtetë/e pavërtetë”) drejt të menduarit interpretativ (“cila histori përshtatet, kush përfiton, si është kornizuar çështja?”). Pjesëmarrësit shpesh shprehën se “të gjithë kanë një agjendë” dhe se e njëjta ngjarje mund të paraqitet përmes këndvështrimeve të ndryshme që duken legjitime. Kjo temë shfaqet veçanërisht në çështje të politizuara, në temat e identitetit dhe në debatet shoqërore polarizuese.

Ky nuk është relativizëm (“asgjë nuk është e vërtetë”). Përkundrazi, kjo pasqyron një përvojë praktike: në mjedise të kontestuara, të rinjtë shpesh hasin versione të shumta të realitetit dhe besueshmëria varet nga zgjedhja e narrativës, jo vetëm nga verifikimi i fakteve.

Pikat kryesore të gjetjeve

Vëzhgimet kryesore (FGD/KII)

Pjesëmarrësit përshkruan se përballen me interpretime të ndryshme dhe e kanë të vështirë të gjejnë një pikë referimi të besueshme.

“Sinqerisht, nuk besoj në informacion objektiv. Nuk mendoj se mund të kemi qasje në të dhëna thjesht faktike. Besoj se gjithçka është një narrativë dhe kjo është në rregull — pyetja është kë lexojmë dhe interpretimin e kujt për atë që ka ndodhur e pranojmë, sepse në fund kemi vetëm interpretime.” (REG, FGD). Një informator kyç shpjegoi gjithashtu se si niveli i ulët i besimit dhe polarizimi krijojnë kushte ku narrativat alternative fitojnë terren. *“Në Bosnje dhe Hercegovinë, gjithçka është gjithmonë një narrativë politike — çdo gjë lidhet me politikën. Me kalimin e kohës, njerëzit fillojnë të ndiejnë se ‘janë të gjithë njësoj’ dhe ‘të gjithë gënjejnë’, dhe kjo e bën të vështirë të ndryshohet diçka.”* (BiH, KII).

“Sinqerisht, nuk besoj në informacion objektiv. Nuk mendoj se mund të kemi qasje në të dhëna thjesht faktike. Besoj se gjithçka është një narrativë dhe kjo është në rregull — pyetja është kë lexojmë dhe interpretimin e kujt për atë që ka ndodhur e pranojmë, sepse në fund kemi vetëm interpretime.”

REG, FGD

Shënimet kryesore të ditarit

Shënimet në ditar e pasqyrojnë këtë fenomen si një “besim të përzier” dhe hezitim, më tepër sesa si një pranim apo refuzim të prerë. Pjesëmarrësit shpesh shënonin se i besonin një postimi “jo plotësisht” ose se nuk arrinin të përcaktonin çfarë ishte e vërtetë, çka shpesh pasohej nga tërheqje ose mbështetje në sinjale sociale për orientim.

- Në Serbi, për shembull, një pjesëmarrës/e e vlerësoi besimin si të ndërmjetëm dhe e përshkroi postimin si të afërt në përmbajtje, por jo krejtësisht të besueshëm, duke treguar se si interpretimi shpesh qëndron mes gjykimit të së vërtetës dhe rezonancës me identitetin personal. (SMD, SRB; besim i ndërmjetëm/i pasigurt)
- Në Kosovë, një pjesëmarrës/e e kategorizoi besimin si të përzier sepse materiali dukej “në pjesën më të madhe i saktë, por i paraqitur nga një këndvështrim i vetëm”, duke reflektuar më shumë hezitim sesa pranim ose refuzim. (SMD, KOS)
- Në Maqedoninë e Veriut, një pjesëmarrës/e shënoi se i besoi “deri diku” një postimi lajmesh, por vuri në dukje se “mungonin disa të dhëna”; më pas përdori komentet si një mënyrë të shpejtë për të kuptuar situatën dhe zgjodhi të mos e shpërndajë. (SMD, MKD)

Shënim mbi kontekstin më të gjerë

LSL mbështet praninë e kornizimeve të polarizuara dhe të modeleve narrative që përsëriten në çështje politike dhe shoqërore. Edhe kur pohimet individuale janë të vështira për t'u verifikuar nga gjurmët publike, njëtrajtshmëria e kornizimit dhe përsëritja në burime të ndryshme mund të krijojnë përshtypjen se “gjithçka është narrative”, duke përforcuar lodhjen interpretative.



Aty ku ka më shumë rëndësi (vende/kontekste)

Kjo temë është më e dukshme aty ku mungesa e besimit dhe polarizimi janë të theksuara, veçanërisht në çështje që lidhen me identitetin, gjeopolitikën ose politikën me rëndësi të lartë. Ajo shfaqet gjithashtu në hapësira ku të rinjtë mbështeten tek influencuesit dhe formatet komentative që ndërthurin informacionin me opinionin, duke e bërë kornizimin narrativ më të theksuar sesa zinxhiri i provave.

Çfarë duhet pasur parasysh (në praktikë)

Këto janë tregues që mund të identifikohen përmes punës së përditshme me të rinjtë dhe monitorimit të mediave, pa pasur nevojë për një studim të ri.

1. Organizatat e të rinjve, shkollat dhe praktikuesit mund të vëzhgojnë ndryshime në përdorimin e gjuhës gjatë seminareve praktike, seancave këshillimore, diskutimeve në grup dhe orëve mësimore: a përdoret shprehja “çdo gjë e ka një agjendë” si shenjë e mendimit kritik, apo si shenjë dorëzimi (“nuk ka kuptim të verifikohet”)?
2. Partnerët mediatikë, verifikuesit e fakteve dhe ekipet digjitale mund të analizojnë se cilat narrativa dominojnë në momentet me rëndësi të lartë duke ndjekur trendet në platforma dhe komentet, si dhe duke vërejtur kur i njëjti kornizim fillon të qarkullojë në kanale private përmes pamjeve të ekranit (screenshot) ose shpërndarjeve nga të rinjtë (me pëlqim dhe masa për mbrojtjen e privatësisë).



Gjetjet: Dy nëntema

7.2 Sporedna tema 2

Autenticiteti i IA-së (konfuzion në rritje + sinjale)

Përmbajtja sintetike dhe e manipuluar po shton pasigurinë mbi atë që konsiderohet “reale”, duke zbehur sinjalet e zakonshme të autenticitetit dhe duke bërë që vendimet për besueshmërinë të mbështeten më tepër tek identiteti i burimit dhe treguesit e platformës.

Përkufizim i shkurtër (fushëveprimi dhe kufijtë)

Kjo temë nxjerr në pah një konfuzion në rritje rreth mediave të krijuara apo të modifikuara nga IA, duke përfshirë dyshime nëse imazhet, videot dhe zërat janë autentikë. Ajo trajton gjithashtu dobësimin e besimit të parimi “ta shohësh do të thotë ta besosh”, veçanërisht në formatet e shkurtra dhe lehtësisht të shpërndara, ku konteksti dhe origjina shpesh janë të paqarta.

Kjo temë konsiderohet “nëntemë” sepse referencat eksplicite ndaj IA-së nuk ishin të shpërndara në mënyrë të njëtrajtshme mes vendeve dhe metodave. Megjithatë, aty ku u shfaq, ajo sinjalizoi një rrezik të lartë potencial, pasi dobëson sinjalet bazë mbi të cilat të rinjtë mbështeten për të orientuar shpejt informacionin.

Pikat kryesore të gjetjeve

Vëzhgimet kryesore (FGD/KII)

Pjesëmarrësit dhe informatorët theksuan një shqetësim në rritje se po bëhet gjithnjë e më e vështirë të dallosh realen nga ajo që është e sajuar në internet. *“Të them të drejtën, është disi shqetësuese sa kohët e fundit është bërë gjithnjë e më e vështirë edhe për mua të identifikoj përmbajtjen e krijuar nga AI. Nganjëherë — sidomos kur bëhet fjalë për video — është e frikshme sa shumë ka përparuar dhe sa shpejt po zhvillohet... Nuk arrij të dalloj nëse është e rreme apo jo.”* (BiH, FGD).

Kjo pasiguri mund të përkthehet shpesh në një lloj hipervigjilence dhe mosbesimi, edhe te ata që nuk kërkojnë në mënyrë aktive lajmet: *“Aspak — unë nuk i përdor rrjetet sociale për t’u informuar, por lajmet më dalin vazhdimisht... dhe ndoshta për shkak të rritjes së inteligjencës artificiale ndihem sikur po bëhem paranojak, sepse çdo lajm që shoh... e vë menjëherë në pikëpyetje... Nuk mund ta besoj plotësisht; më duhet të drejtohem te ndonjë portal institucional...”* (REG, FGD). Një informator kyç theksoi se përmbajtja sintetike mund ta amplifikojë manipulimin, duke e bërë më të lehtë imitimin dhe prodhimin e materialeve që duken “zyrtare”: *“Për shembull, nuk është e lehtë për askënd prej nesh që të përcaktojë me siguri çfarë është reale dhe çfarë jo kur përballemi me një deepfake... Pra, është e vështirë për të gjithë, por ata që nuk kanë njohuritë dhe aftësitë e duhura ose akses në mbështetje të tillë, janë padyshim më të rrezikuar...”* (ALB, KII).

„Ndihehem sikur po bëhem paranojak, sepse çdo lajm që shoh... e vë menjëherë në pikëpyetje... Nuk mund ta besoj plotësisht; më duhet të drejtohem te ndonjë portal institucional...”

REG, FGD

Shënimet kryesore të ditarit

Shënimet në ditar tregojnë pasiguri dhe kujdes. Pjesëmarrësit ndonjëherë e shënonin besimin si të përzier ose të pasigurt kur përballeshin me përmbajtje vizualisht bindëse, veçanërisht kur postimet nuk kishin një zinxhir të qartë burimesh. Kur reagonin, ata shpesh mbështeteshin në sinjale indirekte (“kush e ka postuar”, “a lidhet me një burim të besueshëm”) në vend që të vlerësonin vetë median. (SMD; besim i përzier/i pasigurt)

Shënim mbi kontekstin më të gjerë

Vëzhgimet e LSL-së tregojnë se formatet e natyrshme të platformave e vështirësojnë ndjekjen e origjinës: zinxhirët e ripostimeve, videot e shkurtuara dhe ri-kontekstualizimi në formë memesh e ulin mundësinë e gjurmimit. Kjo shton gjasat që përmbajtja e manipuluar ose e gjeneruar në mënyrë sintetike të qarkullojë pa u vënë re, sidomos kur përputhet me narrativat ekzistuese ose nxit reagime të forta emocionale.


Aty ku ka më shumë rëndësi (vende/kontekste)

Kjo temë ka gjasa të jetë më e rëndësishme gjatë momenteve me rëndësi të lartë (zgjedhje, kriza, narrativa të lidhura me konflikte) dhe në mjedise me besim të ulët institucional, ku sinjalet e burimeve tashmë vihen në dyshim. Ajo është gjithashtu e rëndësishme në kontekste ku të rinjtë mbështeten shumë në video me format të shkurtër dhe në komentet e influencuesve, të cilat shpesh shpëputen nga konteksti origjinal.

Çfarë duhet pasur parasysh (në praktikë)

Këto janë tregues të hershëm që mësuesit, ata që punojnë me të rinjtë dhe partnerët mediatikë mund t'i identifikojnë përmes punës së përditshme dhe monitorimit publik.

- 1. Në shkolla, programe rinore dhe hapësira me bashkëmoshatarë** vëzhgoni reagimet e të rinjve kur dyshojnë se një përmbajtje është e gjeneruar ose e redaktuar nga IA: a tërhiqen (“nuk i besoj më asgjëje”), apo mbështeten më shumë te “kush e ka publikuar” (miq, influencues, llogari “zyrtare”) si një mënyrë e shpejtë për të vendosur besimin?
- 2. Në sesione të edukimit mediatik dhe në shpjegime të bazuara në platforma** fokusohuni te “rregullat praktike” që të rinjtë përdorin për të dalluar përmbajtjen sintetike (p.sh. “duket shumë perfekte” ose “zëri nuk tingëllon natyrshëm”). Vëzhgoni nëse këto sinjale i ndihmojnë realisht ata të ndalojnë dhe të verifikojnë, apo nëse shpërfillen lehtë dhe zëvendësohen nga prova sociale (“të gjithë po e shpërndajnë, pra duhet të jetë e vërtetë”).



Gjetjet: Dy nëntema

Përmbledhje ndër-rajonale

Ky kapitull kalon në një perspektivë më të gjerë nga shtatë temat kryesore për të nxjerrë në pah çfarë është e përbashkët në BP6, ku vendet shfaqin thekse të dallueshme dhe si duhen interpretuar ndryshimet ndërmjet metodave. Sinteza mbështetet në matricën krahasuese (dukshmëria e temave në grupet e të dhënave sipas vendeve), në perspektivat specifike për secilin vend të identifikuar gjatë analizës, si dhe në triangulimin ndërmjet grupeve të fokusit dhe intervistave, ditarëve të rrjeteve sociale dhe monitorimit të lehtë të rrjeteve sociale.




8

8.1 Si të lexohet matrica krahasuese

Matrica krahasuese përmbledh dukshmërinë e secilës temë në grupet e të dhënave sipas vendeve, bazuar në përqindjen e citimeve të koduara të lidhura me atë temë. Këto përqindje ndihmojnë të tregojnë se ku një temë është veçanërisht e theksuar në rrëfimet e pjesëmarrësve, por nuk duhet të lexohen si një renditje e “ashpërsisë” apo si një krahasim i drejtpërdrejtë i “performancës” kombëtare. Dallimet mund të pasqyrojnë ngjarje lokale gjatë periudhës së mbledhjes së të dhënave, llojet e përvojave që pjesëmarrësit kanë zgjedhur të theksojnë, si dhe çfarë është më ose më pak e vëzhgueshme përmes metodave të ndryshme.

Në përgjithësi, mesazhi më i fortë ndër-vendor është thirrja për të “rregulluar në rrënjë”. Dukshmëria relative e temave sipas vendeve përmbledhet në Figurën 1.

Krahasueshmëria e dukshmërisë së temave në grupet e të dhënave të vendeve të WB6



Tema 6 është tema më e dukshme në të gjitha vendet, veçanërisht në Bosnjë dhe Hercegovinë (48 për qind), Kosovë (46 për qind), Maqedoninë e Veriut (44 për qind), Malin e Zi (43 për qind) dhe Shqipëri (39 për qind). Kjo mbështet një perspektivë të qëndrueshme rinore: barra e trajtimit të dezinformimit dhe informacionit të gabuar nuk mund të bjerë vetëm mbi individët kur sistemet dhe nxitjet mbeten të dobëta.

Dy tema të tjera mbeten dukshëm të forta në të gjithë BP6. Tema 1 (“Besimi qarkullon përmes njerëzve”) dhe Tema 7 (“Edukimi mediatik si infrastrukturë”) shfaqen vazhdimisht në të gjitha grupet e të dhënave, veçanërisht në Bosnje dhe Hercegovinë (Tema 1 në 35 për qind; Tema 7 në 38 për qind). Në praktikë, kjo tregon se besueshmëria kuptohet përgjithësisht përmes sinjaleve sociale dhe relacionale, dhe se zgjidhjet shihen kryesisht si kolektive, ndërbrezore dhe institucionale, dhe jo vetëm individuale.

Ndryshe nga kjo, mekanizmat e platformave të përshkruara në Temën 3 (“Platformat formësojnë atë që bëhet normë”) shfaqin më shumë variacion nëpër BP6. Kjo temë është më e theksuar në Maqedoninë e Veriut (20 për qind) dhe Kosovë (15 për qind), por më pak në vendet e tjera. Tema 4 (“Ndarja nuk është gjithmonë besim”) është përgjithësisht më e ulët në shumicën e grupeve të të dhënave, megjithatë është më e pranishme në Bosnje dhe Hercegovinë (11 për qind) dhe Kosovë (10 për qind). Kjo sugjeron se humori, ndjenja e përkatësisë dhe dinamika e ndarjes sociale janë të pranishme në të gjitha vendet, por theksohen ndryshe në mënyrën se si të rinjtë i diskutojnë mjediset e tyre.

Edhe nëntemat janë të paqëndrueshme. “Nuk ka fakte të pastra — vetëm narrativa nga ku mund të zgjedhësh” (Nëntema 7.1) është relativisht e theksuar në Kosovë (21 për qind) dhe Shqipëri (19 për qind), ndërsa “autenticiteti i IA-së” (Nëntema 7.2) shfaqet në nivele më të ulëta në të gjitha grupet e të dhënave (rreth 4–7 për qind). Edhe në këto nivele të ulëta, nëntema e dytë mbetet një rrezik i rëndësishëm në zhvillim, sepse prish sinjalet e përditshme mbi të cilat të rinjtë mbështeten për të përcaktuar çfarë është reale.

8.2 Modele të përbashkëta në të gjithë BP6

Në të gjithë BP6, të rinjtë përshkruajnë përvoja të ngjashme me presionet dhe mënyrat e shkurtra që përdorin në përballje me informacionin e përditshëm. Studimi ynë nuk ka zbuluar dallime të rëndësishme sipas gjinisë – megjithatë, kjo mund të jetë një temë që vlen të eksplorohet më thellë përmes kërkimeve dhe analizave të mëtejshme. Besueshmëria shpesh vlerësohet fillimisht në mënyrë shoqërore, përpara se të analizohet mbi bazë faktesh: kush e ka shpërndarë një përmbajtje, sa i njohur duket një profil dhe nëse një burim perceptohet si “zyrtar”, kanë peshë të madhe — ndonjëherë po aq sa vetë përmbajtja. Ndërkohë, verifikimi shihet si i nevojshëm, por edhe si një proces që kërkon kohë dhe përpjekje. Për këtë arsye, shumë të rinj e përshkruajnë kontrollin si selektiv, të kufizuar në kohë, ose ua besojnë personave që i konsiderojnë të besueshëm, në vend që ta kenë si praktikë të përditshme.

Veçoritë e platformave më pas ndikojnë në mënyrën se si zhvillohen këto zgjedhje. Të rinjtë shpesh e përjetojnë ekspozimin si të personalizuar, por njëkohësisht të modeluar: disa tema shfaqen shpejt, dominojnë vëmendjen dhe bëhen të vështira për t'u shmangur, ndërsa komentet dhe sinjalet e angazhimit shërbejnë si një shtresë dytësore interpretimi. Shpërndarja zakonisht përshkruhet si sociale dhe jo bindëse; humori, përkatësia dhe sinjalizimi i identitetit janë motive të zakonshme, por efektet e amplifikimit vazhdojnë të jenë të pranishme.

Me kalimin e kohës, ekspozimi me volum dhe intensitet të lartë shpesh çon në reagime emocionale. Konfuzioni, lodhja dhe irritimi bëjnë që shumë të rinj të adoptojnë strategji përballuese si shmangia, heshtja (muting), ose kufizimi i ekspozimit. Të tjerë bëhen hipervigjilentë, duke kërkuar vazhdimisht shenja manipulimi në mënyra që janë të vështira për t'u mbajtur në kohë. Në këtë kontekst, nuk është për t'u habitur që përgjegjësia shpesh u atribuohet burimeve të rrjedhës së mësipërme. Në të gjithë vendet, të rinjtë kërkojnë standarde të përmirësuara, zbatim më të fortë, ekosisteme mediatike më transparente dhe përgjegjësi më të qartë të platformave. Ata gjithashtu e shohin edukimin mediatik si infrastrukturë: diçka që duhet të mbështetet nga shkollat, familjet dhe komunitetet dhe të përditësohet vazhdimisht me ndryshimin e mjedisit.

8.3 Veçoritë sipas vendeve (si ndryshon theksi sipas kontekstit)

Ndërsa dinamikat kryesore janë të përbashkëta, të dhënat për secilin vend nxjerrin në pah edhe thekse të veçanta. Në Shqipëri, diskutimet e lidhin fort çrregullimin e informacionit me mungesën e besimit dhe polarizimin, duke treguar një ndjeshmëri të lartë ndaj narrativave konkurruese dhe shqetësimeve në rritje për autenticitetin. Në Bosnje dhe Hercegovinë vihet re një theks i veçantë mbi sinjalet që lidhen me burimin dhe transparencën, si edhe një fokus i fortë mbi përgjegjësinë e burimeve në origjinë dhe rolin e edukimit në zhvillimin e mendimit kritik. Në Kosovë, dinamika e platformave dhe konkurrenca e narrativave janë veçanërisht të dukshme, me një theks të madh mbi përgjegjësinë e sistemit dhe dimensionin social të të nxënit. Në Maqedoninë e Veriut, bien në sy “normalizimi” i platformave dhe boshllëqet në politika, ndërsa të rinjtë shpesh përshkruajnë se si mënyra e shpërndarjes nga platformat ndikon në atë që perceptohet si e pashmangshme. Në Mal të Zi, qasja që fokusohet te burimet në origjinë është e fortë dhe shpesh shprehet përmes vëmendjes ndaj sistemeve dhe standardeve, ndërsa praktikat e përditshme për të vendosur se çfarë është e besueshme mbeten të kufizuara nga koha dhe pasiguria. Në Serbi, praktikat e verifikimit janë më të theksuara krahasimisht, së bashku me një shqetësim të fortë për përgjegjësinë dhe një ndërgjegjësim të qartë se familja dhe rrjetet shoqërore formësojnë interpretimin e përditshëm.

Shqipëria (ALB)

Në Shqipëri, të rinjtë theksojnë rëndësinë e polarizimit dhe mungesës së besimit në mënyrën se si ata e kuptojnë informacionin. Konkurrenca midis narrativave është shumë e dukshme, me të rinjtë që shpesh përballen me interpretime të ndryshme në vend të një ndarje të thjeshtë të saktë/gabim.

- Besimi shihet shpesh si një shkurtore sociale, i ndikuar nga besueshmëria e ulët e institucioneve dhe polarizimi politik.
- Narrativat konkurruese janë të pranishme dhe pasiguria shprehet si dilema “cilin interpretim të pranoj”.
- Shqetësimet për autenticitetin e informacionit rriten së bashku me skepticizmin e përgjithshëm për atë që është reale online.

Bosnja dhe Hercegovina (BiH)

Në Bosnje dhe Hercegovinë, të rinjtë mbështeten shumë te sinjalet që lidhen me burimet dhe mediat për të vlerësuar besueshmërinë, duke i kushtuar gjithashtu vëmendje mungesës së përgjegjesisë dhe zbatimit të dobët të rregullave. Lodhja emocionale është më e dukshme, duke ndikuar në mënyrën se si ata përballen me informacionin.

- Besueshmëria lidhet ngushtë me tregues transparence dhe legjitimiteti, si media investigative të njohura dhe identifikuesit e tyre.
- Problemet me përgjegjësinë në burim janë të forta, sidomos për praktikën e portaleve dhe zbatimin e kufizuar të rregullave.
- Mbingarkesa dhe konfuzioni janë të zakonshme dhe shmangja përdoret shpesh si mekanizëm për t’u përballur me situatën.

Kosova (KOS)

Në Kosovë, të rinjtë e perceptojnë keqinformimin dhe dezinformimin si një problem të lidhur me të gjithë sistemin, me fokus të fortë te mekanizmat e platformave dhe ndikimi i narrativave në tema të politizuara dhe të lidhura me identitetin. Interpretimi i informacionit shpesh përshkruhet si proces social dhe marrëdhënieve.

- Përgjegjësia vendoset kryesisht në burim, me fokus te standardet mediatike, përgjegjësia e platformave dhe reagimi institucional.
- Dinamikat e platformave janë të dukshme, duke përfshirë komentimin nga influencuesit dhe përhapjen e përmbajtjeve sipas angazhimit të përdoruesve.
- Përzgjedhja e narrativave ka rëndësi të veçantë, ku besueshmëria varet nga konteksti, mënyra e prezantimit dhe interpretimi në grup.

Maqedonia e Veriut (MKD)

Në Maqedoninë e Veriut, bie në sy fenomeni i “normalizimit” nga platformat: të rinjtë shpjegojnë se si shpërndarja algoritmike dhe përsëritja e përmbajtjes krijojnë ndjesinë se disa gjëra janë të pashmangshme. Në të njëjtën kohë, besimi tek institucionet shpesh perceptohet në rënie, gjë që ushqen distancimin dhe cinizmin.

- Algoritmet dhe përsëritja ndikojnë shumë në atë që ndihet “normale” dhe në ekspozimin ndaj informacionit.
- Boshllëqet në burim (standardet, zbatim dhe besimi institucional) janë të dukshme në rrëfimet e të rinjve.
- Praktikrat e verifikimit dhe raportimit janë të kufizuara nga koha dhe lodhja, me pak besim se raportimi sjell ndryshim.

Mali i Zi (MNE)

Në Mal të Zi, të rinjtë theksojnë fort përgjegjësinë dhe standardet në nivel sistemi, ndërsa besueshmëria shpesh vlerësohet nga mënyra se si prezantohet informacioni dhe kush e ka burimin. Pasiguria menaxhohet përmes shmangies ose sinjaleve sociale, jo përmes kontrollit të rregullt.

- Përgjegjësia në nivel sistemi është fokusi kryesor, duke përfshirë standardet, kufizimet e zbatimit dhe llogaridhënien.
- Besueshmëria shpesh vlerësohet nga sinjalet e “prezantimit” (toni, stili, sa ngjan si “lajm” përmbajtja), si dhe identiteti i burimit.
- Ekzistojnë shqetësime për autenticitet, por ato zakonisht janë pjesë e skepticizmit më të gjerë mbi cilësinë e përmbajtjes online.

Serbia (SRB)

Në Serbi, praktikrat e verifikimit marrin një rëndësi më të madhe krahasuar me disa vende të tjera, duke përfshirë kërkim dhe krahasim të informacionit. Interpretimi i përditshëm mbetet i lidhur ngushtë me diskutimet me miqtë dhe familjen, komentet online dhe shqetësimet për përgjegjësinë e burimeve dhe stimujt e amplifikimit.

- Praktikrat e verifikimit, si kërkimi dhe krahasimi, përmenden shpesh, edhe kur përdoren selektivisht.
- Rrjetet e familjes dhe bashkëmoshatarëve mbeten të domosdoshme për të kuptuar informacionin, me komente dhe diskutime në grup që ndikojnë në interpretim.
- Shqetësimet mbi përgjegjësinë e burimeve janë të rëndësishme, sidomos në lidhje me praktikrat mediatike dhe mënyrën si platformat amplifikojnë përmbajtje.

8.4 Kontradiktat ndër-metodike (dhe çfarë mund të nënkuptojnë ato)

Triangulimi i të dhënave nga metodat e ndryshme zbulon disa boshllëqe të përsëritura që janë të rëndësishme nga pikëpamja analitike. Një nga më të qëndrueshmet është boshllëku normë–sjellje. Në grupet e fokusit dhe intervistat, të rinjtë shpesh përshkruajnë kontrollimin e informacionit si një parim; ndërsa në ditarë, kontrollimi shihet më selektiv dhe i varur nga rëndësia personale, pasiguria ose perceptimi i rrezikut. Kjo nuk nënkupton pandershmëri. Ajo pasqyron konkurrencën që verifikimi ka me kohën, vëmendjen dhe kapacitetin emocional në përdorimin e përditshëm.

Një çështje e dytë lidhet me dukshmërinë. Të rinjtë shpesh i përshkruajnë disa narrativa të caktuara si “kudo” ose “të pashmangshme”, veçanërisht gjatë periudhave me profil të lartë, si politika, krizat ose çështjet shoqërore ndarëse. Monitorimi i lehtë i rrjeteve sociale mund të tregojë një panoramë të ndryshme, ose sepse disa narrativa janë më të dukshme në hapësira private ose gjysmë-private që nuk mund të monitorohen lehtësisht, ose sepse feed-et janë shumë të personalizuar dhe ndryshojnë sipas vendndodhjes, gjuhës dhe rrjetit të përdoruesit. Në praktikë, ekspozimi i perceptuar reflekton realitetin e ndjerë të një feed-i të kuruar, ndërsa social listening kap gjurmët publike dhe të kërkueshme. Këto dy perspektiva duhet të shihen si shtesë njëra-tjetrës, jo si prova konkurruese.

Një kontradiktë e tretë lidhet me rolin e dyfishtë të seksioneve të komenteve. Pjesëmarrësit ndonjëherë i shohin komentet si një formë korrigjimi nga turma (“dikush do të thotë nëse është e rreme”). Megjithatë, ditarët dhe vëzhgimet tregojnë se komentet mund të rrisin gjithashtu armiqësinë, të thellojnë polarizimin dhe të shkaktojnë largim nga përmbajtja. Së fundi, humori ka një pozicion të ngjashëm dyfishtë: ai mund të ndihmojë të rinjtë të distancohen nga propaganda dhe të përballojnë intensitetin politik, por gjithashtu mund të mbajë gjallë narrativat mashtruese përmes angazhimit dhe shpërndarjes.

8.5 Kujdeset në interpretim

Tre paralajmërime janë të rëndësishme kur interpretohen ndryshimet ndërmjet vendeve. Së pari, proporcionet e temave tregojnë sa dukshëm shfaqen temat brenda të dhënave, jo domosdoshmërisht sa serioze ose të rëndësishme janë. Ato pasqyrojnë çfarë theksuan pjesëmarrësit, mënyrën se si u diskutuan përvojat dhe strukturën e materialit të koduar. Së dyti, metodat pasqyrojnë aspekte të ndryshme të mjedisit informativ. Ditarët reflektojnë feed-et e personalizuar dhe praktikën e përditshme të përdoruesve; ndërsa monitorimi i thjeshtë i rrjeteve sociale kap përmbajtje publike dhe të kërkueshme, por mund të mos shfaqë informacionin që qarkullon në hapësira private. Së treti, disa hapësira në platformat online janë të vështira për t'u vëzhguar sistematikisht dhe kufizimet e fillimit (cold start) mund të ndikojnë në ato që regjistrohen në vëzhgime. Për këtë arsye, triangulimi ndër-metodik është i domosdoshëm: interpretimi më i saktë arrihet duke kombinuar rrëfimet e pjesëmarrësve, sjelljen në ditarë dhe dukshmërinë publike.

Implikimet

Gjetjet tregojnë një realitet të thjeshtë: të rinjtë nuk po lëvizin në një “hapësirë informacioni” neutrale. Ata përballen me një mjedis të formësuar nga besimi shoqëror, dizajni i platformave, mungesa jo e barabartë e përgjegjësisë dhe lodhja emocionale. Implikimet që nxjerr ky kapitull burojnë direkt nga shtatë temat kryesore dhe analiza krahasimore ndër-vendore. Ato janë organizuar sipas sektorëve të interesit, sepse përgjegjësia nuk mund të bjerë vetëm mbi të rinjtë. Në praktikë, qëndrueshmëria është më e fortë kur aftësitë individuale mbështeten nga sisteme që e bëjnë informacionin të besueshëm, më të lehtë për t'u njohur, aksesuar dhe integruar në jetën e përditshme.

9

Në të gjitha sektorët e interesit dalin tre implikime kryesore. Së pari, besueshmëria shpesh është sociale para se të jetë bazuar në fakte. Çdo përgjigje që supozon se të rinjtë do të “kontrollojnë gjithmonë së pari” nuk do të funksionojë nëse nuk pasqyron mënyrën se si lind besimi: përmes njerëzve, marrëdhënieve dhe zërave të njohur. Së dyti, vështirësia ka rëndësi. Kur verifikimi duket si një punë, ai bëhet selektiv, i deleguar ose i shmangur. Zvogëlimi i vështirësisë – duke përdorur mjete praktike, sinjale më të qarta dhe shpjegime të besueshme, të lehta për t’u përdorur brenda platformave – nuk është vetëm një detaj teknik; është dallimi midis aftësisë që ekziston në letër dhe aftësisë që përdoret vërtet. Së treti, kapaciteti emocional është pjesë e sistemit. Mbingarkesa dhe lodhja nuk janë thjesht efekte anësore; ato ndikojnë në atë që të rinjtë mund të arrijnë praktikisht, çfarë lënë pas dore, çfarë ndajnë dhe me çfarë angazhohen. Nëse ndërhyrjet shtojnë më shumë barrë, ato mund t’i shtyjnë të rinjtë drejt distancimit.

Tabela më poshtë përmbledh implikimet kryesore për secilin sektor, ndërsa nënseksionet e mëtejshme ofrojnë diskutim më të detajuar.

Implikimet në një shikim të shpejtë sipas sektorëve të interesit

Sektori	Ç’do të thotë kjo në praktikë
Për të rinjtë	Gjykimet mbi besueshmërinë shpesh bëhen nën kushte shpejtësie, mbingarkese dhe ndikimi shoqëror. Prandaj, përgjigjet duhet të mbështesin praktika të kontrollit të informacionit që mund të zbatohen në mënyrë praktike, norma më të sigurta për ndarjen e përmbajtjes dhe strategji për të menaxhuar konfuzionin, lodhjen dhe ekspozimin ndaj informacionit.
Për sistemet arsimore	Edukimi mediatik dhe informativ duhet trajtuar si një infrastrukturë afatgjatë, jo si një mësim ose fushatë njëherëshe. Kjo nënkupton integrim në kurrikula, mbështetje për mësuesit, burime të aksesueshme dhe qasje që përfshijnë edhe prindërit dhe kujdestarët.
Për median dhe gazetarinë	Besimi nuk formësohet vetëm nga cilësia e përmbajtjes, por edhe nga transparenca dhe qëndrueshmëria e dukshme. Kjo nënkupton përdorimin e burimeve më të qarta, korrigjimeve, sinjaleve të pronësisë dhe formateve që përshtaten me mjediset ku të rinjtë përballen me informacionin në praktikë.
Për platformat dhe ekosistemin digjital	Dizajni i platformave ndikon në atë që bëhet e dukshme, e përsëritur dhe e normalizuar. Kjo nënkupton një vëmendje më të madhe ndaj sistemeve të rekomandimit, reklamave dhe transparencës së burimeve, moderimit dhe përgjegjësisë për dinamikën e amplifikimit.
Për shoqërinë civile dhe organizatat e të rinjve	Përgjigjet më efektive janë ato që janë praktike, të lidhura me kontekstin lokal dhe të zhvilluara së bashku me të rinjtë. Kjo nënkupton përdorimin e rrjeteve të besueshme të bashkëmohatarëve, formateve që përshtaten me platformat dhe ndërhyrjeve që lidhin qëllimet institucionale me sjelljet digjitale të përditshme.

9.1 Implikimet për vendimmarrjen e të rinjve

Vendimmarrja e të rinjve ndikohet nga nevoja për të përpunuar shpejt feed-e me volum të lartë informacioni. Në këto kushte, gjykimet “mjaftueshëm të mira” shpesh zëvendësojnë vlerësimin e plotë. Kjo nuk është thjesht një mungesë aftësishe; është një përshtatje logjike ndaj një mjedisi që vlerëson shpejtësinë, reagimin dhe përsëritjen.

Një implikim i parë është se sinjalet e besueshmërisë formojnë një shtresë themelore të vendimmarrjes. Të rinjtë shpesh mbështeten në atë se kush e ka shpërndarë informacionin, nëse burimi duket i njohur ose “zyrtar” dhe nëse duket i mbështetur gjerësisht. Këto sinjale shërbejnë si shkurtore praktike, por janë gjithashtu të ndjeshme ndaj manipulimit: imitimi i identitetit, formatimi profesional “si lajm”, angazhimi i koordinuar dhe amplifikimi nga influencues mund të imitojnë legjitimitetin. Mbështetja e të rinjve kërkon zhvillimin e “aftësive për të interpretuar sinjalet e besueshmërisë”, jo vetëm njohuritë për të kontrolluar informacionin, por edhe për të kuptuar sinjalet që formësojnë përshtypjet e para dhe për t'i njohur kur ato mund të jenë të manipuluar.

Një implikim i dytë është se verifikimi është i varur nga konteksti. Të rinjtë nuk kontrollojnë çdo informacion; ata zgjedhin prioritetet. Ata janë më të prirur të verifikojnë kur pasojat janë të mëdha, kur pasiguria krijon shqetësim ose kur një pretendim kërcënon identitetin ose sigurinë e tyre. Për këtë arsye, ndërhyrjet duhet të fokusohen në krijimin e rutinave të besueshme “nëse-atëherë” që reflektojnë sjelljen reale: “Nëse shkakton emocion të fortë, atëherë ndalo”; “Nëse kërkon veprim, pagesë, votim, dhurim ose frikësim, atëherë kontrollo”; “Nëse vjen përmes një zinxhiri të përcjellë më parë, atëherë trajtoje si të pa-verifikuar derisa të gjurmohet origjinën.” Këto janë më të zbatueshme se udhëzimet e përgjithshme për verifikimin e çdo përmbajtjeje.

Një implikim i tretë është se ndarja e informacionit është kryesisht shoqërore, jo bindëse, por prapë ndikon në mjedis. Të rinjtë shpesh ndajnë përmbajtje për humor, lidhje shoqërore ose sinjalizim identiteti, edhe kur besimi është i ulët ose i përzier. Qëllimi mund të jetë argëtues, por ndikimi mund të jetë amplifikim: përmbajtja përhapet më larg, bëhet më e njohur dhe interpretohet ndryshe nga audiencat që nuk njohin kontekstin origjinal. Kjo nënvizon nevojën për norma të sigurta për ndarjen e përmbajtjes, jo-moralizuese—sjellje të vogla dhe të lehta për t'u zbatuar, që ulin dëmin pa sakrifikuar lidhjet shoqërore. Normat më efektive janë ato që respektojnë motivimin e përdoruesve (“po ndaj për argëtim”), ndërsa bëjnë të dukshme pasojat (“informacioni përhapet gjithsesi”) dhe ofrojnë alternativa praktike (“shto kontekst”, “përdor paralajmërim në mënyrë të qëndrueshme”, “mos e përcill kur pretendimi shënjestron një grup ose një person të cënueshëm”).

Së fundi, mbingarkesa ndikon në sjellje. Kur të rinjtë janë të lodhur, ata ose shkëputen nga përmbajtja ose bëhen tepër vigjilentë. Të dyja janë mekanizma përballimi; asnjëri nuk mund të mbahet afatgjatë. Kjo tregon se mbështetja e të rinjve duhet të përfshijë mirëqenien digjitale si pjesë e ndërtimit të qëndrueshmërisë ndaj informacionit. Ndiham për menaxhimin e ekspozimit, pa fajësim ose turp, promovon vendimmarrje më të qëndrueshme dhe redukton rrezikun që lodhja të çojë në dorëzim (“asgjë nuk është e ditur”) ose cinizëm (“të gjithë gënjejnë”), gjë që mund të dobësojë besimin dhe ta bëjë manipulimin më të lehtë.

9.2 Implikimet për sistemet arsimore

Gjetjet e vendosin arsimin si një pikë kyçe ndërhyrjeje, por jo në një mënyrë të thjeshtë “t’u mësojmë të verifikojnë”. Të rinjtë po kërkojnë edukim për median dhe informacionin si infrastrukturë: diçka që zhvillohet me kalimin e kohës, përforcohet në lëndë të ndryshme dhe mbështetet ndër breza.

Implikimi i parë është se ndërhyrjet e njëhershme nuk mjaftojnë. Mjedisi informativ ndryshon më shpejt se kurrikulat statike. Nëse shkollat duhet të luajnë një rol mbrojtës, ato kanë nevojë për një model iterativ përsëritës që mund të përditësohet rregullisht me shembuj praktikë, formate të përshtatura për platformat dhe aktivitete të gatshme për klasë. Kjo nuk ka të bëjë me shtimin e një “teme shtesë” në një sistem tashmë të mbingarkuar; bëhet fjalë për integrimin e gjykimit të besueshmërisë, mendimit kritik dhe higjienës kibernetike në mësimin e përditshëm.

Implikimi i dytë është se mësuesit kanë nevojë për mbështetje, jo për fajësim. Të rinjtë i njohin kufizimet në kapacitet. Ata shohin gjithashtu se të rriturit mund të hasin të njëjtat vështirësi në këtë mjedis, ndonjëherë me më pak aftësi digjitale, por me më shumë vetëbesim. Prandaj, sistemet arsimore duhet të priorizojnë zhvillimin e vazhdueshëm profesional që është modular dhe praktik: njësi të shkurtra që i ndihmojnë mësuesit të përballen me taktika të reja (pamje mashtruese, media sintetike, klipe të manipuluar) dhe që ofrojnë rutina të gatshme për përdorim në klasë, jo vetëm teori. Të rriturit janë të rëndësishëm: mësuesit kanë më shumë gjasa të adoptojnë qasje që paraqiten si ndërtim mbështetës i kapaciteteve, sesa si detyrim.

Implikimi i tretë është integrimi ndërkurrikular. Edukimi mediatik nuk mund të kufizohet në një lëndë të vetme apo të mësohet vetëm si diçka opsionale. Mbrojtja më e fortë qëndron te mendimi kritik si aftësi e transferueshme: interpretimi i provave, njohja e kornizimit, dallimi midis faktit dhe opinionit, kuptimi i nxitësve dhe të mësuarit për të pyetur “çfarë mungon?”. Integrimi i këtyre aftësive në lëndë të ndryshme ul gjithashtu rrezikun që edukimi mediatik të bëhet “puna e dikujt tjetër”.

Implikimi i katërt është se arsimi duhet të jetë ndërbrezor. Shkollat mund të arrijnë të rinjtë, por prindërit dhe kujdestarët formësojnë praktikën e përditshme: çfarë shpërndahe, çfarë konsiderohet “e vërtetë” dhe si qarkullojnë frika dhe indinjata në kanalet familjare. Prandaj, sistemet arsimore dhe partnerët duhet të ofrojnë mbështetje të drejtuar ndaj prindërve që shmang turpërimin dhe thekson rutina praktike, si: si të reagojnë ndaj pretendimeve të shpërndara, si të demonstrojnë pasigurinë dhe si të diskutojnë keqinformimin pa përshkallëzuar konfliktin në shtëpi.

Së fundi, bashkëkrijimi me të rinjtë është i rëndësishëm. Në kontekste ku besimi institucional është i ulët, mesazhet e dërguara “nga lart” mund të injorohen. Qasjet e udhëhequra nga bashkëmohatarët dhe të dizajnuara nga të rinjtë priren të kenë shtrirje më të gjerë, veçanërisht kur përdorin stile specifike për platformat. Sistemet arsimore duhet ta shohin pjesëmarrjen e të rinjve jo si një shtesë, por si një parim themelor në materialet dhe mënyrën e zbatimit.

9.3 Implikimet për median dhe gazetarinë

Dëshmitë e të rinjve tregojnë se cilësia dhe llogaridhënia e medias ndikojnë në mjedisin më të gjerë. Ata nuk janë thjesht konsumatorë që kanë nevojë për aftësi; janë qytetarë që kuptojnë nxitësit, paragjykimin, sensacionalizmin dhe mungesën e qëndrueshmërisë. Kur ata e perceptojnë median si të papërgjegjshme ose të komprometuar politikisht, ata tërhiqen, mbështeten te burime sociale ndërmjetëse, ose e interpretojnë gjithçka si narrativë.

Implikimi i parë është se besimi duhet të ndërtohet përmes transparencës dhe qëndrueshmërisë. Të rinjtë shpesh mbështeten në sinjale besueshmërie si media të njohura, marka investigative, autorësia dhe tregues të transparencës. Kjo tregon se organizatat mediatike që fokusohen në burime të qarta, korrigjime të dukshme dhe pronësi transparente mund të rrisin besueshmërinë e tyre. Gjithashtu nënkupton se rregullatorët dhe aktorët e zhvillimit të medias duhet ta shohin transparencën si një mekanizëm praktik për ndërtimin e besimit dhe jo thjesht si një ideal abstrakt qeverisjeje.

Implikimi i dytë është se formati është po aq i rëndësishëm sa përmbajtja. Të rinjtë e hasin informacionin përmes klipeve të shkurtra, zinxhirëve të rishpërndarjes, meme-ve dhe komenteve të influencerëve. Strategjitë tradicionale të orientuara te “artikulli në radhë të parë” mund të humbasin hapësirat ku ndërtohet besimi. Mediat dhe verifikuesit e fakteve kanë nevojë për shpjegime të përshtatura për platformat, që janë të përmbledhura, të shpërndarshme dhe të dizajnuara sipas formateve që të rinjtë përdorin realisht. Qëllimi nuk është të “thjeshtëzohet” informacioni në mënyrë të tepruar, por që informacioni i besueshëm të bëhet i pranishëm në të njëjtën ekonomi vëmendjeje si përmbajtja mashtruese.

Implikimi i tretë është se vetëm korrigjimet nuk mjaftojnë kur narrativat janë të polarizuara. Kur të rinjtë përballen me informacion si interpretime konkurruese, pyetja shpesh nuk është “a është i vërtetë ky pretendim?”, por “çfarë historie po tregohet dhe pse?”. Gazetaria që e bën të dukshëm kornizimin—duke dalluar qartë faktet, interpretimin dhe opinionin—mund t’i ndihmojë të rinjtë të orientohen në këtë konkurrencë narrativesh pa u bërë cinikë apo të dorëzuar.

Implikimi i katërt është se kultura e komenteve dhe nxitësit e angazhimit ndikojnë në besueshmëri. Edhe gazetaria me cilësi të lartë mund të bëhet toksike ose mashtruese në seksione komentesh armiqësore dhe të rinjtë mund t’i perceptojnë ato si tregues besueshmërie. Organizatat mediatike dhe platformat duhet ta konsiderojnë moderimin dhe praktikën e komunitetit si pjesë të integritetit të informacionit, jo si një çështje të veçantë të “angazhimit”.

9.4 Impikimet për platformat dhe ekosistemet digjitale

Gjetjet tregojnë qartë se platformat nuk janë kanale neutrale shpërndarjeje. Ato ndikojnë në atë që bëhet e dukshme, në atë që perceptohet si normale dhe në atë që shpërblehet. Të rinjtë e shohin përsëritjen, rekomandimet dhe komentet si forca që formësojnë realitetin e tyre. Prandaj, çdo përgjigje kuptimplotë duhet të përfshijë llogaridhënien e platformave, krahas fuqizimit të përdoruesve.

Implikimi i parë është se amplifikimi është përgjegjësi. Sistemet e rekomandimit dhe renditja e bazuar në angazhim mund të normalizojnë kornizime të dëmshme përmes përsëritjes, edhe kur përmbajtja nuk është rreptësisht “e rreme”. Platformat duhet të mbajnë përgjegjësi jo vetëm për heqjen e përmbajtjes, por edhe për dinamikën e amplifikimit, veçanërisht gjatë periudhave me rëndësi të lartë, kur rriten polarizimi dhe intensiteti emocional.

Implikimi i dytë është se reklamimi dhe promovimi kërkojnë kufij më të qartë. Të rinjtë e interpretojnë përmbajtjen “e nxitur” si potencialisht të drejtuar nga interesa të caktuara, por njëkohësisht ekspozohen ndaj përmbajtjes së paguar që duket si organike. Etiketimi më i qartë, transparenca më e madhe mbi sponsorizimin dhe reklamimin politik, si dhe zbatimi më i rreptë i rregullave kundër reklamave mashtruese, mund të ndihmojnë në uljen e konfuzionit dhe cinizmit.

Implikimi i tretë lidhet me origjinën dhe autenticitetin. Edhe pse inteligjenca artificiale mund të mos jetë ende shqetësimi kryesor, ajo përbën një rrezik të rëndësishëm duke gërryer sinjalet e përditshme të autenticitetit. Platformat dhe aktorët e ekosistemit duhet të investojnë në sinjale të origjinës që kanë kuptim për përdoruesit e zakonshëm, jo vetëm në watermark-e teknike që mbeten të padukshme. Ata gjithashtu duhet të forcojnë integritetin e llogarive dhe mbrojtjen kundër imitimit, pasi të rinjtë shpesh mbështeten te “kush e ka postuar” si një tregues kyç besueshmërie.

Implikimi është se arkitektura e komenteve mund të shkaktojë dëm. Seksionet e komenteve mund të nxisin korigjimin, por gjithashtu mund të rrisin armiqësinë dhe të bëjnë që përdoruesit të tërhiqen. Platformat duhet të marrin në konsideratë dizajnin e komenteve, kapacitetin e moderimit dhe masat për parandalimin e abuzimit si pjesë të strategjive për integritetin e informacionit. Meqenëse shtresa e komenteve është një hapësirë kyçe ku formësohet kuptimi, ajo nuk duhet të lihet e pa menaxhuar, pasi mund të shkaktojë dëm.

Së fundi, platformat nuk mund të mbështeten vetëm te përdoruesit për sigurinë. Raportimi shpesh perceptohet si joefektiv. Nëse platformat duan që përdoruesit të raportojnë, procesi duhet të duket kuptimplotë: reagime të qarta, veprime të dukshme kur është e nevojshme dhe mundësi reale për përshkallëzim kur dëmi vazhdon.

9.5 Implikimet për shoqërinë civile dhe organizatat e të rinjve

Shoqëria civile dhe organizatat e të rinjve veprojnë në një pikë takimi praktike: ato gëzojnë besim, afërsi dhe aftësinë për t'i kthyer gjetjet në ndërhyrje të përditshme. Gjetjet sugjerojnë disa konsiderata për strukturimin e kësaj pune.

Së pari, duhet punuar duke u mbështetur te besimi ekzistues shoqëror. Meqenëse besueshmëria përhapet përmes njerëzve, ndërhyrjet duhet të angazhojnë në mënyrë të qartë rrjetet e besuara të bashkëmoshatarëve dhe zërat e komunitetit. Formatet “peer-to-peer”, ambasadorët e rinj dhe bashkëpunimet me krijues përmbajtjeje mund të shpërndajnë mesazhe në të njëjtat kanale që formësojnë bindjet dhe shpërndarjen e përditshme.


Së dyti, duhen priorizuar ndërhyrje të thjeshta dhe lehtësisht të zbatueshme. Të rinjtë nuk kanë mungesë ndërgjegjësimit, por përballen me kufizime praktike. Programet duhet të fokusohen në rutina të përdorshme në jetën e përditshme: rregulla të shpejta vendimmarrjeje, sinjale të qarta dhe zakone të sigurta shpërndarjeje. Mjetet më efektive janë zakonisht praktike—udhëzues të shkurtër, lista kontrolli dhe ushtrime të bazuara në situata konkrete—më shumë sesa materiale të gjata teorike.

Së treti, duhet të përfshihet dimensionin e qëndrueshmërisë emocionale. Mbingarkesa informative dhe ankthi ndikojnë drejtpërdrejt në aftësinë për t'u përballur me informacionin. Organizatat e të rinjve mund të ndihmojnë në krijimin e zakoneve më të shëndetshme të konsumimit të informacionit dhe në uljen e stigmatizimit të tërheqjes. Kjo kontribuon si në mirëqenien mendore, ashtu edhe në uljen e manipulimit që shfrytëzon frikën dhe lodhjen.

Së katërti, është e rëndësishme të ndërtohen lidhje ndërbrezore. Të rinjtë shpesh ndihen të detyruar të korrigjojnë prindërit ose të menaxhojnë informacionin që qarkullon në familje. Shoqëria civile mund të zhvillojë materiale dhe aktivitete për prindërit që nuk i fajësojnë brezat më të moshuar, por nxisin rutina të përbashkëta, dialog të respektueshëm dhe mënyra praktike për të trajtuar informacionin e dyshimtë.

Së fundi, mbështetja në nivel individual duhet të lidhet me përkrahjen në nivel sistemik. Të rinjtë tashmë kërkojnë llogaridhënie nga institucionet. Shoqëria civile mund t'i përkthejë këto kërkesa në politika konkrete: më shumë transparencë, zbatim më të fortë rregullash, përgjegjësi për platformat dhe mbështetje për median cilësore—duke shmangur njëkohësisht rrezikun e përdorimit politik të rregulloreve (normave). Në këtë mënyrë, qasja “që nga burimi” bëhet e prekshme dhe praktike.

Rekomandime



Rekomandimet e mëposhtme i përkthejnë gjetjet dhe implikimet në hapa praktikë. Ato synojnë të jenë të zbatueshme në kontekstin e BP6 dhe të përputhen me mënyrën se si të rinjtë e përpunojnë realisht informacionin: përmes sinjaleve të besimit shoqëror, nën kufizime kohore dhe duke përdorur formate të përshtatura për platformat. Rekomandimet janë të organizuara sipas fushave të aktorëve, por duhet të zbatohen në mënyrë të përbashkët. Veprimet e izoluara do të kenë ndikim të kufizuar nëse sistemi më i gjerë mbetet i pandryshuar.

10



10.1 Dhjetë rekomandime të prioritizuara (deklarata veprimi)

1. Përfshirja “e edukimit mbi sinjalet e besueshmërisë” në të gjitha përpjekjet mbështetëse dhe edukativo-mësimore të fokusuara te të rinjtë.

Të shkohet përtej mesazheve të thjeshta “kontrollo faktet”. Të rinjtë të edukohen mbi mënyrën se si krijohen dhe manipulohen sinjalet e besueshmërisë, si: identiteti i burimit, “zyrtariteti”, metrikat e angazhimit, pamjet profesionale dhe zinxhirët e rishpërndarjes, si dhe si të reagojnë me rregulla të thjeshta vendimmarrjeje (“ndalo kur je emocional”, “trajtoji shpërndarjet si të paverifikuara derisa të gjesh burimin origjinal”).

Aktorët kryesorë: ofruesit e arsimit, organizatat e të rinjve, partnerët mediatikë.

Afati kohor: i menjëhershëm (gjashtë deri në dymbëdhjetë muajt e ardhshëm)

Pse tani: besimi përhapet në mënyrë shoqërore dhe bëhet gjithnjë e më i lehtë për t'u imituar (Temat 1, 3, 4, 7).

2. Zvogëlimi i vështirësisë së verifikimit përmes rutinave të thjeshta dhe të përsëritshme që përpunohen me sjelljen reale të shfletimit.

Nxitja e përdorimit të e gjerë të një grupi të vogël rutinash “nëse-atëherë” në programe dhe materiale (për shembull: “Nëse të kërkon të veprosh, të paguash ose të të zërë paniku, atëherë verifiko”; “Nëse është e prerë/shkurtuar, gjëj versionin origjinal”; “Nëse është e shpërndarë, ndalo dhe gjëj burimin”). Kombinojini këto me mjete praktike dhe shembuj nga jeta reale, jo vetëm me teori.

Aktorët kryesorë: sistemet arsimore, organizatat e të rinjve, ofruesit e edukimit mediatik.

Afati kohor: i menjëhershëm (gjashtë deri në dymbëdhjetë muajt e ardhshëm)

Pse tani: verifikimi perceptohet si punë dhe bëhet selektiv (Tema 2).

3. Trajtimi i mirëqenies digjitale si pjesë e qëndrueshmërisë ndaj informacionit.

Përfshirja e zakoneve të shëndetshme të ekspozimit në edukimin mediatik dhe në mbështetjen për të rinjtë: menaxhimi i njoftimeve, vendosja e kufijve gjatë momenteve intensive dhe njohja kur “doom-scrolling” ushqen ankthin dhe dorëzimin. Kjo duhet prezantuar si mbrojtje, jo si shmangie apo diçka për t'u turpëruar.

Aktorët kryesorë: shkollat, organizatat e të rinjve, partnerët për shëndetin mendor dhe mirëqenien.

Afati kohor: i menjëhershëm (gjashtë deri në dymbëdhjetë muajt e ardhshëm)

Pse tani: mbingarkesa ndikon në emocione dhe, për rrjedhojë, në sjellje (Tema 5).

4. Krijimi i një modeli iterativ për Zhvillimin e Vazhdueshëm Profesional (CPD) të mësuesve mbi edukimin mediatik dhe higjienën kibernetike.

Të zhvillohen burime modulare të zhvillimit profesional, të përditësuara rregullisht dhe të përdorshme në klasë, të cilat fokusohen në ndërtimin e kapaciteteve mbështetëse. Këto modulare duhet të përfshijnë skenarë praktikë si pamje mashtruese, media sintetike, shpjegime nga influencerët dhe kornizimi politik, së bashku me aktivitete mësimore të gatshme që mund të përshtaten në lëndë të ndryshme.

Aktorët kryesorë: ministritë e arsimit, institutet e trajnimit të mësuesve dhe donatorët ose partnerët.

Afati kohor: afatmesëm (dymbëdhjetë deri në njëzet e katër muaj)

Pse tani: edukimi mediatik është infrastrukturë thelbësore që kërkon përditësime të vazhdueshme ndërsa taktikat evoluojnë (Tema 7).

5. Kalimi nga edukimi mediatik si lëndë më vete drejt integritit ndërkurrikular të mendimit kritik.

Të integrohet gjykimi i besueshmërisë, arsyetimi mbi evidencën dhe kuptimi i kornizimit narrativ në lëndë të ndryshme, në vend që edukimi mediatik të trajtohet si opsional. Të garantohet që vlerësimi dhe praktika në klasë të shpërblejnë mendimin kritik, jo thjesht përputhjen mekanike me rregullat.

Aktorët kryesorë: organet e kurrikulës, ministritë e arsimit dhe shkollat.

Afati kohor: afatmesëm (dymbëdhjetë deri në njëzet e katër muaj)

Pse tani: konkurrenca narrative dhe mungesa e besimit kërkojnë aftësi arsyetimi të transferueshme (Temat 1, 5, 7; Nëntema 7.1).

6. Zgjerimi i ndërhyrjeve në moshat e hershme dhe te familjet me mbështetje të drejtuar ndaj prindërve, pa fajësim.

Të zhvillohen materiale të përshtatura për moshën e fëmijëve në ciklet e arsimit parashkollor dhe fillor, së bashku me udhëzime për prindërit dhe kujdestarët që fokusohen në rutina praktike: menaxhimi i mesazheve të shpërndara, modelimi i pasigurisë dhe diskutimi i keqinformimit pa përshkallëzuar konfliktet.

Aktorët kryesorë: sistemet arsimore, shoqëria civile, shoqatat e prindërve.

Afati kohor: afatmesëm (dymbëdhjetë deri në njëzet e katër muaj)

Pse tani: zakonet e komunikimit familjar ndikojnë ekspozimin ndaj informacionit ndër breza (Tema 7).

7. Mbështetja e medias cilësore dhe verifikuesve të fakteve që të arrijnë te të rinjtë përmes shpjegimeve të përshtatura për platformat.

Të investohet në shpjegime 30–60 sekondëshe, karusele të shkurtra dhe formate miqësore për krijuesit e përmbajtjes që ofrojnë informacion të besueshëm kur të rinjtë përballen me pretendime. Kjo mund të kombinohet me burime transparente dhe me një dallim të qartë midis fakteve dhe interpretimit.

Aktorët kryesorë: organizatat mediatike, verifikuesit e fakteve, donatorët, partnerët rinorë.

Afati kohor: i menjëhershëm (gjashtë deri në dymbëdhjetë muajt e ardhshëm)

Pse tani: platformat ndikojnë ekspozimin; të rinjtë mbështeten tek interpretuesit dhe formatet e shkurtra (Temat 1, 3, 5).

8. Forcimi i llogaridhënies së platformave për amplifikimin, komentet dhe transparencën e reklamimit.

T'i jepet përparësi masave që ulin dëmin në shkallë të gjerë: etiketim më i qartë i përmbajtjes së sponsorizuar dhe politike, zbatim më i fortë i rregullave kundër reklamave mashtruese dhe masa integriteti që reduktojnë manipulimin e koordinuar. Trajtojeni arkitekturën e komenteve dhe moderimin si elementë mbrojtës të integritetit të informacionit, jo thjesht si çështje “angazhimi”.

Aktorët kryesorë: platformat, rregullatorët, aktorët rajonalë të politikave digjitale.

Afati kohor: strukturor (reforma sistemike dhe investim i vazhdueshëm)

Pse tani: platformat formësojnë atë që bëhet normale dhe komentet ndikojnë në kuptim (Tema 3; Tema 6).

9. Përmirësimi i integritetit të llogarive dhe sinjalet e origjinës që mund të kuptohen nga përdoruesit e zakonshëm.

Të investohet në sinjale të dukshme që i ndihmojnë përdoruesit të vlerësojnë autenticitetin, si verifikimi i llogarive, mbrojtja kundër imitimit dhe zinxhirë më të qartë të origjinës për përmbajtjen e rishpërndarë. Përgatituni për rreziqet nga media sintetike duke e bërë origjinën më transparente dhe duke përmirësuar reagimin e shpejtë gjatë periudhave me ekspozim të lartë.

Aktorët kryesorë: platformat, rregullatorët dhe partnerë të besuar të ekosistemit.

Afati kohor: strukturor (reforma sistemike dhe investim i vazhdueshëm)

Pse tani: “kush e ka postuar” mbetet një shkurtore kyçe dhe autenticiteti i përmbajtjes së krijuar me IA paraqet një rrezik në rritje (Tema 1; Nëntema 7.2).

10. Zhvillimi i një pakete gjithëpërfshirëse në nivel politikash për standardizim, transparencë dhe zbatim, së bashku me masat e sigurisë.

Të mbështeten kërkesat për transparencë për mediat online aty ku është e mundur, si pronësia, financimi dhe korrigjimet; të forcohen kapacitetet e pavarura të zbatimit; dhe të investohet në mekanizma që përmirësojnë cilësinë pa u keqpërdorur politikisht. Përqendrohuni në proporcionalitet, transparencë dhe komunikim të qartë publik për të rindërtuar besimin.

Aktorët kryesorë: rregullatorët, këshillat e medias, politikëbërësit, organizatat e shoqërisë civile.

Afati kohor: strukturor (reforma sistemike dhe investim i vazhdueshëm)

Pse tani: të rinjtë vazhdimisht e vendosin përgjegjësinë në nivelet më të larta të sistemit (Tema 6).

10.2 Rekomandime sipas palëve të interesuara

Për sistemet arsimore

Aktorët e arsimit duhet t'i japin përparësi Rekomandimeve nga 1 deri në 6. Fokusi duhet të jetë zhvillimi gradual i aftësive (integrimi në kurrikula, zhvillimi profesional i vazhdueshëm, mbështetja në vitet e hershme), ulja e pengesave të përditshme dhe mbështetja e mësuesve dhe prindërve si pjesë e një modeli ndërbrezor.

Për median dhe gazetarinë

Aktorët e mediave duhet të përqendrohen kryesisht te Rekomandimet 7 dhe 10. Prioriteti është rritja e cilësisë dhe transparencës, duke përshtatur shpërndarjen në formatet e platformave që të rinjtë përdorin dhe duke veçuar qartë faktet, interpretimin dhe opinionin.

Për platformat dhe ekosistemin digjital

Aktorët e platformave dhe ekosistemit duhet të përqendrohen kryesisht te Rekomandimet 8 dhe 9. Prioriteti është rritja e përgjegjësisë, promovimi i transparencës reale të reklamave, mbrojtja e integritetit dhe krijimi i strukturave të komenteve që nuk dëmtojnë përdoruesit.

Për shoqërinë civile dhe organizatat e të rinjve

Shoqëria civile duhet të përqendrohet kryesisht te Rekomandimet 1–3 dhe 6–7, duke përdorur formatet peer-to-peer dhe rrjetet e besuara, duke përfshirë fokusin te mirëqenia dhe duke e bërë bashkë-krijimin me të rinjtë një praktikë standarde dhe jo opsionale.

Për politikëbërësit dhe rregullatorët

Aktorët e politikave duhet t'i japin përparësi Rekomandimeve 8–10, duke u fokusuar te transparenca, standardet e zbatueshme dhe mbrojtja e pavarësisë për të shmangur politizimin, duke mbështetur gjithashtu median cilësore dhe komunikimin publik të besueshëm.

10.3 Aspekte të zbatimit (renditja e hapave dhe mundësia praktike)

Zbatimi duhet të nisë me veprime që reduktojnë pengesat e përditshme dhe përmirësojnë qasjen tek informacioni i besueshëm në formate të përshtatura për të rinjtë, ndërkohë që krijohen bazat për reforma më të thella.


Në planin afatshkurtër, “fitoret e shpejta” më praktike janë: projekte pilot për mbështetjen e mësuesve (module CPD), partneritete për shpjegime në formatet autoktone të platformave me media dhe kontrollues faktesh të besueshëm, si dhe integrimi i normave praktike për “shpërndarje të sigurt” në programet për të rinjtë. Në planin afatmesëm, fokusi duhet të zhvendoset tek integrimi ndër-kurrikular, materialet për fëmijët e vegjël dhe prindërit, si dhe te mekanizmat më të strukturuar të llogaridhënies dhe transparencës së platformave.

Gjatë të gjitha veprimeve, bashkë-krijimi me të rinjtë duhet të konsiderohet një element thelbësor i dizajnit. Kjo qasje rrit rëndësinë, tonin dhe angazhimin e ndërhyrjeve, duke garantuar që ndërhyrjet të ndërtojnë besim në vend që të nxisin rezistencë.

10.4 Shënime për vëzhgim dhe të nxënit (çfarë të monitorohet)

Progresi duhet të ndiqet përmes një kombinimi treguesish të përvetësimit (si shtrirja dhe përdorimi i mjeteve), treguesish të aftësive (si adoptimi i rutinave të thjeshta dhe me nivel të ulët vështirësie) dhe treguesish në nivel sistemi (si përmirësimet në transparencë dhe llogaridhënie).

Në praktikë, partnerët duhet të kërkojnë tre sinjale kryesore: nëse të rinjtë e kanë më të lehtë procesin e verifikimit, nëse zvogëlohet mbingarkesa emocionale dhe ndjenja e dorëzimit, dhe nëse informacioni i besueshëm bëhet më i aksesueshëm në platformat dhe hapësirat ku ata kalojnë kohën e tyre.





Përfundime



11

Përmbledhje e gjetjeve më të rëndësishme

Ky studim tregon se mjediset e informacionit për të rinjtë në BB6 kuptohen më mirë si sisteme të përjetuara dhe jo thjesht si një luftë mes përmbajtjes “së vërtetë” dhe asaj “të rreme”. Të rinjtë lundrojnë në rrjedha informacioni me volum të lartë dhe ritëm të shpejtë, të formësuara nga dizajni i platformave, ekosistemet e krijuesve dhe rrugët sociale. Ekspozimi është shpesh i rastësishëm dhe jo i qëllimshëm: pretendimet vijnë përmes rekomandimeve, formateve të shkurtra, komenteve dhe shpërndarjes gjysmë-private, shpesh të shkëputura nga konteksti.

Prandaj, gjykimet mbi besueshmërinë bëhen brenda kufizimeve reale. Verifikimi nuk është një veprim automatik; ai është një proces që kërkon përpjekje dhe konkurren me presionin kohor, ngarkesën emocionale dhe pasigurinë. Të rinjtë mbështeten në “sinjale besueshmërie” praktike dhe tregues të zëvendësueshëm për të vendosur se çfarë të besojnë, injorojnë ose shpërndajnë. Këto rrugë të shkurtra mund të ndihmojnë të kuptuarit në mjedise komplekse, por ato gjithashtu krijojnë dobësi kur prezantimi “me pamje zyrtare”, metrikat e angazhimit ose miratimi social merren gabimisht si tregues besueshmërie.

Besimi është i pabarabartë dhe i kontestuar. Besimi institucional ndryshon në varësi të kontekstit, por skepticizmi ndaj motiveve politike dhe praktikave mediatike është i përhapur. Në shumë raste, besimi kalon përmes njerëzve dhe ndërmjetësve të njohur, si miqtë, familja, krijuesit dhe rrjetet komunitare. Kjo mbështetje sociale mund të jetë mbrojtëse, por gjithashtu mund të përshpejtojë qarkullimin e informacionit në hapësira gjysmë-private, ku origjina e informacionit është e vështirë për t'u verifikuar dhe informacioni korrigjues është më pak i dukshëm.

Rreziku intensifikohet gjatë periudhave me rëndësi të madhe, si zgjedhjet, krizave dhe çështjeve sociale polarizuese. Në këto momente, të rinjtë përshkruajnë ekspozim më të lartë dhe reagime emocionale më të forta, ku disa bëhen hiper-vigjilentë ndërsa të tjerët tërhiqen për të mbrojtur mirëqenien e tyre. Mbidoza e informacionit nuk është vetëm çështje sasive; ajo është një gjendje që ndryshon mënyrën se si bëhet gjykimi dhe si ruhet pjesëmarrja. Triangulimi i metodave të përdorura në studim tregon gjithashtu se “ajo që është e dukshme publikisht” nuk përputhet gjithmonë me “atë që duket e pashmangshme” në rrjedhat e personalizuara dhe në kanalet private ose gjysmë-private.

Në përgjithësi, dëshmitë tregojnë se reagimet efektive nuk mund të varen vetëm nga përgjegjësia individuale. Qasjet e fokusuar te të rinjtë duhet të marrin parasysh aspektin social të informacionit, parimet e dizajnit të platformave dhe kufizimet praktike të verifikimit nën presion.

Përmbledhje përmbyllëse dhe perspektiva për të ardhmen

Implikimi i qartë është se rritja e qëndrueshmërisë në mjediset e informacionit për të rinjtë kërkon veprim në shumë nivele. Në nivel individual, edukimi mediatik dhe informativ duhet të theksojë aftësitë praktike për marrjen e vendimeve në situata reale (si njohja e sinjaleve të manipulimit, menaxhimi i pasigurisë dhe përdorimi i strategjive të përshtatshme të verifikimit), dhe jo pritjen për verifikim të plotë.

Në nivel komuniteti, ndërhyrjet duhet t'i trajtojnë bashkëmoshatarët, mësuesit dhe ndërmjetësit e besuar si pjesë të zgjidhjes. Kjo përfshin mbështetjen e mësuesve përmes zhvillimit profesional të vazhdueshëm dhe materialeve të gatshme për klasën; pajisjen e prindërve dhe kujdestarëve me udhëzime jo-gjyquese; dhe integrimin e bashkë-krijimit nga të rinjtë dhe shpërndarjes peer-to-peer si parime standarde të dizajnit në situata ku besimi institucional është i ulët.

Në nivel institucional dhe sistematik, besueshmëria nuk mund të rindërtohet vetëm përmes komunikimit. Komunikimi i qëndrueshëm, transparent dhe në kohë, sidomos gjatë momenteve me intensitet të lartë, ka rëndësi për besimin. Mbështetja për median cilësore dhe kontrolluesit e fakteve ka më shumë gjasa të arrijë te të rinjtë kur ofrohet përmes formateve autoktone të platformave dhe përmes partneriteteve të dizajnuara me kujdes që ruajnë pavarësinë editoriale.

Për më tepër, studimi thekson se llogaridhënia e platformave nuk është një çështje dytësore. Faktorët që ndikojnë në ekspozim, si stimujt për amplifikim, reklamat, sistemet e rekomandimeve dhe dinamika sociale e komenteve, janë thelbësorë në formësimin e mënyrës se si informacioni bëhet "normal". Politikat dhe programet duhet të integrojnë zhvillimin e kapaciteteve me masa që rrisin transparencën dhe minimizojnë stimujt për manipulim.

Kontekstet e BP6 të diskutuara në këtë raport ndryshojnë në kapacitet institucional, mjedise mediatike dhe nivele besimi. Megjithatë, modelet janë mjaftueshëm të qëndrueshme për të mbështetur të nxënit e përbashkët rajonal, së bashku me përgjigje të personalizuar kombëtare. Çelësi është të kalohet nga korrigjimet reaktive drejt përmirësimit të infrastrukturave të përditshme të informacionit: aftësitë, mbështetjet dhe sistemet që lejojnë të rinjtë të angazhohen me besim, siguri dhe autonomi.

Referencë

Agjencia për shërbime audio dhe audiovizuale mediatike (AVMU) (2024) “Media literacy among first- and second-year secondary school students” (shënim nga takim publik / publikim kërkimor). E disponueshme në: <https://avmu.mk/en/2024/07/02/media-literacy-among-first-and-second-year-high-school-students-in-the-spotlight-of-avmus-second-public-meeting/>

Agjencia për Rini dhe Sport (2023) Strategjia Kombëtare për Rininë 2023–2027 (anglisht). E disponueshme në: <https://cms.mtsp.gov>

Instituti Shqiptar i Medias (AMI) (2021) “Edukimi për median dhe informimin: materiale mësimore për mësuesit”. Tiranë: AMI. E disponueshme në: <https://institutemedia.org/wp-content/uploads/2021/03/MIL-tools-teachings-materials-for-teachers-ALB-1.pdf>

ARTICLE 19 (2022) Content Moderation and Local Stakeholders in Bosnia and Herzegovina (raport vendi).

E disponueshme në: <https://www.article19.org/wp-content/uploads/2022/06/bosnia-herzegovina-country-report-content-moderation.pdf>

Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Investigative (BIRN) (2025) ZB6 Youth and Disinformation Study: Inception Report. Komisionuar nga British Council. Dokument i brendshëm i projektit (i papublikuar).

BFMI (2022) Social Media and the Information War in the Balkans. Sarajevë/Beograd: Balkan Free Media Initiative. E disponueshme në: <https://seenpm.org/social-media-and-the-information-war-in-the-balkans/>

Këshilli i Evropës (2022/2023) Towards Coregulation of Harmful Content Online in Bosnia and Herzegovina (studim). E disponueshme në: <https://rm.coe.int/co-regulation-of-harmful-content-online-study-eng/1680adeef7>

Sintezë kërkimore sipas vendeve (dokument projekti) (n.d.) Desk Research Summary CG. Përfshin të dhëna të UNICEF mbi ekspozimin ndaj gjuhës së urrejtjes dhe modelet e reagimit të të rinjve.

Dautaj, A. (2021) “Edukimi për median dhe informimin në arsimin parauniversitar në Shqipëri”. Tiranë: Instituti Shqiptar i Medias. E disponueshme në: <https://www.institutemedia.org/wp-content/uploads/2021/03/Astrit-Dautaj-converted.pdf>

DeFacto Consultancy (2025) Informimi i të rinjve (hulumtim CAWI, 17–27 janar 2025). E disponueshme në: <https://www.masee.org/images/InformisanjeMladih.pdf>

EMI (2021) National Media and Information Literacy Policies and Strategies in Albania. Tiranë: EMI. E disponueshme në: <https://emi-mil.al/wp-content/uploads/2021/10/National-Media-and-Information-Literacy-Policies-and-Strategies-in-Albania.pdf>

Fade In (2023) Media and Information Literacy in Albania, Croatia and Serbia. Zagreb: Fade In. E disponueshme në: https://www.fadein.hr/wp-content/uploads/2024/01/MIL-in-Albania-Croatia-and-Serbia_research-on-the-needs-and-existing-practices-1.pdf

Qeveria e Malit të Zi / Ministria e Sportit dhe Rinisë (2023) Strategjia për Rininë 2023–2027 me Planin e Veprimit 2023–2024. E disponueshme në: <https://www.gov.me/dokumenta/54c48080-7205-4622-8303-fdc12461abd3>

Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut (2024) Analysis of Research Results Related to Digital Rights. E disponueshme në: https://mhc.org.mk/wp-content/uploads/2024/09/02_analiza-povrzano-so-digitalnate-prava-ang-za-veb.pdf

Hibrid.info (2024) Edukimi për të vërtetën: Kurrikula dhe plan-programet mësimore në Kosovë. E disponueshme në: <https://hibrid.info/wp-content/uploads/2024/09/Edukimi-per-te-verteten.pdf>

Instituti për Studime të Komunikimit (IKS) (2024) Raport mbi përdorimin e lajmeve nga të rinjtë dhe njohjen e dezinformimit në Maqedoninë e Veriut. E disponueshme në: <https://respublica.edu.mk/wp-content/uploads/2024/04/survey-report-on-youth-news-consumption-desinformation-recognition-in-north-macedonia-en.pdf>

Instituti i Medias (2021) “Hapa drejt integritit të edukimit për median dhe informacionin në sistemin arsimor”. Tiranë. E disponueshme në: <https://institutemedia.org/hapa-drejt-integritit-te-edukimit-per-median-dhe-informacionin-ne-sistemin-arsimor/>

Instituti për Kërkime Sociologjike / Friedrich-Ebert-Stiftung (2023) Digital Media Literacy in South-East Europe: North Macedonia Report.

Instituti për Media dhe Analitikë (IMA) (2024/2025) “Përballja me dezinformimin në rrjetet sociale – sfida dhe perspektiva”. E disponueshme në: <https://ima.mk/wp-content/uploads/2025/02/spravuva%D1%9Ae-so-dezinformacziite-na-soczi%D1%98alnite-mrezhi-predizviczi-i-perspektivi-analizi.pdf>

IREX (2022) YouThink: Media literacy in North Macedonia. E disponueshme në: <https://www.irex.org>

IREX (2023–2024) Vibrant Information Barometer (Kosovë, Maqedonia e Veriut, Serbi). E disponueshme në: <https://www.irex.org>

Qendra Arsimore e Kosovës (KEC) (2024) “Edukimi medial” – program trajnimi për mësues. E disponueshme në: <https://kec-ks.org>

Instituti Maqedonas për Media (MIM) (2025) Our Media: Attitudes, Trust, and News Consumption in North Macedonia. E disponueshme në: <https://mim.org.mk>

Shoqata Maqedonase e Juristëve të Rinj (2022) Privacy and Protection of Personal Data of Young People in the Digital Era. E disponueshme në: <https://myla.org.mk>

MASHTI (2016–2024) Kurrikula dhe katalogë të zhvillimit profesional për arsimin në Kosovë. E disponueshme në: <https://masht.rks-gov.net>

Mediacentar Sarajevo (2023) Regulation of Harmful Content Online in Bosnia and Herzegovina. E disponueshme në: <https://media.ba>

Metamorphosis (2024–2025) Raporte mbi dezinformimin dhe lirinë e medias në rajon. E disponueshme në: <https://metamorphosis.org.mk>

MFRR (2024) Media Freedom in Bosnia and Herzegovina. E disponueshme në: <https://www.mfrr.eu>

OSCE (2022–2025) Raporte dhe rekomandime mbi edukimin mediatik dhe sektorin e medias. E disponueshme në: <https://www.osce.org>

Ostojić, V. (2024) Youth Study Montenegro 2024. E disponueshme në: <https://library.fes.de>

Reuters (2025) “Albania TikTok ban sparks debate over freedom of speech”. E disponueshme në: <https://www.reuters.com>

SEENPM (2025) The Future of the Media: Facts and Trends. E disponueshme në: <https://futureofmedia.seenpm.org>

UNDP (2024) A Guide to Media Integrity in North Macedonia. E disponueshme në: <https://www.undp.org>

UNESCO (2020–2025) Publikime mbi edukimin mediatik në Ballkanin Perëndimor. E disponueshme në: <https://www.unesco.org>

UNICEF (2025) Situation Analysis of Children and Adolescents in North Macedonia. E disponueshme në: <https://www.unicef.org>

YouthWiki (2023) Media literacy and safe use of new media – Bosnia and Herzegovina. E disponueshme në: <https://national-policies.eacea.ec.europa.eu>



The British Council is the UK's international organisation for cultural relations and educational opportunities. We support peace and prosperity by building connections, understanding and trust between people in the UK and countries worldwide. We work directly with individuals to help them gain the skills, confidence and connections to transform their lives and shape a better world in partnership with the UK. We support them to build networks and explore creative ideas, to learn English, to get a high-quality education and to gain internationally recognised qualifications. The Next Generation series is part of the British Council's commitment to exploring youth voice and choice. It aims to understand youth attitudes and aspirations, amplify youth voice and support better youth policymaking, to ensure that young people's voices are heard and their interests represented in decisions that will have lasting implications for their lives.

www.britishcouncil.org/research-insight

